



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 771/7 Prot

Durrës, më: 30.03 2026

V E N D I M

Nr. 47, datë 30.03 2026

P Ë R

**"MIRATIMIN E PROJEKT - STRATEGJISË SË PROFILIZIMIT TË FAKULTETIT
TË BIZNESIT, PËRMES NDËRKOMBËTARIZIMIT, 2025-2030"**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit dhe të Rregullores së UAMD-së; të Vendimit të Senatit Nr.174, datë 17.12.2025; të Vendimit të Rektoratit Nr.4, datë 02.02.2026 pika 4; referuar shkresës Nr. 576/1 prot., datë 02.03.2026 të Fakultetit të Biznesit, si dhe referuar Vendimit të Rektoratit Nr. 5, datë 18.03.2026 pika 3, në mbledhjen e datës 30.03.2026, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Projekt - Strategjisë së Profilizimit të Fakultetit të Biznesit, përmes ndërkombëtarizimit për periudhën 2025-2030, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - Drejtorët e Drejtorive
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT
DEKANATI

Nr. 79/12 Prot.

Durrës, më 25.02.2026

V E N D I M

Nr. 3, datë 25.02.2026

P Ë R

**"MIRATIMIN E PROJEKT - STRATEGJISË SË PROFILIZIMIT PËRMES
NDËRKOMBËTARIZIMIT 2025-2030, PËR FAKULTETIN E BIZNESIT"**

Në mbështetje të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit Të Lartë në Republikën e Shqipërisë*"; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 685, datë 25.08.2010 "*Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës*"; Ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*"; Statutit dhe Rregullores së UAMD, Vendimeve të Departamenteve të Fakultetit të Biznesit, Urdhërit të Dekanit Nr. 12 datë 23.02.2026, për "*Ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e Projekt - Strategjisë së Profilizimit përmes Ndërkombëtarizimit 2025-2030, për Fakultetin e Biznesit*", Dekanati i Fakultetit të Biznesit:

V E N D O S I:

1. Miratimin e Projekt - Strategjisë së Profilizimit përmes Ndërkombëtarizimit 2025-2030, për Fakultetin e Biznesit.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Zv. Dekanë
 - Drejtuesit e Njësive Bazë
 - Stafi Akademik
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

D E K A N

Prof. As. Dr. Llambi PRENDI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

PROJEKT - STRATEGJIA E PROFILIZIMIT PËRMES NDËRKOMBËTARIZIMIT 2025-2030

FAKULTETI I BIZNESIT

Miraturar me Vendim Dekanati Nr. 3 datë 25.02.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

PARATHËNIE

Ndërkombëtarizimi përbën një nga shtyllat kryesore të zhvillimit strategjik të arsimit të lartë në kontekstin evropian dhe global. Në një mjedis akademik gjithnjë e më të ndërlidhur, Fakulteti i Biznesit pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës synon të forcojë pozicionin e tij si një njësi akademike moderne, konkurruese dhe e integruar në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

Strategjia e Ndërkombëtarizimit 2025–2030 përfaqëson një dokument kornizë që harmonizon vizionin institucional të UAMD me prioritetet e gjashtë departamenteve përbërëse të Fakultetit të Biznesit. Ajo përcakton drejtimet strategjike, objektivat afatmesme dhe afatgjata, mekanizmat e zbatimit dhe instrumentet e monitorimit për integrimin sistematik të dimensionit ndërkombëtar në:

- Mësimdhënie
- Kërkim shkencor
- Inovacion
- Bashkëpunim institucional
- Shërbim ndaj komunitetit

Kjo strategji synon jo vetëm rritjen e cilësisë akademike, por edhe fuqizimin e rolit të Fakultetit të Biznesit si aktor i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik rajonal dhe kombëtar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

QËLLIMI I STRATEGJISË

Qëllimi i Strategjisë së Ndërkombëtarizimit të Fakultetit të Biznesit për periudhën 2025–2030 është konsolidimi i një modeli të qëndrueshëm dhe të integruar të ndërkombëtarizimit, i cili:

- Rrit cilësinë dhe relevancën e programeve të studimit në përputhje me standardet evropiane;
- Forcon kërkimin shkencor përmes rrjeteve dhe projekteve ndërkombëtare;
- Zgjeron mobilitetin akademik të studentëve dhe stafit;
- Promovon programe të përbashkëta dhe diploma duale;
- Rrit dukshmërinë dhe reputacionin ndërkombëtar të Fakultetit;
- Ndërton partneritete strategjike me universitete, institucione financiare dhe sektorin privat.

Strategjia përfaqëson dokumentin koordinues në nivel fakulteti, i cili harmonizon dhe mbështet strategjitë e ndërkombëtarizimit të:

- Departamentit të Marketingut
- Departamentit të Menaxhimit
- Departamentit të Shkencave Ekonomike
- Departamentit të Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar
- Departamentit të Turizmit
- Departamentit të Financë-Kontabilitetit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

GRUPI I PUNËS PËR HARTIMIN E STRATEGJISË

Strategjia e Ndërkombëtarizimit të Fakultetit të Biznesit 2025–2030 është hartuar nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhër të Dekanit të Fakultetit të Biznesit.

Përbërja e Grupit të Punës:

Kryetar: Dr. Altin Gjini

Anëtarë:

Prof. Asoc. Dr. Vaeld Zhezha

Përgjegjës i Departamentit të Marketingut

Prof. Asoc. Dr. Alma Zisi

Përgjegjës i Departamentit të Shkencave Ekonomike

Prof. Asoc. Dr. Mirela Tase

Përgjegjës i Departamentit të Turizmit

Prof. Asoc. Dr. Rovenia Troplini (Vangjel)

Përgjegjës i Departamentit Financë-Kontabilitet

Dr. Denada Liça

Përgjegjës i Departamentit të Menaxhimit

Grupi i punës ka analizuar strategjitë departamentale, dokumentet institucionale dhe kuadrin evropian të arsimit të lartë, duke ndërtuar një dokument të integruar në nivel fakulteti.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

Permbajtje

Departamenti i Marketingut.....	7
1. Baza ligjore dhe dokumentet referuese.....	7
2. Qëllimi i Strategjisë së Programit.....	7
3. Ndërkombëtarizimi – gjendja aktuale.....	7
4. Objektivat strategjike 2025–2030.....	8
5. Objektivat vjetore (2025–2030).....	10
6. Burimet financiare.....	10
7. KPI dhe monitorimi.....	11
8. Struktura e zbatimit dhe përgjegjësitë.....	12
9. Menaxhimi i riskut.....	12
Departamenti i Shkencave Ekonomike.....	13
1. Baza ligjore dhe dokumentet referuese.....	13
2. Qëllimi i strategjisë së departamentit.....	13
3. Ndërkombëtarizimi, gjendja aktuale.....	14
4. Objektivat strategjike 2025–2030.....	19
5. Objektivat vjetore (2025–2030).....	25
6. Burimet financiare.....	26
7. Kpi dhe monitorimi.....	27
8. Struktura e zbatimit dhe përgjegjësitë.....	28
9. Menaxhimi i riskut.....	29
Departamenti i statistikës dhe informatikës së zbatuar.....	31
1. Baza ligjore dhe dokumentet referuese.....	31
2. Qëllimi i strategjisë së departamentit.....	31
3. Ndërkombëtarizimi, gjendja aktuale.....	33
4. Objektivat strategjike 2025–2030.....	36
5. Objektivat vjetore (2025–2030).....	42
6. Burimet financiare prioritetet dhe plani financiar 2025–2030.....	43
7. Kpi dhe monitorimi.....	45
8. Struktura e zbatimit dhe përgjegjësitë.....	47
9. Menaxhimi i riskut.....	48
Departamenti i Turizmit.....	49
1. Baza ligjore dhe dokumentet referuese.....	49



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

2. Qëllimi i Strategjisë së Departamentit.....	50
3. Ndërkombëtarizimi, gjendja aktuale.....	51
4. Objektivat strategjike 2026–2030.....	57
5. Objektivat vjetore (2026–2030).....	76
6. Burimet financiare, prioritetet dhe plani financiar 2026–2030.....	77
7. KPI dhe monitorimi.....	80
8. Struktura e zbatimit dhe përgjegjësitë.....	83
9. Menaxhimi i riskut.....	83
Departamenti i Financë Kontabilitet.....	85
2. Qëllimi i Strategjisë së Departamentit.....	86
3. Ndërkombëtarizimi, gjendja aktuale.....	87
4. Objektivat strategjike 2025–2030.....	89
5. Objektivat vjetore (2025–2030).....	94
6. Burimet financiare.....	95
7. KPI dhe monitorimi.....	97
8. Struktura e zbatimit dhe përgjegjësitë.....	98
9. Menaxhimi i riskut.....	99
Departamenti i Menaxhimit.....	101
1. Baza ligjore dhe dokumentet referuese.....	101
2. Qëllimi i Strategjisë së Departamentit.....	102
3. Ndërkombëtarizimi, gjendja aktuale.....	102
4. Objektivat strategjike 2025–2030.....	106
5. Objektivat vjetore (2025–2030).....	110
6. Burimet financiare.....	111
7. KPI dhe monitorimi.....	112
8. Struktura e zbatimit dhe përgjegjësitë.....	113
9. Menaxhimi i riskut.....	114



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

Departamenti i Marketingut

Strategjia e Ndërkombëtarizimit e Programit Bachelor

"Menaxhim Marketing" dhe "Komunikimit dhe Marketingut Digjital"

Periudha: 2025–2030

1. Baza ligjore dhe dokumentet referuese

Kjo strategji hartohet në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë dhe me dokumentet strategjike institucionale dhe ndërkombëtare.

Ajo mbështetet në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", në Strategjinë e Ndërkombëtarizimit të UAMD 2025–2027, si dhe në standardet e Procesit të Bolonjës dhe Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA).

Gjithashtu, strategjia harmonizohet me prioritetet e programeve Erasmus+ dhe Horizon Europe, duke synuar përfshirjen aktive të programit në iniciativat evropiane.

2. Qëllimi i Strategjisë së Programit

1. Qëllimi kryesor i kësaj strategjie është ndërkombëtarizimi i Programit Bachelor "Menaxhim Marketing" përmes integritit sistematik të dimensionit ndërkombëtar në proceset e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve akademike.

Strategjia synon të rrisë cilësinë akademike të programit, të përmirësojë konkurrueshmërinë e tij në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe të përgatisë studentë me kompetenca profesionale dhe ndërkulturore.

Qëllime specifike janë rritja e mobilitetit studentor dhe akademik, zhvillimi i programeve në gjuhën angleze, krijimi i programeve të përbashkëta ose duale dhe rritja e punësueshmërisë në tregun ndërkombëtar të punës.

2. Qëllimi i kësaj strategjie është rritja e nivelit të ndërkombëtarizimit të Profilit të Komunikimit dhe Marketingut Digjital, në përputhje me Vendimin e Senatit nr. 67 dhe Strategjinë Institucionale të Ndërkombëtarizimit të Universitetit për periudhën 2025–2030. Strategjia synon përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe profilit akademik ndërkombëtar të departamentit.

3. Ndërkombëtarizimi – gjendja aktuale

Programi Bachelor "Menaxhim Marketing" ofron një bazë të mirë për zhvillimin e ndërkombëtarizimit, pasi disponon staf akademik të kualifikuar, infrastrukturë të përshtatshme dhe eksperiencë në projekte ndërkombëtare.

Aktualisht, departamenti ka partneritete aktive me universitete në Ballkan dhe në Bashkimin Evropian, kryesisht në kuadër të programeve Erasmus+.

Mobilitetet e realizuara përfshijnë shkëmbime studentore dhe staf akademik për mësimdhënie dhe trajnim.

Gjithashtu, programi disponon kapacitete si laboratorë IT, platforma digjitale dhe staf me përvojë ndërkombëtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

4. Objektivat strategjikë 2025–2030

OS1: Rritja e mobilitetit ndërkombëtar të studentëve dhe stafit akademik.

OS2: Konsolidimi i mëtejshëm programi të studimit në gjuhën angleze dhe përkthitja e studentëve të huaj. Ndërkombëtarizimi i kurrikulës dhe programeve të studimit në marketing.

OS3: Krijimi dhe konsolidimi i një programi të përbashkët ose programi dual me universitete evropiane.

OS4: Rritja e pjesëmarrjes në kërkim shkencor dhe publikime me bashkautorë ndërkombëtarë.

OS5: Forcimi i kërkimit shkencor dhe publikimeve ndërkombëtare

Këto objektiva synojnë ta pozicionojnë programin në standarde evropiane dhe ta bëjnë atë më tërheqës për studentët vendas dhe të huaj.

4.1 Fushat e ndërhyrjes dhe masat

Mobiliteti i studentëve do të realizohet kryesisht përmes programeve Erasmus+, duke u ofruar studentëve mundësi për të ndjekur një ose dy semestra në universitete partnere. Mobiliteti i stafit akademik do të përfshijë aktivitete teaching dhe training në institucione partnere evropiane. Projekte dhe fonde ndërkombëtare si KA171 dhe Horizon do të shfrytëzohen për zhvillimin institucional. Programet e përbashkëta dhe duale do të zhvillohen me universitete në Rumani, Itali, Bullgari ose me vende të tjera të BE. Ndërkombëtarizimi i kurrikulës do të realizohet përmes futjes së literaturës në anglisht dhe përdorimit të literaturës ndërkombëtare. Kërkimi shkencor do të përfshijë publikime të përbashkëta dhe pjesëmarrje në konferenca. Eventet ndërkombëtare si International Week dhe guest lecturers do të forcojnë dimensionin ndërkulturor. Marketingu ndërkombëtar do të përfshijë promovimin e programit në faqe zyrtare dhe rrjete akademike.

4.2 Plani i veprimit (Action Plan) - Menaxhim Marketing dhe K.M.D.

Nr	Aktiviteti/ Masa	Afati	Përgjegjësi	Partnerë	Burime	Output/Rezultat
1	Konsolidimi i programit në gjuhën angleze dhe përkthitja e studentëve të huaj	2025	Drejtuesi i njësisë bazë / Kordinatori / Departamenti	UAMD / Universitete partnere	Buxheti fakulteti	Kurikulë tërësisht në anglisht Studentë të huaj të regjistruar
2	Nënshkrim MoU me universitete BE	2026	Drejtuesi i njësisë bazë / Kordinatori / Departamenti	Vende të BE (Rumani, Itali, etj)	Erasmus+	Marrëveshje bashkëpunimi
3	Program dual degree	2027	Drejtuesi i	Universitete	Projekt	Diplomë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

			njësisë bazë / Kordinatori / Departament i	partnere	e	dyfishtë / Duale
4	Guest lecturers	Çdo vit	Drejtuesi i njësisë bazë / Kordinatori / Departament i	BE	Erasmu s+	4 pedagogë të huaj
N r	Aktiviteti / Masa	Afati	Përgjegjësi	Partnerë	Burime	Output / Rezultat
1	Integrimi i moduleve në gjuhën angleze në programet e Komunikimit dhe Marketingut Digjital (p.sh. Digital Marketing, Social Media Strategy, Brand Communication, Content Marketing) në programet e Komunikimit dhe Marketingut Digjital	2025 –202 7	Departament i i Komunikimi t dhe Marketingut Digjital	Universitete partnere	Burime njerëzo re	Module të ofruara në anglisht
2	Mobilitet i stafit akademik përmes Erasmus+	2025 –203 0	Departament i / Zyra e Ndërkombët arizimit	Universitete BE	Erasmu s+	Rritje e mobilitetit
3	Mobilitet i studentëve në programe shkëmbimi	2025 –203 0	Departament i	Universitete partnere	Erasmu s+	Studentë pjesëmarrës
4	Organizimi i leksioneve me profesorë të huaj	Çdo vit	Departament i	Lektorë ndërkombët arë	Buxhet instituc ional	Leksione ndërkombëtare
5	Projekte të përbashkëta kërkimore në fushën e komunikimit,	2026 –203 0	Stafi akademik	Partnerë ndërkombët arë	Grante	Publikime shkencore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

	marketingut digjital, mediave sociale dhe sjelljes së konsumatorit online					
6	Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare në fushën e komunikimit, marketingut digjital dhe teknologjive të medias	2025 –203 0	Stafi akademik	Organizator ë	Buxhet / Grante	Prezantime shkencore
7	Promovimi ndërkombëtar i programeve të Komunikimit dhe Marketingut Digjital	2025 –203 0	Departament i	Zyra e Marrëdhëni eve me Publikun	Burime institutuc ionale	Materiale promocionale

5. Objektivat vjetore (2025–2030)

2025: Konsolidimi i partneriteteve dhe rritja e mobilitetit.

2026: Nënshkrim MoU me universitete BE.

- Zgjerimi i ofertës së lëndëve në gjuhë të huaj (minimumi dy module).
- Realizimi i mobiliteteve të para të stafit akademik dhe studentëve.
- Vendosja e të paktën një marrëveshjeje bashkëpunimi me universitete të huaja në fushën e komunikimit digjital.

2027: Nisja e programit dual degree me universitet partner.

- Organizimi i aktiviteteve ndërkombëtare (leksione, workshope, seminare online) me ekspertë të huaj.
- Rritja e pjesëmarrjes së stafit në konferenca ndërkombëtare të marketingut digjital.
- Përfshirja e studentëve në projekte kërkimore dhe praktike me dimension ndërkombëtar.

2028–2030: Konsolidimi i programit dhe zgjerimi i bashkëpunimeve ndërkombëtare.

- Organizimi i aktiviteteve ndërkombëtare (leksione, workshope, seminare online) me ekspertë të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

huaj.

- Rritja e pjesëmarrjes së stafit në konferenca ndërkombëtare të marketingut digjital.
- Përfshirja e studentëve në projekte kërkimore dhe praktike me dimension ndërkombëtar.

6. Burimet financiare

Zbatimi i strategjisë do të mbështetet në burimet financiare të fakultetit dhe universitetit, si dhe në fondet e siguruara nga programet Erasmus+, Horizon, Interreg, etj.

Programi Erasmus+ (KA131 / KA171)

Programi Erasmus+ do të përbëjë një nga burimet kryesore financiare për ndërkombëtarizimin e profilit Komunikim dhe Marketing Digjital, përmes:

- mobilitetit të studentëve për studime dhe praktika profesionale në universitete partnere;
- mobilitetit të stafit akademik për mësimdhënie dhe trajnim;
- shkëmbimit të praktikave më të mira në fushën e marketingut digjital, komunikimit dhe mediave sociale;
- mbështetjes së aktiviteteve të internacionalizimit në shtëpi (leksione online, seminare të përbashkëta).

Projekte ndërkombëtare (KA2 / CBHE / Horizon Europe / Interreg, etj.)

Departamenti synon të rrisë pjesëmarrjen në projekte të financuara ndërkombëtarisht, të cilat do të kontribuojnë në:

- zhvillimin e kapaciteteve akademike dhe kërkimore në komunikim dhe marketing digjital;
- modernizimin e kurrikulës dhe metodave të mësimdhënies;
- realizimin e kërkimeve të përbashkëta dhe publikimeve shkencore;
- forcimin e bashkëpunimit me universitete dhe institucione kërkimore evropiane.

Gjithashtu, do të synohet sigurimi i fondeve nga projekte ndërkombëtare dhe partnerë strategjikë.

Nevoja për investime përfshin trajnimin e stafit, zhvillimin e kurrikulës dhe përmirësimin e infrastrukturës digjitale.

Për zbatimin efektiv të strategjisë, parashikohen investime dhe trajnime në:

- zhvillimin e aftësive të stafit akademik në marketing digjital, media sociale, analitikë digjitale dhe mjete bashkëkohore komunikimi;
- përmirësimin e infrastrukturës digjitale dhe laboratorëve mësimorë;
- trajnime për shkrimin dhe menaxhimin e projekteve ndërkombëtare;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

- certifikime profesionale relevante për fushën e komunikimit dhe marketingut digjital.

7. KPI dhe monitorimi

Treguesit kryesorë të performancës përfshijnë numrin e studentëve vendas e të huaj, mobilitet e studentëve dhe stafit, numrin e marrëveshjeve ndërkombëtare, numrin e programeve joint/dual, numrin e lëndëve në anglisht dhe numrin e publikimeve ndërkombëtare.

Monitorimi do të realizohet përmes raporteve vjetore të përgatitura nga koordinatori i programit, drejtuesi i njësis bazë dhe departamenti në bashkëpunim me Zyrën e Ndërkombëtarizimit.

Viti 2026

- Numri i moduleve në gjuhë të huaj në profilin Komunikim dhe Marketing Digjital (target: ≥ 2).
- Numri i mobiliteteve të stafit akademik (target: ≥ 2).
- Numri i mobiliteteve të studentëve (target: ≥ 5).
- Numri i marrëveshjeve aktive me universitete të huaja (target: ≥ 1).

Viti 2027

- Numri i aktiviteteve ndërkombëtare (workshope, leksione, seminare) të organizuara (target: ≥ 3).
- Numri i pjesëmarrjeve të stafit në konferenca ndërkombëtare (target: ≥ 4).
- Numri i studentëve të përfshirë në projekte me dimension ndërkombëtar (target: ≥ 10).

Viti 2028

- Numri i projekteve të përbashkëta kërkimore ndërkombëtare (target: ≥ 2).
- Numri i publikimeve shkencore në revista ndërkombëtare (target: ≥ 3).
- Rritja vjetore e mobiliteteve krahasuar me vitin 2026 (target: +20%).

Viti 2029–2030

- Numri i partneriteteve ndërkombëtare të konsoliduara (target: ≥ 3).
- Numri total i mobiliteteve të realizuara gjatë periudhës 2025–2030 (target: ≥ 20).
- Raport vlerësimi për ndikimin e ndërkombëtarizimit në cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit

8. Struktura e zbatimit dhe përgjegjësitë

Zbatimi i strategjisë do të koordinohet nga drejtuesi i programit / drejtuesi i njësis bazë në bashkëpunim me grupin e punës të departamentit.

Grupi i punës do të përfshijë pedagogë dhe staf administrativ të angazhuar në ndërkombëtarizim.

Koordinimi me Dekanatin dhe Zyrën e Ndërkombëtarizimit të UAMD do të sigurojë mbështetje institucionale dhe monitorim të vazhdueshëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

9. Menaxhimi i riskut

Nr	Rreziku	Probabiliteti	Ndikimi	Masa parandaluese	Plani B
1	Mungesë fondesh	Mesatar	I lartë	Aplikime për grante	Buxhet alternativ
2	Interes i ulët për mobilitet	Mesatar	Mesatar	Informim dhe motivim	Aktivitetet online
3	Barrierat gjuhësore	I ulët	Mesatar	Trajnime gjuhësore	Leksione në shqip
4	Mungesë partnerësh	I ulët	I lartë	Zgjerim rrjeti	Marrëveshje të reja

Departamenti i Shkencave Ekonomike

1. Baza ligjore dhe dokumentet referuese

Departamenti i Shkencave Ekonomike, si pjesë përbërëse e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, e zhvillon veprimtarinë e tij akademike dhe administrative në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me Statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, si dhe me Rregulloren e Fakultetit të Biznesit të këtij universiteti.

Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës ka si synim që të integrojë dimensionin ndërkombëtar në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe shërbime akademike. Qëllimi është të rrisë bashkëpunimin global, cilësinë akademike dhe përgatitjen e studentëve për tregun ndërkombëtar të punës. Departamenti i Shkencave Ekonomike i bashkangjitet plotësisht këtyre qëllimeve, duke kërkuar që të ketë arritje të dukshme në shkëmbime studentore dhe stafit, marrëveshje bashkëpunimi me universitete të huaja, programe studimi në gjuhë të huaj, projekte dhe kërkime ndërkombëtare dhe pranim të studentëve ndërkombëtarë.

Kjo strategji u hartua duke u mbështetur në bazën e mëposhtme ligjore:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr. 80, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;
- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë";
- Statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës të miratuar me Urdhër nr. 385, datë 09.07.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

- Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës të miratuar me Vendimin nr. 154, datë 26.11.2018 të Senatit Akademik të këtij universiteti;
- Strategjinë e Ndërkombëtarizimit 2025-2030 të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës
- Rregulloren e Fakultetit të Biznesit të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës miratuar me vendim Senati Nr. 36, datë 20.05.2019;
- Rregulloren e Departamentit të Shkencave Ekonomike miratuar me vendim Senati Nr. 68, datë 4.11.2019;
- Rregulloren e Brendshme të Drejtorisë së Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë të miratuar me Vendimin nr. 5, datë 17.01.2020 të Senatit Akademik të këtij universiteti.

2. Qëllimi i strategjisë së departamentit

Qëllimi i Strategjisë së Ndërkombëtarizimit të Departamentit të Shkencave Ekonomike konsiston në konsolidimin e një njësie akademike cilësore dhe konkurruese në përputhje me vizionin e ndërkombëtarizimit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës dhe të Fakultetit të Biznesit. Ky departament kërkon bashkëpunimin global, cilësinë akademike dhe përgatitjen e studentëve për tregun vendas dhe ndërkombëtar të punës. Ai synon shkëmbime studentore dhe të stafit, marrëveshje bashkëpunimi me universitete të huaja, programe studimi në gjuhë të huaj, projekte dhe kërkime ndërkombëtare dhe pranim të studentëve ndërkombëtarë. Departamenti mund të ofrojë programe studimi të standardeve të larta, bashkëkohore dhe tërheqëse për brezat e ardhshëm të studentëve vendas dhe të huaj. Aftësimi i duhur i studentëve i bën ata kontribues të denjë në zhvillimin ekonomik dhe social të komunitetit, vendit dhe më gjerë.

Ndërkombëtarizimi i Departamentit përfshin iniciativa dhe veprimtari që rrisin cilësinë akademike, forcojnë lidhjet me institucionet ndërkombëtare dhe përgatisin studentët për një botë gjithnjë e më të lidhur globalisht.

- Rritja e mobilitetit ndërkombëtar të studentëve dhe stafit akademik nëpërmjet programeve të shkëmbimit si Erasmus+ ose partneriteteve me universitete të huaja për të mundësuar që studentët dhe stafi akademik të studiojnë ose të zhvillojnë kërkime në institucione ndërkombëtare.
- Rritja e numrit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete dhe/ose institute kërkimore jashtë vendit, duke mundësuar projekte kërkimore të përbashkëta dhe mundësi për diplomë të dyfishtë.
- Rritja e numrit të programeve të studimit në gjuhë të huaj, kryesisht anglisht, për të tërhequr studentë ndërkombëtarë dhe për të përgatitur studentët vendas për një treg global të punës.
- Nxitja e pjesëmarrjes në projekte kërkimore ndërkombëtare, si ato të financuara nga programet e BE-së.
- Mbështetje për studentët ndërkombëtarë për t'u regjistruar dhe për t'u integruar në mjedisin akademik të universitetit.
- Nxitja e pjesëmarrjes së stafit dhe studentëve në konferenca, seminare dhe aktivitete akademike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

ndërkombëtare për të ndarë njohuri dhe për të rritur vizibilitetin global.

3. Ndërkombëtarizimi, gjendja aktuale

Përshkrimi i Departamentit të Shkencave Ekonomike

Departamenti i Shkencave Ekonomike është pjesë e Fakultetit të Biznesit në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, institucion publik i arsimit të lartë i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Nr. 801, datë 20.12.2005 "Për hapjen e Universitetit "Aleksandër Moisiu" në Durrës".

Stafi akademik i Departamentit të Shkencave Ekonomike karakterizohet nga një profil profesionalisht, i gatshëm për të përballuar me efikasitet ngarkesën mësimore të shoqëruar me angazhime kërkimore dhe pjesëmarrje në forumet shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Përmes menaxhimit të kujdesshëm dhe me përgjegjshmëri të lartë të procesit mësimor, Departamenti mbështet realizimin e programeve akademike në tre ciklet e studimit: Bachelor, Master Shkencor dhe Doktoraturë, duke synuar standarde të larta cilësore dhe rezultate të matshme të të nxënit. Procesi mësimor i Departamentit mbështetet në kurrikula bashkëkohore, të hartuara dhe të përditësuara nga vetë pedagogët e departamentit, në përputhje me zhvillimet e fundit në literaturën dhe praktikën akademike, si dhe në objektivat strategjike të programit arsimor. Këto kurrikula synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe përgatitjen e studentëve për sfidat e tregut të punës dhe kërkesat e zhvillimit ekonomik.

Aktualisht Departamenti i Shkencave Ekonomike ofron programe si në vijim:

- Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Shkenca Ekonomike" i ofruar nga Universiteti "Aleksandër Moisiu", Fakulteti i Biznesit, Departamenti i Shkencave Ekonomike është hapur në vitin akademik 2006 – 2007 me Vendimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr 1786 Prot, datë 20.03.2007 dhe riorganizuar sipas VKM Nr 685, datë 25.08.2010 "Për Riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.
- Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Ekonomia Qarkulluese dhe zhvillimi i qëndrueshëm" i ofruar nga Universiteti "Aleksandër Moisiu", Fakulteti i Biznesit, Departamenti i Shkencave Ekonomike është hapur në vitin akademik 2024– 2025 me Urdhër Nr.361, datë 12.07.2024 nga MAS.
- Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Economics Science", program në gjuhën angleze, i ofruar nga Universiteti "Aleksandër Moisiu", Fakulteti i Biznesit, Departamenti i Shkencave Ekonomike është hapur në vitin akademik 2022 – 2023 me Urdhër Nr.489 , datë 01.09.2023 nga MAS.
- Programi i studimit Master Shkencor në Ekonomi Biznes i ofruar nga Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, Fakulteti i Biznesit, Departamenti i Shkencave Ekonomike është hapur në vitin akademik 2009 - 2010 me VKM Nr.1002, datë 30.9.2009 "Për hapjen e programeve të studimit të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

ciklit të dytë në Universitetin "Aleksandër Moisiu Durrës" dhe riorganizuar herën e parë sipas Udhëzimit Nr. 31, datë 29.12.2017 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e Arsimit të Lartë" dhe herën e dytë sipas Udhëzimit Nr. 01, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisë kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë".

- Programi i studimit të Ciklit të Tretë Doktoraturë në "Shkenca Ekonomike" i ofruar nga Universiteti "Aleksandër Moisiu", Fakulteti i Biznesit, Departamenti i Shkencave Ekonomike është rihapur në vitin akademik 2021-2022 me Vendimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr.134 datë 17.03.2024 "Për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të tretë nga Doktoratë në "Shkencat Ekonomike" në Doktoratë në "Shkenca Ekonomike" me Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës.

Në fushën e kërkimit shkencor, Departamenti ka treguar nivel të lartë fleksibiliteti dhe përkushtimi, duke marrë pjesë aktivisht në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe duke kontribuar me botime në revista të fushës. Këto aktivitete kanë kontribuar në rritjen e profilit akademik dhe njohjen e arritjeve të Departamentit në shkallë kombëtare dhe më gjerë. Përpjekjet e vazhdueshme të stafit janë reflektuar në arritjen e titujve dhe gradave shkencore të avancuara, si dhe në zgjerimin e kontributit akademik dhe kërkimor. Aktualisht në departamentin e Shkencave Ekonomike janë: 1 anëtar me titullin "Profesor" 4 anëtarë me titullin "Profesor i Asociuar" dhe 5 anëtarë mbajën gradën "Doktor". Puna e anëtarëve të Departamentit të Shkencave Ekonomike, është punë intensive dhe e përgjegjshme individuale dhe në grup, në ndihmë të komunitetit studentor dhe atij akademiko-shkencor dhe politikbërës.

Partneritetet dhe bashkëpunimet me universitete të tjera

Partneritetet dhe bashkëpunimet me universitete të tjera luajnë një rol thelbësor në forcimin e kapaciteteve akademike, kërkimore dhe mësimore të një departamenti apo institucioni të arsimit të lartë. Këto bashkëpunime sjellin përfitime të shumta të dokumentuara në praktikën ndërkombëtare të arsimit të lartë:

Aktualisht Fakulteti i Biznesit ka krijuar ura bashkëpunimi me disa Universitete si: Universiteti i La Laguna (ULL), Spanjë, Universiteti La Sapienza në Romë, Universitetin e Ankonës etj. Departamenti i Shkencave Ekonomike synon që brenda vitit 2027 të sigurojë nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi me një universitet partner për implementimin e një programi dual akademik, në funksion të zhvillimit të modelit të mësimdhënies dhe të rritjes së cilësisë së përgatitjes profesionale të studentëve.

Mobiliteti i stafit akademik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

Mobiliteti i stafit akademik sjell një sërë përfitimesh të rëndësishme për nivelin individual të pedagogëve dhe për institucionet e arsimit të lartë në të cilat ata angazhohen. Në përgjithësi, mobiliteti i stafit akademik është një instrument i fuqishëm për të zhvilluar kapacitetet akademike, për të forcuar cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit, për të zgjeruar bashkëpunimet ndërkombëtare. Mobilitetet e realizuara gjatë 3 viteve të fundit nga stafi i Departamentit të Shkencave Ekonomike janë të pasqyruara në Tabelën 1:

Tabela 1: Mobiliteti i stafit akademik të Departamentit të Shkencave Ekonomike

N	Emri	Mbiemri	Departamenti	Universiteti	Shteti	Viti akademik	Mësimdhënie/trajnimi
1	Alma	Zisi	Shkenca Ekonomike	Universiteti Bielefeld	Gjermani	2022-2023	Trajnim
2	Entela	Velaj	Shkenca Ekonomike	Universiteti Bielefeld	Gjermani	2022-2023	Trajnim
3	Alba	Ramallari	Shkenca Ekonomike	Universiteti Bahcesehir	Turqi	2022-2023	Mësimdhënie
4	Mithat	Mema	Shkenca Ekonomike	Universiteti Vilnius	Lituani	2022-2023	Trajnim
5	Flora	Merko	Shkenca Ekonomike	University Leon	Spanje	2022-2023	Trajnim
6	Ela	Golemi	Shkenca Ekonomike	University Seville	Spanje	2022-2023	Trajnim
7	Ela	Golemi	Shkenca Ekonomike	ISAG	Portugali	2023-2024	Trajnim
8	Entela	Velaj	Shkenca Ekonomike	Bielefeld University	Germani	2023-2024	Training
9	Flora	Merko	Shkenca Ekonomike	Mykolas Romelis University	Lituani	2023-2024	Teaching
10	Alma	Zisi	Shkenca Ekonomike	Mykolas Romelis University	Lituani	2023-2024	Teaching
11	Llambi	Prendi	Shkenca Ekonomike	Instituti Politeknik I Braganças	Portugali	2023-2024	Training



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

Pjesëmarrje në projektet kombëtare dhe ndërkombëtare

Pjesëmarrja në projektet kombëtare dhe ndërkombëtare është një komponent kyç i strategjisë për ndërkombëtarizimin e një departamenti universiteti, dhe luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kërkimit shkencor, rritjen e cilësisë akademike dhe krijimin e mundësive për studentë dhe staf akademik. Pjesëmarrja në këto projekte ofron mundësi për bashkëpunim ndërkombëtar, mbështetje financiare, dhe zhvillimin e kapaciteteve për të adresuar sfida globale dhe lokale. Tabela 2 ilustron përfshirjen e stafit akademik të departamentit në projekte të ndryshme.

Tabela 2 Projekte ku angazhohet stafi akademik i Departamentit të Shkencave Ekonomike

Të dhëna mbi Pjesëmarrjen në projekte Kombëtare dhe Ndërkombëtare
Departamenti i Shkencave Ekonomike

Nr.	Lektori	Emërtimi i Projektit	Kombëtar/ Ndërkomb	Financuesi	Afati
1.	Alma Zisi	Përdorimi i teknologjisë miqësore si një faktor i rëndësishëm në industrinë e turizmit të gjelbert	Kombetar	AKSHI	18 muaj
2.	Alba Ramallari	Plani Kontabel i biznesit, zinxhiri i lidhjes profesionist, menaxher, kontabilist, student.	Kombëtar	Uamd	2024-2 025
		Strategjitë për nxitjen e bizneseve të reja në sektorin e Ekonomisë Qarkulluese në Shqipëri	Kombëtar	AKKSHI	2024-2 025
3.	Daniela Lika	(START4CE-AI)			
		Ndikimi i Turizmit në Mjedisin Natyror: ndërliçhja Turizëm – Mjedis – Rritje Ekonomike në Shqipëri	Kombëtar	UAMD	2024-2 025
		Ndikimi i Turizmit në Mjedisin Natyror: ndërliçhja Turizëm – Mjedis – Rritje Ekonomike në Shqipëri	Kombëtar	UAMD	2024-2 025
4.	Jonida Gashi	Studim mbi përputhshmërinë e kërkesës dhe ofertës për punësimin e të rinjve në Qarkun e Durrësit	Kombëtar	UAMD	2023-2 024
		Building Opportunities for Neë	Kombetar	PKKZH/A	24



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

		Startups in the Circular Economy in Albania		KKSHI	muaj
5.	Irimi Goga	Përdorimi i teknologjisë miqësore si një faktor i rëndësishëm në industrinë e turizmit të gjelbert ELMOB, Partneritetet për promovimin dhe popullarizimin e lëvizshmërisë Elektrike përmes transformimit dhe modernizimit të programeve të studimit të IAL-ve të vendeve të Ballkanit Perëndimor.	Kombetar	AKSHI	18 MUAJ
6.	Flora Merko	Komponenti "Rritja e Kapaciteteve në Arsimin e Lartë. Studim mbi përputhshmërinë e kërkesës dhe ofertës për punësimin e të rinjve në Qarun e Durrësit Përdorimi i teknologjisë miqësore si një faktor i rëndësishëm në industrinë e turizmit të gjelbert	Ndërkombëtar	BASHKIM I EUROPIA N	2022-2025
			Kombëtar	UAMD	2023-2024
			Kombetar	AKSHI	18 UAJ

4. Objektivat strategjike 2025–2030

Objektivat strategjike të Departamentit të Shkencave Ekonomike përfshijnë një gamë të gjerë qëllimesh, të cilat janë të orientuara drejt forcimit të pozicionit të departamentit në arenën globale dhe përgatitjes së studentëve dhe stafit për një botë gjithnjë e më të lidhur ndërkombëtarisht.

4.1 Fushat e ndërhyrjes dhe masat kryesore

O1. Zgjerimi i Partneriteteve dhe Bashkëpunimeve Ndërkombëtare

O1.A1. Nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale për shkëmbim studentor dhe stafi, projekte kërkimore të përbashkëta dhe mundësi të tjera bashkëpunimi.

O1.A2. Krijimi i mundësive për studentët për të ndjekur programe të diplomave të dyfishta me universitete të huaja.

O1.A3. Aktivizimi i lidhjeve ndërkombëtare për të rritur vizibilitetin dhe reputacionin e departamentit dhe universitetit.

O2. Rritja e Pjesëmarrjes në Projekte Kërkimore Ndërkombëtare



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

- O2.A1. Angazhimi në projekte kërkimore që financohen nga organizata ndërkombëtare për të promovuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe për të forcuar kapacitetet kërkimore.
- O2.A2. Angazhimi në hulumtime që adresojnë çështje globale, si zhvillimi i qëndrueshëm, ndryshimet klimatike, dhe ekonomia globale.
- O3. Përmirësimi i Kurrikulave dhe Ofrimi i Programeve në Gjuhë të Huaj
- O3.A1. Përditësimi dhe miratimi i cilësisë së programeve të studimit për të përmbushur kërkesat e tregut global dhe për të pasur një strukturë që është tërheqëse për studentët ndërkombëtarë.
- O3.A2. Ofrimi i programeve të studimit, sidomos në anglisht, për të tërhequr studentë nga vende të ndryshme dhe për t'i mundësuar studentëve vendas të marrin një formim të orientuar ndërkombëtarisht.
- O4. Cilësia Akademike dhe Kërkimore
- O4.A1. Sigurimi që mësimdhënia dhe kërkimi të jenë në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare dhe standardet e arsimit të lartë.
- O5. Rritja e Pjesëmarrjes në Aktivitetet Akademike Ndërkombëtare
- O5.A1. Nxitja e pjesëmarrjes së stafit dhe studentëve në aktivitete akademike ndërkombëtare për të shpërndarë njohuri, për të krijuar lidhje profesionale dhe për të kontribuar në diskutimet shkencore globale.
- O6. Rritja e Diversitetit Studentor dhe Akademik
- O6.A1. Rritja e numrit të studentëve ndërkombëtarë nga vende të tjera për të krijuar një mjedis më të larmishëm dhe për të rritur mundësitë për shkëmbim kulturor.

4.2 Plani i veprimit (Action Plan)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

Tabela 3 Plani i veprimt

NR	Aktiviteti / Masa	Afati	Përgjegjës	Partnerët	Burime	Outputi / Rezultati
1	O1.A1. Nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale për shkëmbim studentor dhe stafi, projekte kërkimore të përbashkëta dhe mundësi të tjera bashkëpunimi.	20 25- 20 30	Departamenti SHE dhe Koordinatori i Marrëdhënieve Ndërkombëtare – Ky individ do të jetë përgjegjës për identifikimin e mundësive për marrëveshje dhe për negociatat me partnerët ndërkombëtarë.	Universitete ndërkombëtare Agjenci ndërkombëtare si Erasmus+	Erasmus+ (KA131/KA171) për shkëmbim studentor dhe stafi Projekte (KA2) për krijimin e marrëveshjeve të përbashkëta kërkimore.	Marrëveshje të nënshkruara për shkëmbim studentor dhe stafi, projekte kërkimore të përbashkëta
2	O1.A2. Krijimi i mundësive për studentët për të ndjekur programe të diplomave të dyfishta me universitete të huaja.	20 25- 20 30	Departamenti i Shkencave Ekonomike - Ky individ do të punojë ngushtë me universitete të huaja për të zhvilluar dhe menaxhuar programet e diplomave të dyfishta.	Universitete partnerë ndërkombëtarë Agjenci të arsimit të lartë ndërkombëtar si Erasmus Mundus dhe EACEA.	Projekte (KA2/CBHE) për zhvillimin e programeve të diplomës së dyfishtë.	Mundësi për studentët që të ndjekin programe të diplomave të dyfishta dhe të fitojnë diplomë të pranuar ndërkombëtarisht



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

NR	Aktiviteti / Masa	Afati	Përgjegjësi	Partnerët	Burime	Outputi / Rezultati
3	O1.A3. Aktivizimi i lidhjeve ndërkombëtare për të rritur vizibilitetin dhe reputacionin e departamentit dhe universitetit.	20-25-20-30	Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Ekonomike dhe Koordinatori i Marketingut dhe Promovimit – Ky individ do të jetë përgjegjës për rritjen e profilit të departamentit dhe universitetit përmes lidhjeve dhe aktiviteteve ndërkombëtare.	Universitete ndërkombëtare Organizata ndërkombëtare të arsimit dhe kërkimit si The European University Association (EUA)	Erasmus+ (KA1) për aktivitetet e vizibilitetit dhe promocion Burime të tjera si sponsorizime dhe partneritete private për mbështetje promovuese.	Rritja e vizibilitetit dhe reputacionit të Departamentit të Shkencave Ekonomike në arenën ndërkombëtare
4	O2.A1. Angazhimi në projekte kërkimore që financohen nga organizata ndërkombëtare për të promovuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe për të forcuar kapacitetet kërkimore.	20-25-20-30	Koordinatori i Kërkimit dhe Projektet Kërkimore – Ky individ do të udhëheqë angazhimin e stafit dhe studentëve në projekte ndërkombëtare kërkimore dhe do të mbikëqyrë aplikimet për financime nga organizata ndërkombëtare.	Horizon Europe Interreg Agjenci kërkimore ndërkombëtare si World Bank, UNDP, dhe OECD.	Projekte (Horizon Europe, Interreg) për financimin e projekteve kërkimore ndërkombëtare Erasmus+ (KA2) për projekte të përbashkëta kërkimore.	Pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare, zhvillimi i kërkimeve të përbashkëta



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

NR	Aktiviteti / Masa	Afati	Përcjellësi	Partnerët	Burime	Output / Rezultati
5	O2.A2. Angazhimi në hulumtime që adresojnë çështje globale, si zhvillimi i qëndrueshëm, ndryshimet klimatike, dhe ekonomia globale.	20 25- 20 30	Profesorët dhe hulumtuesit kryesorë – Ata do të merren me zhvillimin e projekteve kërkimore që adresojnë çështje globale, dhe do të bashkëpunojnë me partnerë ndërkombëtarë.	Organizata ndërkombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm si UNEP dhe Global Environment Facility (GEF). Institucione kërkimore ndërkombëtare, si Green Climate Fund, Horizon Europe, dhe Interreg.	Projekte kërkimore ndërkombëtare (Horizon Europe, Interreg) për financimin e projekteve që adresojnë çështje globale.	Publikime kërkimore në fushat e zhvillimit të qëndrueshëm, ndryshimeve klimatike dhe ekonomisë globale
6	O3.A1. Përditësimi dhe rritja e cilësisë së programeve të studimit për të përmbushur kërkesat e tregut global dhe për të pasur një strukturë që është tërheqëse për studentët ndërkombëtarë.	20 25- 20 30	Koordinatori i Kurrikulave Akademike – Ky individ do të punojë me partnerë ndërkombëtarë për të përditësuar dhe zhvilluar kurrikula që përputhen me kërkesat e tregut dhe janë tërheqëse për studentët ndërkombëtarë.	Universitete ndërkombëtare për shkëmbim kurikulash dhe bashkëpunim në zhvillimin e programeve. Projekte të financuara nga Erasmus+ (KA2).	Projekte (KA2/CBHE) për zhvillimin e kurrikulave të përbashkëta dhe përmirësimin e cilësisë.	Kurrikula të përditësuara që përmbushin kërkesat e tregut global dhe tërheqin studentë ndërkombëtarë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

NR	Aktiviteti / Masa	Afati	Përgjegjësi	Partnerët	Burime	Output / Rezultati
7	O3.A2. Ofrimi i programeve të studimit, sidomos në anglisht, për të tërhequr studentë nga vende të ndryshme dhe për t'i mundësuar studentëve vendas të marrin një formim të orientuar ndërkombëtarisht.	20 25- 20 30	Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Ekonomike – Ky individ do të udhëheqë zhvillimin dhe implementimin e programeve në gjuhën angleze për studentët ndërkombëtarë dhe vendas.	Universitete ndërkombëtare që ofrojnë mësimdhënie në anglisht. Erasmus+ KA171 për mobilitet ndërkombëtar të studentëve.	Erasmus+ (KA171) për ofrimin e programeve të studimit për studentët ndërkombëtarë.	Programe studimi në anglisht, tërheqje e studentëve ndërkombëtarë dhe përgatitje e studentëve vendas për tregun global
8	O4.A1. Sigurimi që mësimdhënia dhe kërkimi të jenë në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare dhe standardet e arsimit të lartë.	20 25- 20 30	Koordinatori i Cilësisë dhe Akreditimit – Ky individ do të sigurojë që mësimdhënia dhe kërkimi të përmbushin standardet ndërkombëtare dhe do të punojë për të siguruar akreditimet ndërkombëtare të programeve.	Erasmus+ (KA1) për trajnime dhe zhvillim profesional të stafit akademik.	Erasmus+ (KA1) për trajnime për staf dhe mundësi për ngritjen e kapaciteteve profesionale Projekte (KA2) për bashkëpunim akademik dhe kërkimor.	Mësimdhënie dhe kërkim që përmbushin standardet më të larta ndërkombëtare



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

NR	Aktiviteti / Masa	Afati	Përgjegjësi	Partnerët	Burime	Output / Rezultati
9	O5.A1. Nxitja e pjesëmarrjes së stafit dhe studentëve në aktivitete akademike ndërkombëtare për të shpërndarë njohuri, për të krijuar lidhje profesionale dhe për të kontribuar në diskutimet shkencore globale	20-20-30	Koordinatori i Mobilitetit dhe Aktivitetet Akademike – Ky individ do të koordinojë pjesëmarrjen e stafit dhe studentëve në aktivitete akademike ndërkombëtare dhe do të menaxhojë mundësitë për mobilitet ndërkombëtar.	Erasmus+ (KA1) për mobilitetin e stafit dhe studentëve.	Erasmus+ (KA1) për mobilitetin e stafit dhe studentëve për pjesëmarrje në aktivitete akademike ndërkombëtare	Rritja e pjesëmarrjes në aktivitete akademike ndërkombëtare, krijimi i mundësive për lidhje profesionale globale
10	O6.A1. Rritja e numrit të studentëve ndërkombëtarë nga vende të tjera për të krijuar një mjedis më të larmishëm dhe për të rritur mundësitë për shkëmbim kulturor.	20-20-30	Koordinatori i Mobilitetit dhe Aktivitetet Akademike – Ky individ do të merret me promovimin e mundësive për studentët ndërkombëtarë dhe me menaxhimin e aplikimeve nga studentët nga vende të ndryshme.	Universitete partnerë	Erasmus+ (KA171) për mundësi mobiliteti dhe rekrutimi të studentëve ndërkombëtarë	Rritja e numrit të studentëve ndërkombëtarë dhe diversifikimi i komunitetit akademik në Departamentin e Shkencave Ekonomike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

5. Objektivat vjetore (2025–2030)

Tabela 4 Objektivat vjetore

NR	Aktiviteti / Masa	2025-2 026	2026-2 027	2027-2 028	2028-2 029	2029-2 030
1	O1.A1. Nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale për shkëmbim studentor dhe staf, projekte kërkimore të përbashkëta dhe mundësi të tjera bashkëpunimi.	1	1	1	1	1
2	O1.A2. Krijimi i mundësive për studentët për të ndjekur programe të diplomave të dyfishta me universitete të huaja.	2-3				
3	O1.A3. Aktivizimi i lidhjeve ndërkombëtare për të rritur vizibilitetin dhe reputacionin e departamentit dhe universitetit.	1	1	1	1	1
4	O2.A1. Angazhimi në projekte kërkimore që financohen nga organizata ndërkombëtare për të promovuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe për të forcuar kapacitetet kërkimore.	1-2				
5	O2.A2. Angazhimi në hulumtime që adresojnë çështje globale, si zhvillimi i qëndrueshëm, ndryshimet klimatike, dhe ekonomia globale.	3	3	3	3	
6	O3.A1. Përditësimi dhe rritja e cilësisë së programeve të studimit për të përmbushur kërkesat e tregut global dhe për të pasur një strukturë që është tërheqëse për studentët ndërkombëtarë.	Përherë				
7	O3.A2. Ofrimi i programeve të studimit, sidomos në anglisht, për të tërhequr studentë nga vende të ndryshme dhe për t'i mundësuar studentëve vendas të marrin një formim të orientuar ndërkombëtarisht.	1-2				
8	O4.A1. Sigurimi që mësimdhënia dhe kërkimi të jenë në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe standardet e arsimit të lartë.	Përherë				
9	O5.A1. Nxjitja e pjesëmarrjes së stafit dhe studentëve në aktivitete akademike ndërkombëtare për të shpërndarë njohuri, për të krijuar lidhje profesionale dhe për të kontribuar në diskutimet shkencore globale	Përherë				
10	O6.A1. Rritja e numrit të studentëve ndërkombëtarë nga	Përherë				



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

NR	Aktiviteti / Masa	2025-2 026	2026-2 027	2027-2 028	2028-2 029	2029-2 030
	vende të tjera për të krijuar një mjedis më të larmishëm dhe për të rritur mundësitë për shkëmbim kulturor.					

6. Burimet financiare

Korniza e Përgjithshme Financiare për realizimin e strategjisë së ndërkombëtarizimit të Departamentit të Shkencave Ekonomike në Fakultetin e Biznesit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës mbështetet në disa burime kryesore financimi që sigurojnë qëndrueshmëri dhe rritje të mundësive për zhvillim. Erasmus+ (KA131/KA171) është një burim i rëndësishëm për financimin e shkëmbimeve ndërkombëtare studentore dhe stafi, si dhe për mundësitë e trajnimit dhe zhvillimit të kapaciteteve për personelin akademik. Po ashtu, Projekte të financuara nga Bashkimi Evropian, si Horizon Europe, Interreg dhe KA2/CBHE ofrojnë mundësi për financimin e projekteve kërkimore ndërkombëtare dhe për zhvillimin e partneriteteve akademike që kontribuojnë në ngritjen e nivelit të kërkimit dhe inovacionit. Këto burime financimi janë thelbësore për mbështetje të projekteve kërkimore, zhvillimin e programeve të diplomave të dyfishta dhe rritjen e cilësisë akademike në nivel ndërkombëtar. Përveç fondeve ndërkombëtare, Departamenti mund të shfrytëzojë burime të tjera, si partneritete me universitete dhe institucione arsimore të huaja, për të mbështetur aktivitetet e ndërkombëtarizimit. Këto partneritete mund të ofrojnë mundësi për financimin e konferencave, ngjarjeve akademike dhe aktiviteteve të tjera që rrisin vizibilitetin e departamentit dhe të universitetit në arenën ndërkombëtare. Gjithashtu, sponsorizimet nga sektorë privatë dhe organizata ndërkombëtare mund të ndihmojnë në financimin e aktiviteteve promovuese dhe zhvillimin e mundësive për studentët dhe stafin të angazhohen në shkëmbime ndërkombëtare. Për të mbështetur këto iniciativa, do të kërkohet një menaxhim i mirëfinancuar dhe i qëndrueshëm i burimeve financiare për të siguruar realizimin efektiv të strategjive dhe objektivave të ndërkombëtarizimit.

7. Kpi dhe monitorimi

Tabela 5 KPI dhe monitorimi

NR	Aktiviteti / Masa	Tregues Kryesor i Performancës (KPI)	Metoda e Monitorimit
1	O1.A1. Nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale për shkëmbim studentor dhe stafi, projekte kërkimore të përbashkëta dhe mundësi të tjera bashkëpunimi.	Numri i marrëveshjeve të nënshkruara.	Raportim nga Koordinatori i Marrëdhënieve Ndërkombëtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

NR	Aktiviteti / Masa	Tregues Kryesor i Performancës (KPI)	Metoda e Monitorimit
2	O1.A2. Krijimi i mundësive për studentët për të ndjekur programe të diplomave të dyfishta me universitete të huaja.	Numri i studentëve që ndjekin programe të diplomës së dyfishtë.	Raportim nga Përgjegjësi i Departamentit
3	O1.A3. Aktivizimi i lidhjeve ndërkombëtare për të rritur vizibilitetin dhe reputacionin e departamentit dhe universitetit.	Numri i ngjarjeve promovuese ndërkombëtare të organizuara.	Raportim nga Koordinator i Marketingut dhe Promovimit.
4	O2.A1. Angazhimi në projekte kërkimore që financohen nga organizata ndërkombëtare për të promovuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe për të forcuar kapacitetet kërkimore.	Numri i projekteve kërkimore të financuara ndërkombëtarisht.	Raportim nga Koordinator i Kërkimit dhe Projektet Kërkimore.
5	O2.A2. Angazhimi në hulumtime që adresojnë çështje globale, si zhvillimi i qëndrueshëm, ndryshimet klimatike, dhe ekonomia globale.	Numri i projekteve kërkimore që adresojnë çështje globale.	Raportim nga profesorët e angazhuar.
6	O3.A1. Përditësimi dhe rritja e cilësisë së programeve të studimit për të përmbushur kërkesat e tregut global dhe për të pasur një strukturë që është tërheqëse për studentët ndërkombëtarë.	Numri i programeve të përditësuara Rritja e regjistrimeve të studentëve ndërkombëtarë në programet e reja..	Raportim nga Koordinator i Kurrikulave Akademike. Raportim nga Përgjegjësi i Departamentit
7	O3.A2. Ofrimi i programeve të studimit, sidomos në anglisht, për të tërhequr studentë nga vende të ndryshme dhe për të mundësuar studentëve vendas të marrin një formim të orientuar ndërkombëtarisht.	Numri i programeve të studimit në anglisht. Rritja e numrit të studentëve ndërkombëtarë dhe regjistrimeve në këto programe.	Raportim nga Përgjegjësi i Departamentit Raportim nga Përgjegjësi i Departamentit
8	O4.A1. Sigurimi që mësimdhënia dhe kërkimi të jenë në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe standardet e arsimit të lartë.	Pjesëmarrja e stafit në trajnime dhe programe profesionale.	Monitorimi i vlerësimeve dhe auditimeve të cilësisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

NR	Aktiviteti / Masa	Tregues Kryesor i Performancës (KPI)	Metoda e Monitorimit
9	O5.A1. Nxitja e pjesëmarrjes së stafit dhe studentëve në aktivitete akademike ndërkombëtare për të shpërndarë njohuri, për të krijuar lidhje profesionale dhe për të kontribuar në diskutimet shkencore globale	Numri i stafit dhe studentëve të angazhuar në aktivitete ndërkombëtare. Numri i publikimeve dhe kontribuimeve në aktivitete ndërkombëtare.	Raportim nga Koordinatori i Mobilitetit dhe Aktivitetet Akademike. Pjesëmarrja dhe kontributet e stafit dhe studentëve në aktivitete ndërkombëtare.
10	O6.A1. Rritja e numrit të studentëve ndërkombëtarë nga vende të tjera për të krijuar një mjedis më të larmishëm dhe për të rritur mundësitë për shkëmbim kulturor.	Numri i studentëve ndërkombëtarë të regjistruar.	Raportim nga Prergjegjesi i Departamentit

8. Struktura e zbatimit dhe përgjegjësitë

Struktura e monitorimit të aktiviteteve të ndërkombëtarizimit në Departamentin e Shkencave Ekonomike të Fakultetit të Biznesit, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës është e ndarë në disa nivele dhe përfshin raportime të rregullta nga individët përgjegjës për secilin aspekt të strategjisë. Koordinatori i Marrëdhënieve Ndërkombëtare është përgjegjës për monitorimin dhe raportimin mbi marrëveshjet bilaterale dhe mundësitë e bashkëpunimit me universitete dhe organizata ndërkombëtare. Ai do të përgatitë raportime të rregullta mbi nënshkrimin e marrëveshjeve të reja dhe aktivitetet e përbashkëta, duke siguruar transparencë dhe monitorim të vazhdueshëm të partneriteteve. Po ashtu, Koordinatori i Marketingut dhe Promovimit do të sigurojë një raportim mbi aktivitete promovuese ndërkombëtare, duke monitoruar përpjekjet për rritjen e vizibilitetit të departamentit dhe universitetit, dhe vlerësuar ndikimin e aktiviteteve në reputacionin ndërkombëtar.

Ndërkohë, përgjegjësitë e monitorimit përfshijnë gjithashtu raportime nga Koordinatori i Kërkimit dhe Projektet Kërkimore, i cili do të mbikëqyrë realizimin e projekteve kërkimore ndërkombëtare dhe angazhimin në financime ndërkombëtare, si dhe do të raportojë për numrin e projekteve të përfunduara dhe fondeve të siguruar. Koordinatori i Kurrikulave Akademike do të sigurojë përditësimin e kurrikulave dhe do të raportojë për numrin e programeve të reja të ofruara dhe angazhimin në përputhje me standardet ndërkombëtare. Përgjegjësi i Departamentit do të udhëheqë procesin e monitorimit dhe do të përgatisë raportime periodike për përmbushjen e objektivave strategjike, duke vlerësuar gjithashtu ndikimin e këtyre aktiviteteve në cilësinë akademike dhe kërkimore. Të gjitha këto raportime do të kontribuojnë në një sistem të integruar monitorimi, që siguron transparencë dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

përmbyshje të standardeve të kërkuara, duke ndihmuar në përcaktimin e nevojave për përmirësim të vazhdueshëm.

9. Menaxhimi i riskut

Në versionin akademik, rreziqet e procesit të ndërkombëtarizimit lidhen kryesisht me aspekte institucionale, financiare dhe akademike. Një nga rreziqet kryesore është mungesa e partnerëve strategjikë ndërkombëtarë, që mund të kufizojë mundësitë për bashkëpunime, projekte të përbashkëta dhe mobilitet akademik. Ky problem mund të ndikojë drejtpërdrejt në mundësitë për zhvillimin e aktiviteteve ndërkombëtare dhe për përmirësimin e kurrikulave. Për të parandaluar këtë, është e nevojshme krijimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe zgjerimi i rrjetit të partnerëve. Si plan alternativ, konsiderohet identifikimi i partnerëve të rinj, duke përfshirë rajonin dhe hapësirën evropiane, që mund të ofrojnë mundësi të reja për zhvillimin e bashkëpunimeve dhe projekteve të përbashkëta.

Një tjetër rrezik i rëndësishëm është financimi i pamjaftueshëm për projektet ndërkombëtare, i cili mund të ndikojë drejtpërdrejt në zbatimin e aktiviteteve të planifikuara. Pa një mbështetje financiare adekuate, është e vështirë të realizohen iniciativat dhe të sigurohen mundësi për mobilitetin e studentëve dhe stafit, si dhe për zhvillimin e projekteve kërkimore. Për të adresuar këtë rrezik, departamenti synon të aplikojë për financime nga programe ndërkombëtare si Erasmus+ dhe Horizon Europe, të cilat ofrojnë mundësi të rëndësishme për bashkëpunim dhe mbështetje financiare.

Një tjetër grup rrezikesh lidhet me faktorët njerëzorë, si pjesëmarrja e ulët e stafit dhe studentëve në aktivitetet ndërkombëtare, si dhe barrierat gjuhësore dhe kulturore. Këto rreziqe mund të pengojnë zhvillimin e shkëmbimeve dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare, duke ndikur negativisht në efektivitetin e programeve të mobilitetit dhe integrimin ndërkulturor. Për të adresuar këto sfida, departamenti ka parashikuar të ofrojë programe studimi në anglisht që tashmë është bërë një gjuhë e përdorur ndërkombëtarisht, ofrimi i incentivave akademike për pjesëmarrjen në aktivitete ndërkombëtare dhe promovimi i mundësive të mobilitetit. Këto masa synojnë të lehtësojnë integrimin ndërkombëtar dhe të rrisin angazhimin e stafit dhe studentëve. Në përgjithësi, Departamenti i Shkencave Ekonomike qaset ndaj menaxhimit të riskut duke identifikuar paraprakisht sfidat dhe duke implementuar masa konkrete për minimizimin e ndikimit të tyre, duke siguruar kështu suksesin e strategjisë së ndërkombëtarizimit dhe forcimin e pozicionit të departamentit në arenën akademike ndërkombëtare.

Tabela 6 Monitorimi i rrezikut

Nr	Rreziku	Probabiliteti	Ndikimi	Masa parandaluese	Plani B
1	Refuzimi i aplikimeve	Mesatar	Lartë	Përmirësim i cilësisë së aplikimeve	Ri-aplikim në thirrjet e ardhshme



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

	Erasmus+				
2	Numër i ulët aplikimesh nga studentët	Mesatar	Mesatar	Promovim dhe informim	Zgjatje e afateve dhe mbështetje
3	Probleme me njohjen e krediteve	Ulët	Lartë	Marrëveshje të qarta akademike	Rishikim manual i ekuivalencës
4	Probleme administrative	Mesatar	Mesatar	Trajnime për stafin administrativ	Mbështetje nga zyra ndërkombëtare
5	Anulime mobiliteti	Mesatar	Mesatar	Planifikim fleksibël	Zëvendësim me kandidatë të tjerë
6	Probleme financiare	Ulët	Lartë	Menaxhim i mirë i fondeve	Përdorimi i rezervave
7	Probleme me vizat	Ulët	Mesatar	Mbështetje dokumentacioni	Ndryshim destinacioni
8	Mungesë partnerësh aktivë	Mesatar	Lartë	Zgjerim i rrjetit	Partnerë alternativë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

Departamenti i statistikës dhe informatikës së zbatuar

1. Baza ligjore dhe dokumentet referuese

Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar zhvillon veprimtarinë e tij akademike dhe organizative në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me Statutin e Universitetit, si dhe me Rregulloren e Fakultetit të Biznesit. Ndërkombëtarizimi është tashme një proces ku një fokus të veçantë i kushtohet zhvillimit të kompetencave ndërkulturore, mendimit kritik dhe aftësive profesionale të studentëve, duke i përgatitur ata për të operuar me sukses në një treg pune gjithnjë e më të globalizuar dhe konkurrues.

Nëpërmjet kësaj Strategjie, Departamenti synon gjithashtu të rrisë përfshirjen e tij në projekte ndërkombëtare kërkimore dhe zhvillimore, në ndërkombëtarizimin e programeve akademike dhe forcimin e partneriteteve me institucione vendase dhe të huaja. Kjo strategji hartohet duke u bazuar në dokumentat e mëposhtme të cilat përbëjnë bazën ligjore dhe operative të kësaj strategjie :

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr. 80, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore të dalë në zbatim të tij;
- Statutin (miratuar me urdhër nr. 385, datë 09.07.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë) Rregulloren (miratuar me Vendimin nr. 154, datë 26.11.2018 të Senatit Akademik) të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD);
- Rregulloren e Brendshme të Drejtorisë së Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë (miratuar me Vendimin nr. 5, datë 17.01.2020 të Senatit Akademik),
- Strategjinë e Ndërkombëtarizimit STRATEGJIA E NDËRKOMBËTARIZIMIT 2025-2030
- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; Rregulloren financiare të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës
- Rregulloren e Fakultetit të Biznesit
- Rregulloren e Departamentit të Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

2. Qëllimi i strategjisë së departamentit

Qëllimi i strategjisë së Ndërkombëtarizimit të Departamentit konsiston në konsolidimin e një njësie akademike cilësore dhe konkurruese, e orientuar drejt mësimdhënies bashkëkohore, kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit me tregun e punës në përputhje me vizionin e Fakultetit të Biznesit dhe të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës. Ky vizion synon të ndërtojë një strukturë akademike që udhëheq studentët në mënyrë të përgjegjshme dhe etike, duke i pajisur me kompetenca të avancuara profesionale që të kontribuojnë me vlera të prekshme në tregun e punës.

Një dimension i pandashëm i vizionit të Departamentit qëndron në ndërkombëtarizimin e programeve akademike dhe forcimin e partneriteteve me institucione vendase dhe të huaja, në funksion të avancimit të cilësisë dhe konkurrueshmërisë shkencore. Realizimi i këtij vizioni synon që Departamenti të ofrojë programe studimi të standardeve të larta, bashkëkohore dhe tërheqëse për brezat e studentëve, të cilët do të zgjedhin të ndjekin Fakultetin e Biznesit, dhe që këto programe të kontribuojnë në mënyrë substanciale në zhvillimin ekonomik dhe social të komunitetit të Durrësit, të Republikës së Shqipërisë dhe Integrimit Europian.

Qëllimet specifike:

Në funksion të realizimit të qëllimit të përgjithshëm për integrimin e dimensionit ndërkombëtar në të gjitha veprimtaritë akademike, kërkimore dhe institucionale, Departamenti synon të ndjekë një sërë qëllimesh specifike të strukturuar në mënyrë të ndërthurur dhe afatgjatë

- **Promovimi i stafit akademik** përmes garantimit të cilësisë dhe plotësimit të standardeve akademike në të tri ciklet e studimit, si dhe nxitjes, mbështetjes dhe forcimit të aktivitetit kërkimor shkencor të pedagogëve dhe studentëve, veçanërisht atyre që diplomohen si mënyrë për të avancuar kapacitetet njohëse dhe kontribuimin shkencor të departamentit.
- **Rritja e mobilitetit ndërkombëtar të studentëve dhe stafit akademik**, duke zgjeruar pjesëmarrjen në programe shkëmbimi si Erasmus+, marrëveshje dypalëshe dhe iniciativa të tjera evropiane dhe ndërkombëtare. Përmes mobilitetit, Departamenti synon të forcojë përvojën akademike dhe profesionale të studentëve, të rrisë ekspozimin e tyre ndaj praktikave më të mira ndërkombëtare dhe të nxisë shkëmbimin e njohurive dhe metodologjive bashkëkohore midis stafit akademik dhe institucioneve partnere.
- **Cilësia në mësimdhënie** përmes krijimit, transmetimit, zhvillimit dhe mbrojtjes së dijes, duke integruar në mënyrë sinergjike mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe shërbimet akademike; Përgatitja e specialistëve të nivelit të lartë në fushën e Shkencave Ekonomike mbështetet në programe mësimore bashkëkohore, të kualifikuara dhe të përshtatura me kërkesat e tregut të punës në Shqipëri dhe në kontekstin e vendeve perëndimore, në përputhje me standardet e cilësisë dhe relevancës akademike.
- Një qëllim tjetër thelbësor është **harmonizimi dhe ndërkombëtarizimi i kurrikulave**, duke



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

integruar në programet e studimit përmbajtje, standarde dhe praktika të njohura ndërkombëtarisht. Kjo përfshin përditësimin e syllabuseve në përputhje me zhvillimet globale në menaxhimin e turizmit, turizmin e qëndrueshëm, dixhitalizimin e industrisë së mikpritjes dhe menaxhimin e destinacioneve. Në këtë mënyrë, Departamenti synon të sigurojë që diplomat e ofruara të jenë konkurruese dhe të krahasueshme në hapësirën evropiane dhe më gjerë.

- Pjesëmarrja e stafit akademik në *projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare* identifikohet si një prioritet strategjik, duke inkurajuar angazhimin e pedagogëve në iniciativa kërkimore brenda dhe jashtë vendit, si një mekanizëm për rritjen e ekspertizës kërkimore, zhvillimin e rrjeteve bashkëpunuese dhe adresimin e problematikave socio-ekonomike në nivel lokal dhe më gjerë.
- *Integrimi i Departamentit në ekonominë rajonale dhe sektorin e biznesit*, përmes bashkëpunimit me autoritetet vendore dhe sektorin privat për identifikimin e kërkesës për profesionistë ekonomikë dhe përshtatjen dinamike të programeve mësimore, si dhe për të promovuar aftësimin praktik të studentëve dhe të diplomuarve, duke forcuar lidhjet me tregun e punës dhe institucionet publike

3. Ndërkombëtarizimi, gjendja aktuale

Përshkrimi i Departamentit të Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar

Departamenti është pjesë e Fakultetit të Biznesit në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, institucion publik i arsimit të lartë i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Nr. 801, datë 20.12.2005 "Për hapjen e Universitetit "Aleksandër Moisiu" në Durrës". Për herë të parë Departamenti hapi dyert për studentët në vitin akademik 2023-2024.

Stafi akademik i Departamentit të Shkencave Ekonomike karakterizohet nga një profil profesionalisht, i gatshëm për të përballuar me efikasitet ngarkesën mësimore të shoqëruar me angazhime kërkimore dhe pjesëmarrje në forumet shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Përmes menaxhimit të kujdesshëm dhe me përgjegjshmëri të lartë të procesit mësimor, Departamenti mbështet realizimin e programeve akademike në tre ciklet e studimit: Bachelor, Master Shkencor dhe Doktoraturë, duke synuar standarde të larta cilësore dhe rezultate të matshme të të nxënit. Procesi mësimor i Departamentit mbështetet në kurrikula bashkëkohore, të hartuara dhe të përditësuara nga vetë pedagogët, në përputhje me zhvillimet e fundit në literaturën dhe praktikën akademike, si dhe në objektivat strategjike të programit arsimor. Këto kurrikula synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe përgatitjen e studentëve për sfidat e tregut të punës dhe kërkesat e zhvillimit ekonomik.

Departamenti ofron programe në dy cilke të arsimit të lartë: Bachelor në "Informatika Ekonomike" dhe Doktoraturë në "Shkenca Ekonomike". Mësimdhënia bazohet në kurrikula bashkëkohore, hartuar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

nga stafi vetë, të cilat rifreskohen rregullisht për të përfshirë literaturë dhe tematika që reflektojnë kërkesat dhe zhvillimet ndërkombëtare të fushës.

- Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Informatika Ekonomike" i ofruar nga Universiteti "Aleksandër Moisiu", Fakulteti i Biznesit, Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar është hapur në vitin akademik 2023 – 2024 me Vendimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr 4525/1Prot, datë 14.07.2023 dhe riorganizuar sipas VKM Nr 685, datë 25.08.2010 "Për Riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës¹.
- Programi i studimit të Ciklit të Tretë Doktoraturë në "Shkenca Ekonomike" i ofruar nga Universiteti "Aleksandër Moisiu", Fakulteti i Biznesit, Departamenti i Shkencave Ekonomike është rihapur në vitin akademik 2021-2022 me Vendimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr.134 datë 17.03.2024 "Për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të tretë nga Doktoratë në "Shkencat Ekonomike" në Doktoratë në "Shkenca Ekonomike" me Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës.

Në fushën e kërkimit shkencor, Departamenti ka treguar nivel të lartë fleksibiliteti dhe përkushtimi, duke marrë pjesë aktivisht në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe duke kontribuar me botime në revista të fushës. Këto aktivitete kanë kontribuar në rritjen e profilit akademik dhe njohjen e arritjeve të Departamentit në shkallë kombëtare dhe më gjerë. Përpjekjet e vazhdueshme të stafit janë reflektuar në arritjen e titujve dhe gradave shkencore të avancuara, si dhe në zgjerimin e kontributit akademik dhe kërkimor. Aktualisht në departament: 1 anëtar me titullin "Profesor" 3 anëtarë me titullin "Profesor i Asociuar" dhe 3 anëtarë mbajnë gradën "Doktor". Puna e anëtarëve të Departamentit, është punë intensive dhe e përgjegjshme individuale dhe në grup, në ndihmë të komunitetit studentor dhe atij akademiko-shkencor dhe politikbërës.

Partneritetet dhe bashkëpunimet me universitete të tjera

Partneritetet dhe bashkëpunimet me universitete të tjera luajnë një rol thelbësor në forcimin e kapaciteteve akademike, kërkimore dhe mësimore të një departamenti apo institucioni të arsimit të lartë. Këto bashkëpunime sjellin përfitime të shumta të dokumentuara në praktikën ndërkombëtare të arsimit të lartë:

- *Përforsim i cilësisë akademike dhe mësimore* Bashkëpunimet me institucione partnere mundësojnë shkëmbimin e praktikave të suksesshme në mësimdhënie, materiale mësimore, metodologji të avancuara dhe qasje pedagogjike inovative, duke kontribuar kështu në rritjen e cilësisë së programeve akademike dhe përvojës së studentëve.

¹ VKM Nr. 685 datë 25.08.2010; "Për Riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

- *Rritje e kapaciteteve kërkimore dhe impaktit shkencor.* Bashkëpunimet ndëruniversitare lehtësojnë krijimin e projekteve kërkimore të përbashkëta, publikimeve të përbashkëta dhe aplikimin për fonde ndërkombëtare të kërkimit, duke zgjeruar qasjen në resurse, të dhëna dhe ekspertizë të specializuar.
- *Ndërkombëtarizim dhe globalizim i arsimit.* Partneritetet janë një shtyllë kyçe e strategjive të ndërkombëtarizimit, duke integruar universitetin në rrjete ndërkombëtare, duke zgjeruar ndikimin dhe duke përgatitur studentë me vizion global, të aftë për të funksionuar në një treg pune ndërkombëtar.

Aktualisht Fakulteti i Biznesit ka krijuar ura bashkëpunimi me disa Universitete si: Universiteti i La Laguna (ULL), Spanjë, Universiteti La Sapienza në Romë, Universitetin e Ankonës etj. Departamenti i Shkencave Ekonomike synon që brenda vitit 2027 të sigurojë nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi me një universitet partner për implementimin e një programi dual akademik, në funksion të zhvillimit të modelit të mësimdhënies dhe të rritjes së cilësisë së përgatitjes profesionale të studentëve.

Mobiliteti i stafit akademik

Mobiliteti i stafit akademik sjell një sërë përfitimesh të rëndësishme për nivelin individual të pedagogëve dhe për institucionet e arsimit të lartë në të cilat ata angazhohen. Në përgjithësi, mobiliteti i stafit akademik është një instrument i fuqishëm për të zhvilluar kapacitetet akademike, për të forcuar cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit, për të zgjeruar bashkëpunimet ndërkombëtar. Disa nga përfitimet kryesore që sjell mobiliteti i stafit akademik janë:

- Përmirësimi i praktikave mësimore dhe metodave të mësimdhënies
- Zhvillimi i kompetencave profesionale dhe personale
- Rritja e bashkëpunimit dhe rrjetëzimit ndërkombëtar
- Kontributi në strategjitë e ndërkombëtarizimit të institucionit

Mobilitetet e realizuara gjatë 3 viteve të fundit janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

N	Eme	Mbieme	Departament	Universitet	Shteti	Viti	Mesimdhënie/trajni
						akademik	
r	r	r	i	i Prites	Spanje	2024-20	m
1	Altin	Gjini	SIZ	i Cordoba	i	25	Trajnim

Pjesëmarrje në projektet kombëtare dhe ndërkombëtare

Të dhëna mbi Pjesëmarrjen në projekte Kombëtare dhe Ndërkombëtare



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

Departamenti i Shkencave Ekonomike

Nr.	Lektori	Emërtimi i Projektit	Kombëtar / Ndërkomb	Financuesi	Afati
1.	Altin Gjini	STARS EU	Ndërkombëtar	EU	18 Muaj
		SAMESEA	Ndërkombëtar	EU	18 muaj
		TBEAI	Ndërkombëtar	EU	18 muaj
		Rrjeti Nderkombetar per Kerkim dhe Edukim Financiar Bluecosystem	Kombetar	UAMD	18 muaj
2.	Brunela Trebicka		Nderkombëtar	EU	2024-2026
		BECCE	Nderkombëtar	EU	18 muaj
		TBEAI	Ndërkombëtar	EU	18 muaj
		Strategjitë për nxitjen e bizneseve të reja në sektorin e Ekonomisë Qarkulluese në Shqipëri (START4CE-A1)	Kombëtar	AKKSHI	2024-2025
3.	Llambi Prendi	Ndikimi i Turizmit në Mjedisin Natyror: ndërlidhja Turizëm – Mjedis – Rritje Ekonomike në Shqipëri	Kombëtar	UAMD	
		Studim mbi përputhshmërinë e kërkesës dhe ofertës për punësimin e të rinjve në Qarkun e Durrësit	Kombëtar	UAMD	2023-2024
		Përdorimi i teknologjisë miqësore si një faktor i rëndësishëm në industrinë e turizmit të gjelbert	Kombetar	AKSHI	18 MUAJ

4. Objektivat strategjike 2025–2030

OS1. Objektiva Akademike: Modernizimi i kurrikulave sipas standardeve të BE dhe tregut të punës dhe rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe përmbajtjes akademike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

Modernizimi i kurrikulave përbën themelin e zhvillimit akademik dhe garanton përputhshmërinë e programeve të studimit me standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA). Në kushtet e transformimeve të shpejta ekonomike, digjitalizimit dhe tranzicionit drejt ekonomisë së gjelbër, është e domosdoshme që përmbajtja akademike të reflektojë zhvillimet bashkëkohore teorike dhe praktike. Harmonizimi i kurrikulave me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (EQF), me standardet e sigurimit të cilësisë dhe me praktikën më të mira të universiteteve evropiane kontribuon në rritjen e transparencës dhe krahësueshmërisë së diplomave.

Rishikimi i përmbajtjes mësimore duhet të bazohet në analizën e nevojave të tregut të punës, duke përfshirë kompetenca profesionale, aftësi digjitale, mendim kritik dhe etikë profesionale. Integrimi i metodave bashkëkohore të mësimdhënies, si mësimi i bazuar në projekte (project-based learning), studimet e rasteve ndërkombëtare dhe përdorimi i platformave digjitale, rrit cilësinë e procesit mësimor. Për më tepër, përfshirja e ekspertëve nga sektori publik dhe privat në hartimin e programeve garanton lidhjen e drejtpërdrejtë midis teorisë dhe praktikës.

Në këtë kuadër, OS1 synon jo vetëm përditësimin formal të syllabuseve, por transformimin e plotë të qasjes pedagogjike drejt një modeli student-centered learning, i cili nxit autonominë akademike, analizën kritike dhe aplikimin praktik të njohurive ekonomike.

OS2 Objektiva Kërkimore: Rritja e publikimeve shkencore dhe projekteve kërkimore mbi zhvillimin ekonomik, financat publike dhe tregjet e gjelbra.

Zhvillimi i kërkimit shkencor përbën një nga treguesit kryesorë të cilësisë dhe reputacionit akademik të një departamenti universitar. Rritja e publikimeve në revista të indeksuara ndërkombëtare (Scopus, Web of Science) kontribuon në forcimin e profilit shkencor dhe në rritjen e ndikimit institucional në debatin akademik. Në veçanti, fokusimi në tema si zhvillimi ekonomik, financat publike dhe ekonomia e gjelbër reflekton prioritetet aktuale të politikave evropiane dhe globale.

Zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm, menaxhimi i financave publike dhe tranzicioni drejt tregjeve të gjelbra janë fusha me rëndësi strategjike për ekonominë në zhvillim dhe për procesin e integritit evropian. Përmes projekteve kërkimore ndërdisiplinore dhe aplikimeve në programe financimi kombëtare dhe ndërkombëtare, departamenti mund të kontribuojë në prodhimin e njohurive që kanë ndikim real në hartimin e politikave publike.

Ky objektiv kërkon krijimin e grupeve kërkimore tematike, mentorimin e stafit të ri akademik dhe zhvillimin e kulturës së bashkëpunimit shkencor. Gjithashtu, nxitja e bashkëpunimit me institucione publike dhe organizata ndërkombëtare rrit relevancën praktike të kërkimit dhe forcon lidhjen midis universitetit dhe shoqërisë.

OS3 Objektiva Shoqërore: Organizimi i konferencave, forumeve dhe aktiviteteve që lidhin studentët me institucionet publike dhe bizneset si edhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitutional.

Roli i universitetit nuk kufizohet vetëm në transmetimin e njohurive, por shtrihet edhe në kontribuimin aktiv në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik. Organizimi i konferencave shkencore, forumeve ekonomike dhe tryezave të rrumbullakëta krijon një hapësirë dialogu midis akademisë, institucioneve publike dhe sektorit privat. Këto aktivitete nxisin shkëmbimin e ideve, prezantimin e rezultateve kërkimore dhe aplikimin praktik të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

Përfshirja e studentëve në aktivitete të tilla rrit ndërgjegjësimin profesional dhe krijon mundësi për rrjetëzim (networking) dhe orientim karriere. Bashkëpunimi me ministri, banka, institucione financiare dhe biznese private kontribuon në zhvillimin e praktikave profesionale dhe projekteve të përbashkëta. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional, si në nivel kombëtar ashtu edhe rajonal, krijon sinergji akademike dhe rrit kapacitetin për projekte të përbashkëta. Në këtë kuadër, OS3 synon konsolidimin e departamentit si një qendër aktive e debatit ekonomik dhe e ndikimit shoqëror.

OS4 Objektiva Ndërkombëtare: Zgjerimi i partneriteteve me universitete evropiane dhe pjesëmarrja në projekte Erasmus+ dhe të tjera.

Ndërkombëtarizimi përbën një dimension strategjik për rritjen e cilësisë dhe reputacionit institucional. Zgjerimi i partneriteteve me universitete evropiane krijon mundësi për mobilitet akademik, projekte të përbashkëta kërkimore dhe zhvillim të programeve të përbashkëta studimore. Pjesëmarrja aktive në programe si Erasmus+ forcon integrimin e departamentit në rrjetet akademike evropiane.

Partneritetet ndërkombëtare nuk duhet të jenë vetëm formale, por të bazohen në interesa të përbashkëta kërkimore dhe akademike. Bashkëpunimet strategjike mund të çojnë në zhvillimin e programeve të përbashkëta (joint degrees), shkëmbime të stafit dhe organizim aktivitetsesh të përbashkëta shkencore.

Ky objektiv kontribuon në rritjen e dukshmërisë ndërkombëtare, përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit, si dhe në rritjen e atraktivitetit të departamentit për studentë vendas dhe të huaj. Në planin afatgjatë, ndërkombëtarizimi shërben si mekanizëm për integrimin e plotë të departamentit në hapësirën akademike evropiane.

4.1 Fushat e ndërhyrjes dhe masat kryesore

1. Mobiliteti i Studentëve

Mobiliteti i studentëve përbën një nga instrumentet kryesore të ndërkombëtarizimit, duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave akademike, ndërkulturore dhe profesionale dhe synon rritjen e numrit të studentëve që marrin pjesë në shkëmbime semestrale, praktika ndërkombëtare dhe programe intensive në universitete partnere.

Masat kryesore

- Hartimi i marrëveshjeve bilaterale me universitete të BE-së dhe rajonit.
- Rritja e pjesëmarrjes në programet Erasmus+, CEEPUS dhe programe të tjera mobiliteti.
- Njohja automatike e krediteve ECTS për studentët në mobilitet.
- Krijimi i një zyre këshillimi për mobilitetin akademik.
- Ofrimi i bursave mbështetëse për studentët me mundësi të kufizuara ekonomike.

Këto masa do të ndikojnë në rritjen e ekspozimit ndërkombëtar të studentëve dhe përmirësimin e punësueshmërisë së tyre.

2. Mobiliteti i Stafit për Trajnime dhe Mësimdhënie



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

Mobiliteti i stafit akademik dhe administrativ synon transferimin e praktikave të mira, modernizimin e metodologjive të mësimdhënies dhe rritjen e kapaciteteve kërkimore.

Masat kryesore

- Pjesëmarrja e stafit në mobilitete Erasmus+ për mësimdhënie (STA) dhe trajnim (STT).
- Organizimi i vizitave studimore në universitete me performancë të lartë.
- Mbështetje financiare për pjesëmarrje në trajnime ndërkombëtare.
- Ftesa për profesorë vizitorë nga universitete partnere.

Këto ndërhyrje kontribuojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe në harmonizimin me standardet europiane.

3. Projektet Ndërkombëtare

Pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare përbën një dimension strategjik për rritjen e kapaciteteve institucionale dhe financiare.

Masat kryesore

- Aplikimi në projekte Erasmus+ Capacity Building, Horizon Europe, Jean Monnet etj.
- Krijimi i një njësie për menaxhimin e projekteve ndërkombëtare.
- Trajnimi i stafit në shkrimin dhe menaxhimin e projekteve.
- Partneritete strategjike me universitete dhe institucione kërkimore.

Këto masa rrisin reputacionin akademik dhe ndikimin shkencor të departamentit.

4. Programet e Përbashkëta dhe Diploma Dyfishe

Programet e përbashkëta dhe diplomat e dyfishta përfaqësojnë nivelin më të avancuar të bashkëpunimit akademik ndërkombëtar, gjë të cilën së fundmi po tentojmë ta realizojmë edhe mes aleatëve të Stars EU, por edhe me Universitete të tjera me të cilët kemi marrëveshje bashkëpunimi. Hartimi i kurrikulave të harmonizuara me universitete partnere.

- Nënshkrimi i marrëveshjeve për diploma të dyfishta në fushën e shkencave Ekonomike, Ekonomi Biznesit dhe Ekonomisë Qarkulluese.
- Krijimi i komisioneve të përbashkëta akademike.
- Sigurimi i akreditimit sipas standardeve ndërkombëtare.

Kjo rrit atraktivitetin e programit dhe prestigjin akademik.

5. Ndërkombëtarizimi në Kurrikul

Ndërkombëtarizimi në kurrikul synon integrimin e dimensionit ndërkombëtar në përmbajtjen akademike. Tregon aftësinë e një institucioni për të krijuar ura lidhëse më të afërta me vendet e zhvilluara duke integruar studimet, programet, studentët dhe stafi akademik.

Masat kryesore

- Ofrimi i lëndëve në gjuhë të huaj (anglisht).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

- Integrimi i studimeve krahasuese europiane dhe globale.
- Përfshirja e literaturës ndërkombëtare në syllabuse.
- Përdorimi i metodologjive moderne (case studies ndërkombëtare, simulime, projekte ndërkulturore).

Kjo ndihmon në zhvillimin e kompetencave globale të studentëve.

6. Kërkimi Shkencor dhe Botimet me Bashkëautorë

Rritja e bashkëpunimit kërkimor ndërkombëtar përmes publikimeve të përbashkëta nxit përkushtimin, rrit standartin, sjell bashkëpunim dhe shkëmbim idesh dhe eksperiencash.

Masat kryesore

- Krijimi i grupeve kërkimore ndërkombëtare.
- Nxitja e publikimeve në revista me indeksim Scopus dhe Eeb of Science.
- Financim për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare.
- Marrëveshje bashkëpunimi për projekte kërkimore të përbashkëta.

Këto masa rrisin citueshmërinë dhe ndikimin akademik.

7. Krijimi i Konferencave dhe Workshopeve Ndërkombëtare

Organizimi i aktiviteteve shkencore me pjesëmarrje ndërkombëtare. Departamenti I shkencave ekonomike ka qënë gjithmonë aktiv në aktivitetet e kërkimit shkencor dhe ka bashkëpunuar edhe me departamentet e tjera me qëllim mbarëvajtjen e aktiviteteve shkencore dhe vazhdimësinë e punës së përbashkët.

Masat kryesore

- Organizimi i konferencës vjetore ndërkombëtare në ekonomi.
- Ftesa për keynote speakers nga universitete prestigjioze.
- Publikimi i proceeding-eve me ISBN/ISSN.
- Organizimi i workshop-eve tematike mbi Ekonomiksin publik, politikat ekonomike, ekonominë e gjelbër etj.

Kjo e pozicionon departamentin si qendër referimi akademik.

8. Marketing dhe Komunikim Ndërkombëtar

Rritja e dukshmërisë ndërkombëtare të departamentit ka lidhje me faktin e paraqitjes së cdo rezultati të departamentit në rrjetet sociale. Kjo gjë mundëson shpërndarjen e informacionit të duhur për informim, tërheqjen e studentëve të rinj dhe vendosje komunikimi me studentët aktual.

Masat kryesore

- Përditësimi i faqes zyrtare në gjuhën angleze.
- Prezencë aktive në rrjete akademike (ResearchGate, LinkedIn).
- Publikimi i raporteve vjetore në anglisht.
- Promovimi i sukseseve akademike në media ndërkombëtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

Kjo rrit atraktivitetin për studentë dhe partnerë të huaj.

9. Mbështetje për Studentët e Huaj

Sigurimi i integritetit akademik dhe social të studentëve ndërkombëtarë të cilët zgjedhin të vijnë e studiojnë në programet e studimit të departamentit tonë, me qëllim që të ndjejnë frymën e bashkëpunimit social dhe shkencor në çdo ditë të tyre të qëndrimit.

Masat kryesore

- Krijimi i një "International Student Desk".
- Program mentorimi nga studentë vendas.
- Ofrimi i kurseve të gjuhës shqipe dhe orientimit kulturor.
- Mbështetje administrative për akomodim dhe dokumentacion.

Këto masa garantojnë përvojë pozitive akademike dhe rrisin reputacionin institucional.

Bottom of Form

4.2 Plani i veprimit (Action Plan)

Për të hartuar një plan veprimi 5 vjeçar me tematike kryesor ndërkombëtarizimin e departamentit duhen mbajtur parasysh së pari programet e studimit që ofron departamenti dhe mundësitë që ato kanë për të krijuar bashkëpunime. Për të paraqitur kurikulën sa më bashkëkohore është e nevojshme përditësimi i saj për të përfshirë tema ose lëndë të cilat janë të kohës dhe të lidhura edhe me digjitalizimin edhe me ekonominë qarkulluese.

Departamenti ynë ju ofron studentëve siguri për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe orintimin e tyre drejt tregut të punës, e bashkëpunimin me Alumni për të shtuar mundësitë e bashkëpunimit përmes punësimit të studentëve dhe në të njëjtën kohë me marrëveshje e nënshkruar për kryerjen e praktikave studentore në banka, kompani konsulence apo institucione publike.

Githashtu këtu ndikojnë edhe aplikimet për projekte që mund të bëjë stafi i departamentit, mobilitetet duke shfrytëzuar marrëveshjet e institucionit, si edhe konferencat dhe workshope të ndryshme të cilat do të mundësonin jo vetëm shkëmbimin e mendimeve dhe kërkim shkencor, por edhe mobilitete dhe mundësi të reja bashkëpunimi.

Studentët e doktoraturës në bashkëpunim me udhëheqësit e tyre shkencorë nxiten të përfshihen në publikimin e punimeve të tyre shkencore apo në projektet për kërkim shkencor dhe zhvillim, Përmes projekteve që ka në vazhdim departamenti mund të krijojë edhe aktivitete në formë forumi apo takimi inovator me qëllim shkëmbimin e ideve, eksperiencave dhe krijimin e mundësive të reja.

Në mënyrë të përmbledhur po e paraqesim planin edhe me tabelë.

Plan aktivitetesh me focus te përqëndruar 2025–2030



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

NR	Aktiviteti / Masa	Afati	Përgjegjësi	Partnerët	Burime	Output / Rezultati
1	Rishikim i kurrikulave sipas standardeve të BE; organizimi i konferencave kombëtare mbi zhvillimin ekonomik	2025–2030	DSIZ; Komisioni i Kurrikulës	Universitetet lokale; Banka e Shqipërisë; Ministria e Arsimit	Burime njerëzore akademike; fonde nga buxheti institucional; financim nga projekte kombëtare	Kurrikula të harmonizuara me ECTS dhe standardet e BE; rritje e cilësisë së programeve; 1 konferencë kombëtare/vit; Leksione të hapura; publikime me ISBN/ISSN; raport vlerësimi periodik
2	Organizimi i praktikave profesionale; funksionalizimi i Qendrës së Karrierës; konkurse studentore	2025–2030	Departamenti; Zyra e Karrierës	Bankat; Dhoma e Tregtisë; kompani private; institucione publike	Marrëveshje bashkëpunimi; mentorë profesionalë; fonde për evente dhe konkurse	Minimumi 70% e studentëve të përfshirë në praktika; panairë karriere vjetore; rritje e punësueshmërisë; databazë alumnish dhe punëdhënësish
3	Shkëmbime studentore dhe staf; projekte Erasmus+; organizimi i konferencës ndërkombëtare	2025–2030	Departamenti; Koordinator i Marrëdhënieve Ndërkombëtare	BE; universitete evropiane; Agjencia Kombëtare Erasmus+	Fonde Erasmus+; buxhet për mobilitet; staf administrativ për menaxhim projektesh	Rritje 30–50% e mobilitetit; të paktën 2 projekte ndërkombëtare të fituara; konferencë ndërkombëtare vjetore; rritje bashkëpunimi akademik në rritje
4	Krijimi i mundësisë së laboratorit digjital ekonomik; rritja e publikimeve; projekte rajonale kërkimore	2025–2030	Departamenti; Grupi Kërkimor	INSTAT; AKKSHI; fondacione; universitete rajonale	Investim në pajisje IT dhe softëare statistikore; fonde kërkimore; trajnime për staf	Laborator funksional me softëare statistikore (SPSS, STATA, R); rritje e publikimeve në revista të indeksuara; projekte rajonale të financuara
5	Organizimi i Forumit Ballkanik	2025–2030	Departamenti; Zyra e Projekteve	Universitetet rajonale; kompani	Sponsorizime; fonde donatorësh;	Forum rajonal çdo 2 vite; rritje aktiv alumni; rritje e fondeve alternative;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

NR	Aktiviteti / Masa	Afati	Përgjegjësi	Partnerët	Burime	Output / Rezultati
	Ekonomik; krijimi i rrjetit Alumni; sigurimi i fondeve sponsorizuese			private; institucione financiare	platformë digjitale për alumni	forcim i reputacionit rajonal

5. Objektivat vjetore (2025-2030)

Objektivat Strategjike (OS)	Objektivat Vjetore (SMART)	Indikatorë të Matshëm	Afati / Viti
O1 – Objektiva Akademike	1. Përditësimi i kurrikulave mësimore sipas standardeve të BE dhe tregut të punës. 2. Realizimi i trajnimeve për mësimdhënie bashkëkohore për stafin akademik. 3. Zbatimi i një sistemi vlerësimi të brendshëm për cilësinë e mësimdhënies.	Numri i kurrikulave të harmonizuara Numri i trajnimeve të zhvilluar Raporti vjetor i vlerësimit	2025-2 0230
O2 – Objektiva Kërkimore	1. Publikimi i të paktën 5 artikujve shkencorë në revista të indeksuara. 2. Aplikimi për 2-3 projekte kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare. 3. Organizimi çdo vit i 1 workshop kërkimor	Numri i publikimeve të botuara Numri i aplikimeve të dorëzuara Numri i aktiviteteve të organizuara	2025-2 0230
O3 – Objektiva Shoqërore	1. Pjesëmarrja në Konferencës që zhvillohet çdo vit nga Fakulteti i Biznesit 2. Realizimi i 2 forume bashkëpunimi/tryeza të rumbullakta me institucione publike dhe biznese. 3. Zhvillimi i aktiviteteve praktike për studentët me partnerë nga biznesi.	Numri i pjesëmarrësve Numri i forumeve të zhvilluara Numri i aktiviteteve të implementuara	2025-2 0230
O4 – Objektiva Ndërkombëtare	1. Nënshkrimi i 1 marrëveshjeje bashkëpunimi ndërkombëtar me një universitet europian. 2. Sigurimi i pjesëmarrjes së stafit në të paktën	Numri i marrëveshjeve të nënshkruara Numri i	2025-2 0230



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

2 programe Erasmus+ (mobilitet staf/studentë).	pjesëmarrjeve të realizuara
3. Organizimi i 1 vizitë studimore ndërkombëtare për staf ose studentë.	Numri i vizitave të realizuara

6. Burimet financiare prioritetet dhe plani financiar 2025–2030

6.1 Korniza e Përgjithshme Financiare

Financimi i veprimtarisë së Departamentit të Shkencave Ekonomike për periudhën 2025–2030 do të mbështetet në:

- Buxhetin vjetor institucional (Fakultet/Universitet);
- Fondet e programit Erasmus+ (KA131 / KA171);
- Projekte kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Bashkëpunime me partnerë të industrisë dhe sponsorizime;
- Burime të tjera konkurruese dhe donacione.

Planifikimi financiar do të orientohet drejt realizimit të objektivave strategjike në fushën akademike, kërkimore, ndërkombëtare dhe të infrastrukturës.

6.2 Prioritizimi i Investimeve (2025–2030)

A. Prioritete Afatshkurtra (2025–2026)

Qëllimi: Konsolidimi i bazës akademike dhe rritja e kapaciteteve aplikative.

1. Përmirësimi i infrastrukturës teknologjike në auditorë
2. Mbështetje për mobilitet Erasmus+
3. Trajnime për shkrimin dhe menaxhimin e projekteve
4. Organizimi i workshopeve/tryezave të rumbullakta dhe aktiviteteve të tjera shkencore
- 5.

B. Prioritete Afatmesme (2027–2028)

Qëllimi: Rritja e konkurrueshmërisë akademike dhe ndërkombëtarizimit.

1. Krijimi Living Lab laborator
2. Zgjerimi i partneriteteve ndërkombëtare
3. Rritja e pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare
4. Certifikime profesionale për stafin
5. Digjitalizimi i moduleve dhe zhvillimi i moduleve në gjuhën angleze

C. Prioritete Afatgjata (2029–2030)

Qëllimi: Qëndrueshmëri financiare dhe profil i fortë kërkimor

1. Konsolidimi i laboratorit si qendër kërkimore dhe shërbimi për industrinë
2. Zhvillimi i projekteve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

3. Rritja e të ardhurave nga projekte dhe bashkëpunime me industrinë

4.

Plani Financiar Indikativ 2025–2030

Infrastrukturë dhe Pajisje

Kategoria	2025–2026	2027–2028	2029–2030	Burimi i Financimit
Pajisje teknologjike (pc)	Mesatar	—	—	Buxhet institucional
Laboratori Living Lab	—	I lartë	Mirëmbajtje	Buxhet + Projekte
Softuerë profesionalë & databaza	Mesatar	Mesatar	Mesatar	Buxhet + Projekte

Kërkimi Shkencor dhe Projekte

Kategoria	2025–2026	2027–2028	2029–2030	Burimi
Mbështetje për publikime	Mesatar	Mesatar	Mesatar	Buxhet
Aplikime për projekte	Mesatar	I lartë	I lartë	Projekte

Ndërkombëtarizimi dhe Mobiliteti

Kategoria	2025–2026	2027–2028	2029–2030	Burimi
Mobilitet studentor	I lartë	I lartë	I lartë	Erasmus+
Mobilitet stafit	Mesatar	I lartë	I lartë	Erasmus+
Guest lectures ndërkombëtare	Mesatar	Mesatar	Mesatar	Buxhet + Projekte

Zhvillimi i Kapaciteteve

Kategoria	2025–2026	2027–2028	2029–2030	Burimi
Trajnime për projekte	Mesatar	Mesatar	Mesatar	Buxhet + Projekte
Pjesëmarrje në	Mesatar	I lartë	I lartë	Projekte



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

konferenca

6.4 Mekanizmi i Monitorimit Financiar

- Planifikim vjetor në përputhje me buxhetin institucional;
- Raportim financiar vjetor në nivel Departamenti dhe Fakulteti;
- Monitorim i realizimit të investimeve sipas prioriteteve;
- Analizë periodike e raportit midis investimit dhe performancës (KPI).

7. Kpi dhe monitorimi

7.1 Ndërkombëtarizimi dhe Mobiliteti

Objektivi Strategjik	Treguesi (KPI)	Baseline (2024)	Target	Afati	Njësia Përgjegjëse	Instrumenti i Verifikimit
Rritja e ndërkombëtarizimit	Nr. studentëve në mobilitet dalës	2 studentë	≥ 3 studentë/vit	2025–2028	Koordinatori i Ndërkombëtarizimit	Raport Erasmus+, evidenca zyrtare
	Nr. studentëve në mobilitet hyrës	0–1	≥ 2 studentë/vit	2025–2028	Koordinatori i Ndërkombëtarizimit	Marrëveshje & regjistrime
	Nr. mobiliteteve të stafit	3 mobilitete	≥ 4 /vit	2025–2028	Përgjegjësi i Departamentit	Raport vjetor
	Nr. marrëveshjeve ndërkombëtare	3	≥ 5	2025–2027	Departamenti	Arkiva e marrëveshjeve

7.2 Projekte dhe Partneritet

Objektivi Strategjik	Treguesi (KPI)	Baseline e	Target	Afati	Njësia Përgjegjëse	Instrumenti i Verifikimit
Rritja e kapacitetit aplikues	Nr. aplikimeve për projekte	2/vit	≥ 2 /vit	2025–2028	Koordinatori i Projekteve	Dosje aplikimesh
	Nr. projekteve të fituara	1–2	≥ 2 aktive/vit	2025–2028	Departamenti	Kontrata projektesh



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

Nr. marrëveshjeve me industrinë	2-3	≥ 2	2025-2027	Përgjegjësi i Departamentit	Memorandume bashkëpunimi
Nr. aktiviteteve me aktorë të industrisë	1/vit	$\geq 1/vit$	2025-2028	Departamenti	Raporte aktiviteteve

7.3 Zhvillimi akademik dhe Kurrikular

Objektivi Strategjik	Treguesi (KPI)	Baselin e	Targe t	Afati	Njësia Përgjegjëse	Instrumenti i Verifikimit
Modernizimi i ofertës akademike	% moduleve në anglisht	<10%	$\geq 30\%$	2025-2028	Koordinatori i Cilësisë	Plani mësimor
	Nr. programeve me komponent ndërkombëtar	1	≥ 2	2025-2028	Departamenti	Vendime Senati
	Nr. guest lectures	2/vit	$\geq 4/vit$	2025-2028	Departamenti	Procesverbalet e aktiviteteve
	% studentëve në praktikë	75%	100% (prof.) $\geq 80\%$ (BA)	2025-2028	Koordinatori i Praktikave	Kontrata praktike

7.4 Kërkimi Shkencor

Objektivi Strategjik	Treguesi (KPI)	Baseline	Target	Afati	Njësia Përgjegjëse	Instrumenti i Verifikimit
Forcimi i profilit kërkimor	Nr. publikimeve shkencore	15 (3 vite)	≥ 20 (3 vite)	2025-2028	Stafi Akademik	Lista e publikimeve
	Publikime në revista të indeksuara	3/vit	$\geq 5/vit$	Vjetor	Departamenti	Database shkencore
	Bashkautorësi ndërkombëtare	1-2	$\geq 3/vit$	2025-2028	Stafi Akademik	Publikime



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

Nr. konferencave të organizuara	1/vit	≥ 2 /vit	2025–2028	Departamenti	Raporte aktivitetesh
Studentë të angazhuar në kërkim	5	≥ 5 /vit	2025–2028	Koordinatori i Kërkimit	Evidencë projektsh

7.5 Mekanizmi i Monitorimit

Elementi	Përshkrimi
Frekuenca e monitorimit	Semestrale për treguesit akademikë; Vjetore për mobilitet, projekte dhe kërkim
Forma e raportimit	Raport Vjetor i Departamentit; Analizë KPI; Prezantim në Këshillin e Fakultetit
Instrumente	Matrica KPI; analiza statistikore; anketime studentore; feedback nga partnerët

8. Struktura e zbatimit dhe përgjegjësitë

Për të garantuar një zbatim sa më të mirë strategjia mbështetet në një model gjithëpërfshirës:

- **Drejtuesi i Departamentit:** Mbikëqyr mbarëvajtjen e procesit të strategjisë së ndërkombëtarizimit
- **Koordinatorët e Programeve:** Monitorojnë ndërkombëtarizimin brenda programeve (mobiliteti, ECTS, modulet në anglisht).
- **Stafi Akademik (Gjithëpërfshirja):** Çdo anëtar i stafit angazhohet në të paktën një projekt ndërkombëtar ose dhe kontribuon në konferencën e përvitshme.
- **Studentët Ekselentë**
 - o **Promovimi:** Studentët me rezultate të larta do të angazhohen si "Ambasadorë të Ndërkombëtarizimit", duke asistuar në pritjen e studentëve të huaj dhe promovimin e mobilitetit.
 - o **Junior Researchers:** studentët do të trajnohen për shkrimin e artikujve shkencorë dhe pjesëmarrjen në konferenca, duke nxitur dëshirën për research në ët ardhmen
- **Bordi i Konferencës dhe Projekteve:** Koordinon organizimin e aktivitetit vjetor dhe aplikimet në Erasmus+ dhe Projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

9. Menaxhimi i riskut

Tabela e menaxhimit të riskut për strategjinë e ndërkombëtarizimit të Departamentit paraqet një analizë të strukturuar të rreziqeve kryesore që mund të ndikojnë në realizimin me sukses të objektivave ndërkombëtare të departamentit, si dhe masat parandaluese dhe planet alternative për menaxhimin e tyre.

Në versionin akademik, rreziqet lidhen kryesisht me aspektet institucionale, financiare dhe akademike të procesit të ndërkombëtarizimit. Një nga rreziqet kryesore është mungesa e partnerëve strategjikë ndërkombëtarë, e cila mund të kufizojë mundësitë për bashkëpunime, projekte të përbashkëta dhe mobilitet akademik. Për të parandaluar këtë, parashikohet krijimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe zgjerimi i rrjetit të partnerëve, ndërsa si plan alternativ konsiderohet identifikimi i partnerëve të rinj në rajon dhe në hapësirën evropiane. Një tjetër rrezik i rëndësishëm është financimi i pamjaftueshëm për projektet ndërkombëtare, i cili mund të ndikojë drejtpërdrejt në zbatimin e aktiviteteve të planifikuara. Për këtë arsye, departamenti synon të aplikojë në programe ndërkombëtare si Erasmus+ dhe Horizon Europe, si dhe të përdorë burime alternative financimi në rast nevojë.

Tabela gjithashtu evidenton rreziqe që lidhen me faktorët njerëzorë, si pjesëmarrja e ulët e stafit dhe studentëve në aktivitetet ndërkombëtare, si dhe barrierat gjuhësore dhe kulturore. Këto rreziqe mund të ndikojnë negativisht në nivelin e ndërveprimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Për të adresuar këto sfida, janë parashikuar masa si organizimi i trajnimeve gjuhësore, ofrimi i incentivave akademike dhe promovimi aktiv i mundësive të mobilitetit.

Në versionin e fokusuar në programet Erasmus+ dhe mobilitetin, rreziqet lidhen kryesisht me proceset operative dhe administrative, si refuzimi i aplikimeve, pjesëmarrja e ulët e studentëve, problemet me njohjen e krediteve, si dhe anulimet e mobilitetit. Këto rreziqe mund të ndikojnë në efektivitetin dhe vazhdimësinë e programeve të shkëmbimit. Për këtë arsye, janë parashikuar masa si përmirësimi i cilësisë së aplikimeve, mbështetja administrative, promovimi i programeve dhe sigurimi i fleksibilitetit në planifikim.

Në përgjithësi, tabela tregon se departamenti ka një qasje proaktive dhe të strukturuar ndaj menaxhimit të riskut, duke identifikuar paraprakisht sfidat potenciale dhe duke përcaktuar masa konkrete për minimizimin e ndikimit të tyre. Kjo qasje kontribuon në rritjen e qëndrueshmërisë dhe suksesit të strategjisë së ndërkombëtarizimit, si dhe në forcimin e pozicionit të departamentit në hapësirën akademike ndërkombëtare.

N r	Rreziku	Probabiliteti	Ndikimi	Masa parandaluese	Plani B
1	Refuzimi i aplikimeve Erasmus+	Mesatar	Lartë	Përmirësim i cilësisë së aplikimeve	Ri-aplikim në thirrjet e ardhshme
2	Numër i ulët aplikimesh nga	Mesatar	Mesatar	Promovim dhe informim	Zgjatje e afateve dhe mbështetje



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

	studentët				
3	Probleme me njohjen e krediteve	Ulët	Lartë	Marrëveshje të qarta akademike	Rishikim manual i ekuivalencës
4	Probleme administrative	Mesatar	Mesatar	Trajnime për stafin administrativ	Mbështetje nga zyra ndërkombëtare
5	Anulime mobiliteti	Mesatar	Mesatar	Planifikim fleksibël	Zëvendësim me kandidatë të tjerë
6	Probleme financiare	Ulët	Lartë	Menaxhim i mirë i fondeve	Përdorimi i rezervave
7	Probleme me vizat	Ulët	Mesatar	Mbështetje dokumentacioni	Ndryshim destinacioni
8	Mungesë partnerësh aktivë	Mesatar	Lartë	Zgjerim i rrjetit	Partnerë alternativë

Departamenti i Turizmit

1. Baza ligjore dhe dokumentet referuese

Hartimi i Strategjisë së Ndërkombëtarizimit të Departamenti synon të harmonizojë programet e studimit me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare nëpërmjet nxitjes së mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik, zgjerimit të bashkëpunimeve me universitete, institucione kërkimore dhe aktorë të industrisë së turizmit në nivel evropian dhe global. Ndërkombëtarizimi është tashme një proces ku një fokus të veçantë i kushtohet zhvillimit të kompetencave ndërkulturore, mendimit kritik dhe aftësive profesionale të studentëve, duke i përgatitur ata për të operuar me sukses në një treg punë gjithnjë e më të globalizuar dhe konkurrues.

Nëpërmjet kësaj Strategjie, Departamenti synon gjithashtu të rrisë përfshirjen e tij në projekte ndërkombëtare kërkimore dhe zhvillimore, të promovojë turizmin e qëndrueshëm dhe inovacionin në menaxhimin e destinacioneve, si dhe të forcojë lidhjet midis akademisë, komunitetit dhe industrisë në një kontekst ndërkombëtar. Përmes kësaj qasjeje, ndërkombëtarizimi bëhet pjesë integrale e misionit dhe zhvillimit afatgjatë të Departamentit të Turizmit, duke kontribuar në rritjen e dukshmërisë, cilësisë dhe ndikimit të tij në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Kjo strategji hartohet duke u bazuar në dokumentat e mëposhtme të cilat përbëjnë bazën ligjore dhe operative të kësaj strategjie :

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

- Ligjin nr. 80, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;
- Statutin (miratuar me urdhër nr. 385, datë 09.07.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë) Rregulloren (miratuar me Vendimin nr. 154, datë 26.11.2018 të Senatit Akademik) të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD);
- Rregulloren e Brendshme të Drejtorisë së Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë (miratuar me Vendimin nr. 5, datë 17.01.2020 të Senatit Akademik),
- Strategjinë e Ndërkombëtarizimit STRATEGJIA E NDËRKOMBËTARIZIMIT 2025-2027
- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; Rregulloren financiare të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës
- Rregulloren e Fakultetit të Biznesit
- Rregulloren e Departamentit të Turizmit

2. Qëllimi i Strategjisë së Departamentit

Qëllimi i kësaj Strategjie të Ndërkombëtarizimit është të orientojë dhe forcojë integrimin e dimensionit ndërkombëtar në të gjitha veprimtaritë akademike, kërkimore dhe institucionale të Departamentit të Turizmit, në përputhje me vizionin e Fakultetit të Biznesit dhe të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës. Strategjia synon të krijojë një kuadër të qëndrueshëm zhvillimi, i cili rrit cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, përmirëson konkurrueshmërinë akademike dhe profesionale të studentëve, si dhe fuqizon pozicionimin e Departamentit në rrjetin ndërkombëtar të institucioneve të arsimit të lartë në fushën e turizmit dhe mikpritjes.

Qëllimet specifike:

Në funksion të realizimit të qëllimit të përgjithshëm për integrimin e dimensionit ndërkombëtar në të gjitha veprimtaritë akademike, kërkimore dhe institucionale, Departamenti i Turizmit synon të ndjekë një sërë qëllimesh specifike të strukturuar në mënyrë të ndërthurur dhe afatgjatë.

- Së pari, strategjia *synon rritjen e mobilitetit ndërkombëtar të studentëve dhe stafit akademik*, duke zgjeruar pjesëmarrjen në programe shkëmbimi si Erasmus+, marrëveshje dypalëshe dhe iniciativa të tjera evropiane dhe ndërkombëtare. Përmes mobilitetit, Departamenti synon të forcojë përvojën akademike dhe profesionale të studentëve, të rrisë ekspozimin e tyre ndaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e turizmit dhe të nxisë shkëmbimin e njohurive dhe metodologjive bashkëkohore midis stafit akademik dhe institucioneve partnere.

- Një qëllim tjetër thelbësor është *harmonizimi dhe ndërkombëtarizimi i kurrikulave*, duke integruar në programet e studimit përmbajtje, standarde dhe praktika të njohura ndërkombëtarisht. Kjo përfshin përditësimin e syllabuseve në përputhje me zhvillimet globale në menaxhimin e turizmit, turizmin e qëndrueshëm, dixhitalizimin e industrisë së mikpritjes dhe menaxhimin e destinacioneve. Në këtë mënyrë, Departamenti synon të sigurojë që diplomat e ofruara të jenë konkurruese dhe të krahasueshme në hapësirën evropiane dhe më gjerë. Përfshirja e Departamentit në diploma duale me Universitete prestigjioze si Sapienza dhe Terramo dhe jo vetëm do të ofrojë studentët që do të diplomohen, mundësi për tregun e brendshëm por edhe atë rajonal e më gjerë.
- Strategjia synon gjithashtu *forcimin e bashkëpunimit kërkimor ndërkombëtar*, përmes përfshirjes aktive në projekte të përbashkëta, aplikime në thirrje ndërkombëtare për financim, organizim konferencash shkencore dhe publikime të përbashkëta me partnerë të huaj. Një fokus i veçantë do t'i kushtohet kërkimit në fushën e turizmit të qëndrueshëm, inovacionit, menaxhimit të trashëgimisë kulturore dhe zhvillimit të destinacioneve turistike në përputhje me prioritetet evropiane dhe globale.
- Një dimension i rëndësishëm i kësaj strategjie është *zhvillimi i partneriteteve strategjike me institucione akademike dhe aktorë ndërkombëtarë* të industrisë së turizmit dhe mikpritjes. Përmes këtyre bashkëpunimeve synohet rritja e mundësive për praktika profesionale jashtë vendit, projekte aplikative, leksione nga ekspertë ndërkombëtarë dhe transferim njohurish midis akademisë dhe industrisë. Kjo do të kontribuojë në forcimin e lidhjes ndërmjet teorisë dhe praktikës dhe në rritjen e punësueshmërisë së studentëve.
- Në të njëjtën kohë, strategjia synon *rritjen e kapaciteteve institucionale për menaxhimin* efektiv të proceseve të ndërkombëtarizimit. Kjo përfshin përmirësimin e mekanizmave administrativë, rritjen e aftësive të stafit në menaxhimin e projekteve ndërkombëtare, si dhe përdorimin e teknologjisë për të mbështetur bashkëpunimin ndërkufitar dhe mësimdhënien në kontekste ndërkombëtare.
- Një tjetër qëllim i rëndësishëm është *promovimi i kompetencave ndërkulturore dhe aftësive globale* të studentëve. Departamenti synon të krijojë një mjedis akademik të hapur dhe gjithëpërfshirës, që nxit respektin për diversitetin kulturor, dialogun ndërkulturor dhe zhvillimin e aftësive të komunikimit në mjedise shumëkombëshe. Këto kompetenca konsiderohen thelbësore për profesionistët e ardhshëm të sektorit të turizmit, i cili operon në një kontekst thellësisht ndërkombëtar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

- Së fundmi, strategjia *synon rritjen e dukshmërisë dhe reputacionit ndërkombëtar* të Departamentit të Turizmit, përmes pjesëmarrjes aktive në rrjete akademike, forume shkencore dhe iniciativa ndërkombëtare. Përmes promovimit të arritjeve akademike dhe kërkimore, si dhe përmes ndërtimit të një profili të qartë ndërkombëtar, Departamenti synon të konsolidojë pozicionin e tij si një njësi akademike moderne, konkurruese dhe e orientuar drejt zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.

Në tërësi, këto qëllime specifike ndërtojnë një qasje të integruar dhe afatgjatë, duke e vendosur ndërkombëtarizimin në thelb të zhvillimit strategjik të Departamentit të Turizmit.

3. Ndërkombëtarizimi, gjendja aktuale

Pershkrimi i Departamentit të Turizmit

Departamenti i Turizmit është pjesë e Fakultetit të Biznesit në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, institucion publik i arsimit të lartë i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Nr. 801, datë 20.12.2005 "Për hapjen e Universitetit "Aleksandër Moisiu" në Durrës". Për herë të parë Departamenti i Turizmit hapi dyert për studentët në vitin akademik 2009-2010 ku në bankat e tij filluan studimet universitare rreth njëqind e njëzet studentë nga i gjithë vendi.

Me hapjen e Departamentit të Turizmit, "Universiteti Aleksandër" Moisiu Durrës kishte për qëllim hapjen e një Departamenti të ri i cili do të sillte eksperiencat më të mira akademike perëndimore në fushën e turizmit. Filozofia e punës është "Studenti në qendër të vëmendjes" që do të thotë se gjithçka që ndodh në Departament, që nga procesi mësimor, shërbimet, aktivitetet dhe mjetet janë në dispozicion ekskluziv të studentit. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet një stafi dinamik të zgjedhur dhe të përkushtuar, një ambjenti të kompjuterizuar që mundëson kontakte të vazhdueshme me botën akademike perëndimore dhe nëpërmjet veprimtarive të larmishme ekstrakurrikulare.

Misioni i Departamentit të Turizmit është krijimi i një departamenti multidisiplinar dhe inovator, ku ndërthuret teoria me praktikën. Ky departament si pjesë e Fakultetit të Biznesit në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, në gjithë veprimtarinë e tij synon në mënyrë të vazhdueshme të arrijë standardet akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, ai synon të kontribuojë në rritjen e standardeve të turizmit, demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë.

Po ashtu, departamenti i turizmit ka si objektiv vendosjen e lidhjeve me tregun e punës që përpara diplomimit dhe konsolidimin e raportit me studentët alumni për të qënë koherent me nevojat e tregut të punës dhe mundësive konkrete të punësimeve. Më tej, departamenti *synon* të ofrojë asistencë e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

mbështetje për kualifikim të mëtejshëm të diplomuarve dhe stafit akademik

Vizioni i Departamentit të Turizmit është krijimi i një bërthame shkencore të lirë dhe autonome, pararojë në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor, e aftë të udhëheqë studentët në mënyrë të përgjegjshme duke kontribuar denjësisht në tregun e punës, duke ndërtuar një të ardhme ku studentët dhe stafi akademik të jenë pjesë integrale. Ndërkombëtarizimi i programeve të ofruara nga Departamenti i Turizmit mbetet pjesë e pandashme e vizionit të kësaj njësie.

Vlerat. Departamenti i Turizmit ka si qëllim krijimin e një mjedisi profesional e bashkohor për studentën duke krijuar kurrikul cilësore dhe staf profesional akademik. Në këtë kontekst, është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në të gjitha përpjekjet tona. Njëkohësisht, përkushtimi ndaj veprimtarive inovative kërkimore shkencore dhe transmetimi i dijes dhe risive. Një vlerë tjetër që departamenti ka zhvilluar dhe e vazhdon ende është krijimi i një mjedisi që kultivon integritetin individual dhe institucional në të gjitha aspektet. Një ambient i tillë konstruktiv dhe i civilizuar ka ndikuar e ndikon në shkëmbimin e lirë të ideve, në lirinë akademike, në hulumtim, në mësimdhënie dhe në terren. Të gjitha këto vlera janë realizuar dhe do vazhdojnë të realizohen me përgjegjshmëri dhe transparencë brenda institucionit tonë akademik dhe për publikun.

Gjendja aktuale e nderkombëtarizimit

3.2.1 Programe studimi

Për t'ju përshtatur nevojave të tregut si dhe synimit për të pasur një ofertë sa më tërheqëse për kandidatët studentë Departamenti i Turizmit gjatë vitit akademik 2025-2026 ka hapur me Universitetin e Sapienza të Romës (Itali) Programin e Studimit Master Shkencor në "Environmental, Cultural and Tourism Economics".

Më poshtë paraqiten programet mësimore që Departamenti i Turizmit ofron sipas cikleve të studimit:

Tabela 1. Programet mësimore që Departamenti i Turizmit ofron sipas cikleve të studimit.

Nr	Cikli i Studimeve	Emërtesa e programit	Gjuha e programit
1	Studime Profesionale 2-Vjeçar	"Guidë Turistike"	Shqip
2	Program Studimi i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor	"Turizëm"	Shqip
3	Program Studimi i Ciklit të Parë	"Menaxhim Turizmi me Profil"	Shqip



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

	të Studimeve Bachelor	Menaxhim Hotel -Restorant"	
4	Program Studimi i Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor	"Tourism Management with profile Hotel & Restaurant Management"	Anglisht
5	Program Studimi i Ciklit të Dytë të Studimeve Master Profesional	"Guidë Turistike Shqiptare"	Shqip
6	Program Studimi i Ciklit të Dytë të Studimeve Master Profesional	"Menaxhim i Sipërmarrjeve Turistike"	Shqip
7	Program Studimi i Ciklit të Dytë të Studimeve Master Shkencor	"Environmental, Cultural and Tourism Economics"	Anglisht& Italisht

Burimi: Departamenti i Turizmit

3.2.2 Pjesëmarrje në projektet kombëtare dhe ndërkombëtare i stafit akademik

Të dhëna mbi Pjesëmarrjen në projekte Kombëtare dhe Ndërkombëtare
Departamenti i Turizmit

N	Lektori	Emërtimi i Projektit	Kombët ar/Ndër kombët ar	Financuesi	Afati
1	Dorina Xheraj	Turina	Kombët ar	UAMD	2024-2025
2	Dorina Xheraj	Heritage Hub 3 https://meki.gov.al/newsroom/lista-e-projekteve-te-miratuara/	Kombët ar	Ministry of Economy, Culture and Innovation, (MEKI), Albania	Prill- Nov 2025
3	Dorina Xheraj	Epidamn Heritage-Connecting past with the present/ "Trashëgimia Epidamn: lidhja mes së shkuarës dhe së tashmes"	Ndërko mbetar	EUfor Culture,	Dhjetor 2024- Gusht 2025
4	Gentian Ruspi	(SustainTour) Erasmus+ CB VET	Ndërko mbetar	Erasmus +	2024-2026
5	Nevila Cinaj	"Prespa Ohrid Nature Trust" mbeshetur nga	Ndërko mbetare	MAVA Foundation dhe German Ministry for Economic	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

Cooperation and
Development
(BMZ) nepermjet
KfW Development
Bank.

6	Nevila Cinaj	The Integrated Tourist Product in the Function of Year-round Responsible Tourism along the Adriatic Coast"	Kombet ar	AKKSHI	
7	Nevila Cinaj	"Vlerësimin dhe Ngritja e Kapaciteteve të Komiteteve Menaxhuese të ZM-ve",	Kombet ar	EU4Nature. UNDP-Albania.	
8	Nevila Cinaj	COST Action: CA24134, Observatory of Innovative Strategies for Repurposing Terrain Vague (OBSERVISTA)	Nderko mbetar		
9	Brunilda Licaj	B- VISA 2030 IPA Action Plan BlueEconomy Albania 2030	Nderko mmbetar	IPA Adriatic	Tetor 2024- Prill 2025
1 0	Brunilda Licaj	Roli i Universitetit të Durrësit në përbushjen e nevojave të fuqisë punëtore në sektorin e turizmit dhe detarisë në rajonin e Durrësit	Kombet ar	UAMD	Maj 2025- Janar 2026
1 1	Brunilda Licaj	Scoping study for the development of cultural and rural tourism in the Mallakaster Region Albania – BYLIS	Nderko mbetar	AICS and European Union	April 2025- Nov 2025
1 2	Brunilda Licaj	Capacity Building in the agrotourism sector in Elbasan region	Nderko mbetar	Bread – Diagonia Agapes	Korrik 2025- Nentor 2025
1 3	Violeta Aliaj (Plumbi)	Governance	Nderko mbetar	IPA South Adriatic Cross Border	Janar 2024 – Tetor 2025
1 4	Violeta Aliaj (Plumbi)	ACT	Nderko mbetar	IPA South Adriatic Cross Border	Janar 2024 – Tetor 2025
1 5	Violeta Aliaj	Soft Mobility	Nderko mbetar	IPA South Adriatic Cross Border	Janar 2024 – Tetor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

	(Plumbi)				2025
1	Violeta	Biotours 2.0	Nderko	IPA South Adriatic	Janar 2024
6	Aliaj		mbetar	Cross Border	- Tetor
	(Plumbi)				2025
1	Violeta	Histek Plus	Nderko	IPA South Adriatic	Korrik
7	Aliaj		mbetar	Cross Border	2025 -
	(Plumbi)				Korrik
					2027
1	Violeta	ALEDU.SEA	Nderko	IPA South Adriatic	Korrik
8	Aliaj		mbetar	Cross Border	2025 -
	(Plumbi)				Korrik
					2027
1	Violeta	Cost Cultural Property Protection	Nderko	Bashkimi European	Korrik
9	Aliaj	for ALL (CPP4ALL)	mbetar		2025 -
	(Plumbi)				Korrik
					2027
2	Violeta	Via -Egnatia nje laborator I hapur I	Kombet	UAMD	Shtator
0	Aliaj	kerkimit shkencor	ar		2025 -
	(Plumbi)				Mars 2026
2	Mirela	Projekti Environmental , Cultural	Kombet	Uamd	Dhjetor-
1	Tase	and Tourism economics	ar		2025-shtat
					or 2026
2	Mirela	Enhancing Family	Nderko	UAMD-V4 &	Tetor-2025
2	Tase	Tourism Enterprises through	mbetar	Albania	-Mars
		Education and Cooperation in V4 &			2027
		Albania			
2	Mirela	Erasmus-EDU-2024-CBE-Erasmus	Nderko	UAMD-EACEA	Mars
3	Tase	Sustaintour	mbetar		2024-
					Dhjetor
					2026
2	Mirela	NAWA	Nderko	UAMA-Poland	Djetor
4	Tase		mbetar		2025-Nent
					or 2026

3.2.3 Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Departamentit

Të dhëna për Bashkëpunime shkencore në rang Fakulteti/programi studimi në kuadër të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

Bashkëpunimit ndërkombëtar në vitet e fundit

1	Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare	20
2	Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj (ose orë mësimore)	
3	Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt programit të studimit	10
4	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime	
5	Numri i Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	1

3.2.4 Bursa dhe Mobiliteti Akademik per studentet dhe stafin

Emër	Mbiemër	Universiteti Pritës	Vendi i Mobilitetit	Viti	Mobiliteti
Mirela	Tase	Universitatea Babes-Bolyai	Rumani	2025	Training
Mirela	TaSE	Salento	Itali	2025	Teaching
Arlind	Kasa	Vilniaus Kolegija (VIKO)	Lithuania	2025	Training
Celnik	Mujollari	Isparta University	Turkey	2025	Teaching
Majlinda	Muka	Kolodaysnkit	Hungary	2025	Teaching
Nevila	Cinaj	Universiteti METU	Hungari	202	Teaching

Burimi: Te dhena nga zyra e Drejtorise se Projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë

Emër	Mbiemër	Gjinia	Programi i Studimit	Universiteti Pritës	Vendi Pritës	Viti akademik	Semestri
Fabio	Taraj	M	MTMHR	ISAG	Portugali	2024-2025	II
Morena	Muzhaqi	F	Turizem	ISAG	Portugali	2025-2026	II
Matia	Mema	M	Turizem	Cordobes	Spanje	2024-2025	I



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

Departamentit të Turizmit për 2025-2030. Këto objektiva synojnë: internacionalizimin e programeve mësimore, zgjerimin e ofertës akademike në gjuhë të huaja dhe rritjen e dimensionit ndërkombëtar të edukimit. Më poshtë objektivat e sipërpërmendura paraqiten në formë matrice strategjike, strukturë që e bën dokumentin operacional të matshëm për periudhën 2025–2026 në nivel Departamenti të Turizmit.

Tabela 1. Matrica me objektivat strategjike të Departamentit të Turizmit (2026–2030), pjesë e Prioritetit 1: Mësimdhënia dhe studentët

Objektivi strategjik	Veprimet kryesore	Indikatorët e matjes	Ndikimi tek studentët
Internacionalizim i i programeve mësimore	- Harmonizimi i programeve të Turizmit me standardet ndërkombëtare. - Integrimi i moduleve ndërdisiplinore.	- Numri i kurrikulave të përditësuara. - Pjesëmarrja e stafit në projekte ndërkombëtare të zhvillimit të kurrikulave.	Studentët marrin një formim akademik të krahasueshëm me universitetet europiane, duke rritur konkurrueshmërinë e tyre në tregun e punës.
Zgjerimi i ofertës akademike në gjuhë të huaja	- Hapja e programeve të Turizmit në anglisht dhe gjuhë të tjera. - Krijimi i programeve të përbashkëta me universitete partnere për diploma të dyfishta/multiploma.	- Numri i programeve në gjuhë të huaja. - Numri i marrëveshjeve për diploma të dyfishta/multiploma.	Studentët fitojnë aftësi gjuhësore dhe akademike ndërkombëtare, duke pasur mundësi për diploma të njohura globalisht.
Rritja e dimensionit ndërkombëtar të edukimit	- Tërheqja e studentëve të huaj në programet e Turizmit. - Organizimi i shkëmbimeve studentore dhe praktikave profesionale jashtë vendit. - Nxitja e aktiviteteve akademike dhe	- Numri i studentëve të huaj të regjistruar. - Numri i shkëmbimeve dhe praktikave ndërkombëtare. - Numri i aktiviteteve akademike/kërkimore të përbashkëta.	Studentët vendas përfitojnë nga ndërveprimi kulturor dhe akademik, ndërsa studentët e huaj gjejnë një mjedis tërheqës për studime në Turizëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

kërkimore me partnerë
globalë.

Për të ofruar një edukim ndërkombëtar për studentët vendas dhe të huaj synohet rritja e numrit të programeve të studimit në gjuhë të huaja, krijimi i programeve të përbashkëta që ofrojnë diploma të dyfishta ose të shumëfishta dhe zgjerimi i kapaciteteve.

Prioriteti 2: Kërkimi shkencor dhe inovacioni

Departamenti i Turizmit synon të forcojë rolin e tij si qendër akademike e prodhimit të njohurive të reja, duke kontribuar në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe inovativ me ndikim rajonal, kombëtar e më gjerë. Në periudhën 2025–2030, objektivat e tij strategjikë lidhen ngushtë me nxitjen e kërkimit shkencor, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe aplikimin e teknologjive digjitale në fushën e turizmit. Këto objektiva janë të strukturuar në mënyrë që të sigurojnë matje të qartë të progresit dhe të rrisin ndikimin e departamentit në rrjetet akademike dhe profesionale globale.

Tabela 2. Matrica me objektivat strategjikë të Departamentit të Turizmit (2025–2030), pjesë e Prioritetit 2: Kërkimi shkencor dhe inovacioni,

Objektivi strategjik	Veprimet kryesore	Indikatorët e matjes	Ndikimi në kërkimin dhe inovacionin
Zhvillimi i kapaciteteve kërkimore	- Nxitja e projekteve kërkimore në turizmin e qëndrueshëm, menaxhimin e destinacioneve dhe ndikimin e klimës. - Krijimi i grupeve kërkimore ndërdisiplinore brenda universitetit.	- Numri i projekteve kërkimore të nisura. - Numri i publikimeve shkencore.	Forcon rolin e departamentit si qendër e prodhimit të njohurive të reja në turizëm.
Internacionalizim i i kërkimit shkencor	- Zhvillimi i projekteve të përbashkëta kërkimore me universitete partnere ndërkombëtare. - Pjesëmarrja në konsorciume dhe rrjete kërkimore europiane.	- Numri i projekteve të përbashkëta. - Numri i publikimeve ndërkombëtare.	Rrit vizibilitetin akademik ndërkombëtar dhe integron departamentin në rrjetet globale të kërkimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

Nxjtja e inovacionit në turizëm	- Aplikimi i teknologjive digjitale në studimet e turizmit (GIS, inteligjencë artificiale për analizën e tregjeve turistike, sistemet e rezervimit online, realiteti virtual (VR) dhe realiteti i shtuar (AR) etj.). - Krijimi i laboratorit të inovacionit në fushën e turizmit për studentë dhe personelin akademik	- Numri i projekteve inovative të realizuara. - Numri i partneriteteve me sektorin privat.	Departamenti kontribuon në zhvillimin e praktikave inovative dhe të qëndrueshme në turizëm.
Shpërndarja e rezultateve kërkimore	- Organizimi i konferencave, seminareve dhe botimeve shkencore në fushën e turizmit. - Përfshirja e studentëve në projekte kërkimore dhe publikime.	- Numri i konferencave/seminareve të organizuara. - Numri i studentëve të përfshirë në kërkim.	Rrit kulturën kërkimore dhe përfshirjen e studentëve në prodhimin e njohurive.

Këto objektiva kanë si qëllim pozicionimin e Departamentit të Turizmit si një aktor aktiv në prodhimin e njohurive të reja dhe në aplikimin e inovacionit në fushën e turizmit. Zbatimi i tyre do të rrisë ndikimin akademik dhe praktik të departamentit, duke e bërë atë një pikë referimi për kërkimin shkencor dhe zhvillimin e politikave të qëndrueshme në turizëm.

Prioriteti 3: Ndërkombëtarizimi

Departamenti i Turizmit e konsideron ndërkombëtarizimin si një shtyllë themelore për rritjen e cilësisë akademike dhe përmirësimin e vizibilitetit global. Përmes partneriteteve ndërkombëtare, mobilitetit akademik dhe hapjes ndaj studentëve të huaj, departamenti synon të krijojë një mjedis multikulturor dhe të integruar në rrjetet globale të arsimit dhe kërkimit. Objektivat e mëposhtëm janë të strukturuar për të siguruar që ndërkombëtarizimi të jetë i matshëm, i qëndrueshëm dhe i lidhur ngushtë me vizionin e universitetit.

Tabela 3. Matrica me objektivat strategjike të Departamentit të Turizmit (2025–2030), pjesë e Prioritetit 3: Ndërkombëtarizimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

Objektivi strategjik	Veprimet kryesore	Indikatorët e matjes	Ndikimi në ndërkombëtarizim
Zhvillimi i partneriteteve ndërkombëtare	- Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete dhe institute të huaja. - Pjesëmarrja në rrjete akademike dhe profesionale ndërkombëtare të turizmit.	- Numri i marrëveshjeve të reja. - Numri i rrjeteve ndërkombëtare ku departamenti është aktiv.	Forcon integrimin e departamentit në komunitetin akademik global.
Marrëveshje të përbashkëta me univesitetet evropiane që ofrojnë programe studimore në fushën e turizmit	- Ndërtimi i marrëveshjeve me interes të ndërsjelltë me universitete partnere që ofrojnë programe studimore në fushën e turizmit. - Nxitja e mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik për integrim në arsimin e lartë evropian.	- Numri i marrëveshjeve të nënshkruara. - Numri i projekteve apo studimeve të përbashkëta si dhe mobilitetet studentore e të stafit.	Rrit kapacitetet e resurseve humane, rrit mundësitë për formim ndërkombëtar dhe përvoja kulturore të pasura.
Promovimi i vizibilitetit ndërkombëtar	- Organizimi i konferencave, seminareve dhe workshop-eve me tematikë ndërkombëtare. - Publikimi i materialeve akademike në gjuhë të huaja.	- Numri i aktiviteteve ndërkombëtare të organizuara. - Numri i publikimeve në gjuhë të huaja.	Rrit reputacionin e departamentit dhe e pozicionon si aktor aktiv në fushën e turizmit global.
Tërheqja e studentëve të huaj	- Zhvillimi i programeve të Turizmit në gjuhë të huaja. - Krijimi i shërbimeve mbështetëse për studentët ndërkombëtarë (orientim, mentorim, integrim kulturor).	- Numri i studentëve të huaj të regjistruar. - Nivel i kënaqësisë së studentëve ndërkombëtarë.	Diversifikon komunitetin akademik dhe krijon një mjedis multikulturor në departament.

Objektivat e mësipërme synojnë ta pozicionojnë Departamentin e Turizmit si një aktor aktiv jo vetëm brenda vendit, por edhe në arenën ndërkombëtare, duke e bërë pjesë të rrjeteve akademike dhe profesionale globale. Zbatimi i tyre ka për qëllim rritjen e mëtejshme të reputacionit të departamentit, dhe do të krijojë një mjedis më të pasur multikulturor për studentët dhe stafin, duke e forcuar rolin e tij



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

si një qendër e rëndësishme e arsimit dhe kërkimit në turizëm.

Prioriteti 4: Infrastruktura dhe burimet njerëzore

Departamenti i Turizmit e konsideron zhvillimin e infrastrukturës dhe menaxhimin e burimeve njerëzore si një element kyç për rritjen e cilësisë akademike dhe kërkimore. Investimi në mjedise moderne mësimore, laboratorë digjitalë dhe pajisje teknologjike, si dhe fuqizimi i stafit akademik dhe administrativ, janë bazë për të siguruar një edukim bashkëkohor dhe për të mbështetur objektivat strategjike të universitetit. Objektivat e mëposhtëm janë të strukturuar më synimin për të garantuar që infrastruktura dhe burimet njerëzore të jenë të përshtatura me kërkesat e kohës dhe të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të departamentit.

Tabela 4. Matrica me objektivat strategjike të Departamentit të Turizmit (2025–2030), pjesë e Prioritetit 4: Infrastruktura dhe burimet njerëzore

Objektivi strategjik	Veprimet kryesore	Indikatorët e matjes	Ndikimi në departament
Modernizimi i infrastrukturës mësimore	- Përmirësimi i auditorëve dhe laboratorëve me pajisje digjitale. - Krijimi i hapësirave interaktive për mësimdhënie dhe kërkim.	- Numri i auditorëve/laboratorëve të rinovuar. - Nivel i kënaqësisë së studentëve dhe stafit.	Siguron kushte bashkëkohore për mësimdhënie dhe kërkim shkencor.
Zhvillimi i laboratorëve digjitalë dhe inovativë	- Instalimi i teknologjive moderne (GIS, inteligjencë artificiale për analizën e tregjeve turistike, sistemet e rezervimit online, realiteti virtual (VR) dhe realiteti i shtuar (AR) etj.). - Krijimi i laboratorëve për simulime turistike dhe analizë të të dhënave.	- Numri i laboratorëve të krijuar. - Numri i projekteve inovative të realizuara.	Rrit kapacitetin e departamentit për kërkim dhe inovacion në turizëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

Fuqizimi i burimeve njerëzore	- Trajnimi i stafit akademik dhe administrativ në teknologji dhe metodologji moderne. - Nxitja e pjesëmarrjes së stafit në programe ndërkombëtare të zhvillimit profesional.	- Numri i trajnimeve të realizuara. - Numri i mobiliteteve të stafit akademik.	Përmirëson cilësinë e mësimdhënies dhe rrit kompetencat profesionale të stafit.
Optimizimi i shërbimeve mbështetëse	- Përmirësimi i sistemeve administrative digjitale për studentët dhe stafin. - Krijimi i mekanizmave të mentorimit dhe mbështetjes për studentët.	- Nivel i kënaqësisë së studentëve. - Efikasiteti i shërbimeve administrative.	Rrit efikasitetin e menaxhimit dhe përmirëson përvojën studentore.

➤ Synimi përmes objektivave të mësipërm është modernizimi i infrastrukturës dhe fuqizimi i burimeve njerëzore si themel për ta vendosur Departamentin e Turizmit në një rrugë zhvillimi të qëndrueshëm me cilësi akademike dhe kërkimore. Zbatimi i këtyre strategjive do të ndihmojë në sigurimin e një mjedisi më të përshtatshëm për studentët dhe stafin, duke e bërë departamentin konkurrues në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Prioriteti 5: Komuniteti

Departamenti i Turizmit e sheh komunitetin si një partner të pazëvendësueshëm në zhvillimin e tij akademik dhe praktik. Ndërveprimi me komunitetin lokal, bashkëpunimi me aktorët e industrisë së turizmit dhe përfshirja e studentëve në projekte sociale e kulturore janë elementë që e forcojnë lidhjen mes universitetit dhe shoqërisë. Objektivat e mëposhtëm janë të strukturuar për të siguruar që departamenti të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe të krijojë ura të forta bashkëpunimi.

Tabela 5. Matrica me objektivat strategjike të Departamentit të Turizmit (2025–2030), pjesë e Prioritetit 5: Komuniteti

Objektivi strategjik	Veprimet kryesore	Indikatorët e matjes	Ndikimi në komunitet
Bashkëpunimi me industrinë e turizmit	- Partneritete me biznese lokale dhe operatorë turistikë.	- Numri i marrëveshjeve me aktorë lokalë. - Numri i studentëve të	Forcon lidhjen mes akademisë dhe tregut të punës, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik lokal.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

	- Organizimi i praktikave profesionale për studentët në komunitet.	përfshirë në praktika.	
Përfshirja në projekte sociale dhe kulturore	- Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe sociale në bashkëpunim me komunitetin. - Pjesëmarrja e studentëve dhe stafit në nisma për ruajtjen e trashëgimisë kulturore.	- Numri i aktiviteteve të realizuara. - Numri i pjesëmarrësve nga komuniteti.	Rrit ndërgjegjësimin për vlerat kulturore dhe sociale, duke e bërë departamentin një aktor aktiv në jetën komunitare.
Promovimi i turizmit të qëndrueshëm	- Projekte për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e turizmit të gjelbër. - Fushata ndërgjegjësimi për komunitetin lokal mbi praktikën e qëndrueshme.	- Numri i projekteve të qëndrueshme. - Nivel i ndërgjegjësimit të komunitetit.	Ndihmon në ruajtjen e resurseve natyrore dhe promovon turizmin e përgjegjshëm.
Ndërveprimi me komunitetin akademik dhe lokal	- Organizimi i forumeve, tryezave të rumbullakëta dhe konsultimeve me aktorë lokalë. - Krijimi i platformave digjitale për komunikim dhe bashkëpunim.	- Numri i forumeve të organizuara. - Numri i pjesëmarrësve nga komuniteti.	Forcon dialogun dhe bashkëpunimin mes universitetit dhe komunitetit lokal.

➤ Departamenti i Turizmit përmes arritjes së këtyre objektivave synon të ketë një rol edhe më aktiv dhe më të përgjegjshëm ndaj komunitetit, duke e konsideruar atë një faktor të rëndësishëm në zhvillimin social, kulturor dhe ekonomik lokal. Përmes bashkëpunimit, përfshirjes dhe promovimit të turizmit të qëndrueshëm, departamenti jo vetëm që rrit ndikimin e tij akademik, por edhe kontribuon drejtpërdrejt në mirëqenien e komunitetit.

Prioriteti 6: Qeverisja dhe transparencja

➤ Departamenti i Turizmit e konsideron qeverisjen e mirë dhe transparencën si bazë për funksionimin efikas dhe të besueshëm. Menaxhimi i qartë, proceset transparente dhe komunikimi i vazhdueshëm me studentët, stafin dhe komunitetin janë elementë që sigurojnë integritetin institucional



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

dhe rrisin besimin publik. Objektivat e mëposhtëm janë të strukturuar për të garantuar që qeverisja e departamentit të jetë e përgjegjshme, transparente dhe e orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm.

Tabela 6. Matrica me objektivat strategjike të Departamentit të Turizmit (2025–2030), pjesë e Prioritetit 6: Qeverisja dhe transparencja

Objektivi strategjik	Veprimet kryesore	Indikatorët e matjes	Ndikimi në qeverisje dhe transparencë
Forcimi i mekanizmave të qeverisjes	- Hartimi i politikave të brendshme për menaxhimin e departamentit. - Krijimi i strukturave të qarta vendimmarrëse dhe monitoruese.	- Numri i politikave të miratuara. - Efikasiteti i proceseve vendimmarrëse.	Siguron funksionim të qartë dhe të përgjegjshëm të departamentit.
Rritja e transparencës institucionale	- Publikimi i raporteve periodike mbi aktivitetet akademike dhe financiare. - Krijimi i platformave digjitale për akses të hapur në informacion.	- Numri i raporteve të publikuara. - Nivel i aksesit të studentëve dhe stafit në informacion.	Forcon besimin e studentëve, stafit dhe komunitetit tek departamenti.
Përfshirja e studentëve dhe stafit në vendimmarrje	- Organizimi i forumeve konsultative me studentët dhe stafin. - Krijimi i mekanizmave për feedback dhe sugjerime.	- Numri i forumeve të organizuara. - Numri i rekomandimeve të zbatuara.	Rrit ndjenjën e përkatësisë dhe përfshirjes në proceset e departamentit.
Monitorimi dhe vlerësimi i performancës	- Zhvillimi i sistemeve të vlerësimit të performancës akademike dhe administrative. - Raportim i rregullt mbi arritjet dhe sfidat.	- Numri i raporteve të performancës. - Përmirësimet e evidentuara pas vlerësimit.	Siguron përmirësim të vazhdueshëm dhe llogaridhënie institucionale.

Realizimi i objektiveve të mësipërme do ta pozicionojnë Departamentin e Turizmit si një strukturë akademike që operon me integritet, transparencë dhe efikasitet. Në këtë mënyrë Departamenti i Turizmit do të garantojë një kulturë qeverisjeje të hapur, ku studentët dhe stafi ndihen të përfshirë, ndërsa komuniteti gjen një institucion të besueshëm dhe të përgjegjshëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT



4.1 Fushat e ndërhyrjes dhe masat kryesore

❖ **Mobiliteti i studentëve:**

Strategjia Kombëtare për Arsimin në Shqipëri për periudhën 2021-2026 thekson ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë si një objektiv strategjik kyç. Qëllimi është të përmirësohet cilësia e arsimit dhe të krijohen mundësi më të mira për studentët shqiptarë në tregun global të punës. Bashkëpunimi me universitete të huaja është i domosdoshëm për të rritur mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik, si dhe për të promovuar shkëmbimin e njohurive dhe resurseve. Në këtë kuadër, mobiliteti i studentëve është një fushë ndërhyrjeje strategjike për Departamentin e Turizmit, pasi përfaqëson një mekanizëm të drejtpërdrejtë për ndërkombëtarizimin e studimeve, rritjen e kompetencave profesionale dhe krijimin e përvojave kulturore të pasura. Përmes mobilitetit, studentët kanë mundësi të ndjekin studime, praktika profesionale dhe projekte kërkimore në universitete dhe institucione të huaja, duke sjellë më pas përvoja të vlefshme në departament.



Departamenti i Turizmit synon të ndërhyjë në disa drejtime kryesore për të forcuar mobilitetin studentor:

- Zgjerimi i marrëveshjeve ndërkombëtare përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të reja me universitete dhe institute të huaja për shkëmbime akademike dhe praktika profesionale në fushën e turizmit.
- Integrimi i praktikave profesionale jashtë vendit, me synim bashkëpunimin me kompani dhe organizata turistike ndërkombëtare për të ofruar studentëve mundësi praktike në destinacione të ndryshme.
- Mbështetje institucionale dhe financiare, duke krijuar mekanizma të brendshëm (zyra e mobilitetit, bursa, fonde mbështetëse) për të lehtësuar aksesin e studentëve në programe ndërkombëtare.
- Promovimi i kulturës së mobilitetit nëpërmjet organizimit të aktiviteteve informuese, forumeve dhe mentorimit nga studentët që kanë përfutur mobilitet, për të nxitur pjesëmarrjen e gjerë.
- Përfshirja e studentëve në rrjete akademike globale: Nxitja e pjesëmarrjes në projekte kërkimore dhe konferenca ndërkombëtare, duke i bërë studentët pjesë aktive të komunitetit akademik global.



Mobiliteti i studentëve është një investim i drejtpërdrejtë në cilësinë e formimit akademik dhe profesional. Përmes masave të ndërhyrjes, Departamenti i Turizmit jo vetëm që rrit mundësitë e studentëve për përvoja ndërkombëtare, por edhe e pozicionon veten si një strukturë akademike të hapur, dinamike dhe të integruar në rrjetet globale të arsimit dhe turizmit.

❖ **Mobiliteti i stafit (teaching/training):**

Mobiliteti i stafit akademik (teaching/training) është një fushë ndërhyrjeje e rëndësishme për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

Departamentin e Turizmit, pasi ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e mësimdhënies dhe zhvillimin profesional të pedagogëve. Përmes mobilitetit, stafi ka mundësi të marrë pjesë në programe ndërkombëtare trajnimi, shkëmbimi përvojash dhe projekte bashkëpunimi, duke sjellë më pas praktika të reja dhe inovative në departament. Kjo jo vetëm që rrit kapacitetet akademike, por edhe e pozicionon departamentin si pjesë aktive e rrjeteve globale të arsimit dhe kërkimit.

➤ Departamenti i Turizmit për të fuqizuar mobilitetin e stafit akademik synon marrjen e veprimeve konkrete, si më poshtë:

- Zgjerimi i marrëveshjeve ndërkombëtare për personelin akademik përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete dhe institute të huaja që ofrojnë programe trajnimi dhe shkëmbimi për pedagogët.
- Pjesëmarrja në programe ndërkombëtare nëpërmjet nxitjes së stafit për të marrë pjesë në programe si Erasmus+, projekte Interreg, projekte të financuara nga UAMD për të mbështetur stafin akademik dhe studentët, projekte të financuara nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) si dhe projektet për ndërkombëtarizimin dhe konsorciume akademike, duke përfutur nga trajnime dhe seminare ndërkombëtare.
- Trajnime profesionale dhe metodologjike duke organizuar trajnime për përdorimin e teknologjive digjitale (GIS, VR/AR) dhe metodologji moderne të mësimdhënies.
- Shkëmbimi i përvojave akademike përmes përfshirjes së stafit akademik në leksione të hapura, seminare dhe projekte kërkimore në universitete partnere, duke sjellë praktika të reja në departament.
- Mbështetje institucionale dhe financiare me qëllim sigurimin e fondeve dhe bursave për mobilitetin e stafit, si dhe krijimi i mekanizmave të brendshëm për lehtësimin e pjesëmarrjes.

➤ Mobiliteti i stafit akademik është një investim i drejtpërdrejtë në cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Përmes masave të ndërhyrjes, Departamenti i Turizmit synon të krijojë një kulturë të vazhdueshme zhvillimi profesional, ku pedagogët përfitojnë nga përvoja ndërkombëtare dhe sjellin inovacion në procesin akademik. Kjo mendohet se do të rrisë konkurrueshmërinë e departamentit dhe do ta pozicionojë atë si një strukturë akademike dinamike dhe të integruar në rrjetet globale të arsimit dhe turizmit.

❖ *Projekte dhe fonde (KA2/KA171/Horizon/Interreg, etj.):*

➤ Projekte dhe fonde ndërkombëtare si KA2, KA171, Horizon Europe, Interreg etj., përfshijnë një fushë ndërhyrjeje strategjike për Departamentin e Turizmit. Ato ofrojnë mundësi për bashkëpunim



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

akademik, kërkim shkencor, inovacion dhe ndërkombëtarizim, duke e pozicionuar departamentin si një aktor aktiv në rrjetet europiane dhe globale të arsimit dhe turizmit. Përmes këtyre instrumenteve financiare, departamenti synon të rrisë kapacitetet e tij kërkimore, të përmirësojë infrastrukturën akademike dhe të krijojë mundësi të reja për studentët dhe stafin.

➤ Departamenti i Turizmit synon të ndërmarrë masa të qarta për të përfituar nga programet ndërkombëtare të financimit si më poshtë:

- ✓ Aplikimi në projekte Erasmus+ (KA2/KA171) me synimin e nxitjes së pjesëmarrjes në projekte bashkëpunimi ndëruniversitare, mobilitete studentor dhe të personelit akademik, si dhe zhvillimin e programeve të përbashkëta akademike.
- ✓ Pjesëmarrja në Horizon Europe ka si qëllim përfshirjen në projekte kërkimore të avancuara mbi turizmin e qëndrueshëm, inovacionin digjital dhe ndikimin e klimës në sektorin turistik.
- ✓ Angazhimi në programet Interreg përmes zhvillimit të projekteve ndërkufitare me fokus në menaxhimin e destinacioneve, ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimin e turizmit të gjelbër.
- ✓ Krijimi i një njësie të brendshme për menaxhimin e projekteve nëpërmjet formimit të një strukture të dedikuar për identifikimin e thirrjeve, përgatitjen e aplikimeve dhe menaxhimin e fondeve të fituara.
- ✓ Trajnimi i stafit dhe studentëve për aplikime ndërkombëtare përmes organizimit të workshop-eve dhe seminareve për të rritur kapacitetet e brendshme në hartimin dhe menaxhimin e projekteve.
- ✓ Ndërtimi i partneriteteve strategjike përmes bashkëpunimit me universitete, institute kërkimore dhe aktorë të industrisë për të rritur shanset e suksesit në aplikime.

➤ Përmes angazhimit në projekte dhe fonde ndërkombëtare, Departamenti i Turizmit do të rrisë kapacitetet e tij akademike dhe kërkimore, duke krijuar mundësi të reja për studentët dhe stafin. Kjo qasje do ta pozicionojë departamentin si një strukturë dinamike, të integruar në rrjetet europiane dhe globale, dhe të aftë për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit.

❖ *Programe të përbashkëta / diploma të dyfishta:*

➤ Programe të përbashkëta dhe diplomat e dyfishta përfaqësojnë një fushë ndërhyrjeje strategjike për Departamentin e Turizmit, pasi ofrojnë mundësi për integrim të thelluar akademik me universitete partnere ndërkombëtare. Këto iniciativa jo vetëm që rrisin cilësinë e formimit akademik, por edhe e pozicionojnë departamentin si një aktor aktiv në ndërkombëtarizimin e arsimit, duke u dhënë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

studentëve mundësinë të përfitojnë nga dy sisteme arsimore dhe të marrin diploma të njohura ndërkombëtarisht.

➤ Departamenti i Turizmit do të ndërmarrë masa të qarta për të zhvilluar dhe konsoliduar programe të përbashkëta dhe diploma të dyfishta:

- Nënshkrimi i marrëveshjeve strategjike me universitete partnere në rajon dhe më gjerë, për të krijuar programe të përbashkëta studimi në turizëm dhe fusha të lidhura.
- Krijimi i diplomave të dyfishta/multiploma që u japin studentëve mundësinë të diplomohen njëkohësisht në dy institucione, duke rritur konkurrueshmërinë e tyre në tregun global të punës.
- Integrimi i moduleve ndërkombëtare në kurrikula për të siguruar harmonizimin e programeve dhe për të lehtësuar njohjen e krediteve akademike.
- Mbështetje institucionale për studentët që ndjekin programe të përbashkëta, përmes orientimit, mentorimit dhe lehtësimit administrativ.
- Promovimi i programeve të përbashkëta përmes fushatave informuese dhe aktiviteteve ndërkombëtare, duke tërhequr studentë vendas dhe të huaj.
- Përfshirja e stafit akademik në dizajnimin e programeve për të siguruar cilësi dhe përputhje me standardet ndërkombëtare të arsimit.
- Programe të përbashkëta dhe diplomat e dyfishta janë një instrument kyç për ndërkombëtarizimin e Departamentit të Turizmit. Zbatimi i masave të parashikuara do të rrisë vizibilitetin ndërkombëtar të departamentit, do të ofrojë studentëve mundësi të zgjeruara akademike dhe profesionale, dhe do ta pozicionojë departamentin si një strukturë akademike të integruar në rrjetet globale të arsimit dhe kërkimit në turizëm.

❖ *Ndërkombëtarizimi në kurrikulë (internationalisation at home):*

➤ Ndërkombëtarizimi në kurrikulë ("internationalisation at home") është një fushë ndërhyrjeje strategjike për Departamentin e Turizmit, sepse u mundëson studentëve të përfitojnë nga përvoja ndërkombëtare pa qenë e domosdoshme lëvizja fizike jashtë vendit. Kjo qasje synon të integrojë perspektiva globale në programet e studimit, të rrisë ndërkulturalitetin dhe të përgatisë studentët për një treg pune gjithnjë e më të ndërlidhur ndërkombëtarisht.

➤ Departamenti i Turizmit do të ndërmarrë masa konkrete për të forcuar ndërkombëtarizimin e programeve mësimore:

- Integrimi i moduleve ndërkombëtare në programet e studimit përmes përfshirjes së lëndëve që



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

trajtojnë praktikat globale të turizmit, menaxhimin ndërkulturor dhe politikat ndërkombëtare të zhvillimit të qëndrueshëm.

- Përdorimi i literaturës dhe burimeve akademike ndërkombëtare, duke përzgjedhur tekstet, artikujt dhe rasteve studimore nga literatura bashkëkohore globale për të pasuruar procesin mësimor.
- Pjesëmarrja e pedagogëve ndërkombëtarë në mësimdhënie nëpërmjet ftesave të profesorëve vizitorë dhe ekspertëve të huaj për leksione, seminare dhe workshop-e.
- Zhvillimi i projekteve të përbashkëta në kurrikulë me synim përfshirjen e studentëve në projekte të dizajnuara bashkë me universitete partnere, duke krijuar përvoja ndërkombëtare brenda auditorit.
- Përdorimi i teknologjive digjitale për ndërveprim global, si rasti i krijimit të klasave virtuale të përbashkëta, ku studentët bashkëpunojnë me kolegë nga universitete të tjera në nivel ndërkombëtar.
- Promovimi i gjuhëve të huaja në kurrikulë nëpërmjet ngritjes së programeve mësimore në gjuhën angleze dhe gjuhë të tjera për të rritur aftësitë gjuhësore dhe ndërkulturore të studentëve.

➤ Ndërkombëtarizimi në kurrikulë është një mekanizëm i fuqishëm për të sjellë botën brenda departamentit, duke i ekspozuar studentët ndaj perspektivave globale pa qenë e nevojshme të udhëtojnë jashtë vendit. Përmes masave të parashikuara, Departamenti i Turizmit do të krijojë një mjedis akademik multikulturor, do të rrisë cilësinë e formimit profesional dhe do të përgatisë studentët për sfidat e turizmit në një kontekst ndërkombëtar.

❖ *Kërkimi shkencor dhe publikimet me bashkautorë:*

➤ Kërkimi shkencor dhe publikimet me bashkautorë janë të rëndësishme për Departamentin e Turizmit, sepse përfaqësojnë bazën e zhvillimit akademik dhe rritjes së reputacionit ndërkombëtar. Përmes kërkimit të strukturuar dhe publikimeve të përbashkëta, departamenti jo vetëm që kontribuon në literaturën shkencore mbi turizmin, por edhe forcon bashkëpunimin me universitete, institute dhe ekspertë të huaj. Kjo qasje e bën departamentin pjesë aktive të dialogut global mbi turizmin e qëndrueshëm, inovacionin digjital dhe politikat e zhvillimit.

➤ Departamenti i Turizmit për të fuqizuar kërkimin shkencor dhe publikimet me bashkautorë synon të ndërmarrë masa të qarta, si:

- Nxitja e projekteve kërkimore ndërdisiplinore: Përfshirja e stafit dhe studentëve në projekte që lidhin turizmin me fusha si ekonomia, mjedisi, teknologjia digjitale dhe kultura.
- Bashkëpunimi me universitete dhe institute ndërkombëtare: Krijimi i ekipeve kërkimore të përbashkëta për studime krahasuese dhe projekte të financuara nga programe si Horizon Europe, Erasmus+ KA2/KA171 dhe Interreg.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

- Publikime me bashkautorë në revista ndërkombëtare: Inkurajimi i stafit për të botuar artikuj shkencorë në revista me faktor impakti, duke përfshirë bashkautorë nga institucione të tjera.
- Krijimi i një kulture kërkimore brenda departamentit: Organizimi i seminareve, konferencave dhe workshop-eve për prezantimin e rezultateve të kërkimit dhe për nxitjen e bashkëpunimit akademik.
- Mbështetje institucionale për publikimet: Sigurimi i fondeve dhe mekanizmave për mbulimin e kostove të publikimit në revista ndërkombëtare me akses të hapur.
- Mentorimi i studentëve në kërkim: Përfshirja e studentëve në publikime të përbashkëta me pedagogët, duke i përgatitur për karrierë akademike dhe profesionale.

➤ Kërkimi shkencor dhe publikimet me bashkautorë janë një mekanizëm i fuqishëm për rritjen e cilësisë akademike dhe reputacionit ndërkombëtar të Departamentit të Turizmit. Përmes masave të ndërhyrjes, departamenti do të krijojë një kulturë kërkimore të qëndrueshme, do të forcojë bashkëpunimin ndërkombëtar dhe do të kontribuojë në literaturën globale mbi turizmin. Kjo qasje e bën departamentin një aktor të rëndësishëm në zhvillimin e dijes dhe inovacionit në fushën e turizmit.

◆ *Evente ndërkombëtare (workshop-e, javë ndërkombëtare, konferenca):*

➤ Eventet ndërkombëtare si workshop-e, javët ndërkombëtare dhe konferenca krijojnë hapësira për shkëmbim akademik, rrjetëzim profesional dhe promovim të vizibilitetit ndërkombëtar. Përmes organizimit dhe pjesëmarrjes në këto aktivitete, Departamenti i Turizmit jo vetëm që forcon lidhjet me universitete dhe institute të huaja, por edhe u ofron studentëve dhe stafit mundësi të drejtpërdrejta për të përfituar nga praktikat më të mira globale.

➤ Departamenti i Turizmit ka në plan të ndërmarrë masa të qarta për të konsoliduar rolin e tij në organizimin dhe pjesëmarrjen në evente ndërkombëtare, si më poshtë:

- Organizimi i workshop-eve ndërkombëtare përmes fimit të ekspertëve të huaj dhe profesorëve vizitorë për të ndarë përvoja mbi turizmin e qëndrueshëm, inovacionin digjital dhe menaxhimin e destinacioneve.
- Javë ndërkombëtare për studentët dhe stafin me synimin krijimin e aktiviteteve multikulturore ku studentët dhe pedagogët ndërveprojnë me kolegë nga universitete partnere, duke përfshirë leksione të hapura, prezantime dhe projekte të përbashkëta.
- Konferenca shkencore ndërkombëtare. Organizimi i konferencave me pjesëmarrje të studiuesve dhe profesionistëve nga vende të ndryshme, për prezantimin e kërkimeve dhe publikimeve mbi turizmin.
- Pjesëmarrja aktive në rrjete akademike globale përmes angazhimit të stafit dhe studentëve në konferenca dhe kongrese ndërkombëtare, duke prezantuar punime dhe duke ndërtuar partneritete të reja.
- Promovimi i eventeve ndërkombëtare. Përdorimi i platformave digjitale dhe rrjeteve sociale



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

për të rritur vizibilitetin e aktiviteteve dhe për të tërhequr pjesëmarrës ndërkombëtarë.

- Mbështetje institucionale për pjesëmarrësit nëpërmjet sigurimit të fondeve dhe bursave për studentët dhe stafin që marrin pjesë në evente ndërkombëtare, duke lehtësuar aksesin dhe përfshirjen e gjerë.

➤ Eventet ndërkombëtare janë një mekanizëm i fuqishëm për ndërkombëtarizimin e Departamentit të Turizmit dhe për rritjen e reputacionit të tij akademik. Përmes organizimit dhe pjesëmarrjes aktive, departamenti do të krijojë një kulturë bashkëpunimi global, do të rrisë cilësinë e kërkimit dhe mësimdhënies, dhe do të pozicionohet si një aktor i rëndësishëm në rrjetet ndërkombëtare të arsimit dhe turizmit.

❖ *Marketing / komunikim ndërkombëtar:*

➤ Marketingu dhe komunikimi ndërkombëtar janë një fushë ndërhyrjeje strategjike për Departamentin e Turizmit, sepse përfaqësojnë mënyrën se si departamenti prezantohet dhe ndërvepron me publikun global. Përmes strategjive të mirëpërcaktuara të komunikimit, departamenti mund të rrisë vizibilitetin e tij, të tërheqë studentë ndërkombëtarë, të forcojë partneritetet akademike dhe të pozicionohet si një aktor i rëndësishëm në fushën e turizmit në nivel ndërkombëtar.

➤ Departamenti i Turizmit do të ndërmarrë masa të qarta për të konsoliduar marketingun dhe komunikimin ndërkombëtar:

- ⇒ Zhvillimi i një strategjie të integruar komunikimi ndërkombëtar. Hartimi i një plani të dedikuar për promovimin e programeve, aktiviteteve dhe arritjeve të departamentit në nivel global.
- ⇒ Përdorimi i platformave digjitale dhe rrjeteve sociale me synimin e krijimit të përmbajtjes multimediale (video, artikuj, intervista) në gjuhë të huaja për të rritur vizibilitetin ndërkombëtar.
- ⇒ Promovimi i programeve në gjuhë të huaja, si prezantimi i ofertës akademike në anglisht dhe gjuhë të tjera për të tërhequr studentë ndërkombëtarë.
- ⇒ Ndërtimi i një imazhi institucional ndërkombëtar përmes përdorimit të materialeve promionale (broshura, katalogë, faqe web) të standardizuara dhe të përkthyer në gjuhë të huaja.
- ⇒ Pjesëmarrja në panaire dhe forume ndërkombëtare të arsimit duke prezantuar departamentin në evente globale për të rritur njohjen dhe për të krijuar partneritete të reja.
- ⇒ Komunikim i vazhdueshëm me partnerët ndërkombëtarë me synim krijimin e kanaleve të dedikuara për shkëmbim informacioni dhe përforsim të bashkëpunimit akademik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

⇒ Tërheqja e mediave ndërkombëtare për këtë qëllim do të synohet organizimi i aktiviteteve që tërheqin vëmendjen e mediave të huaja dhe promovojnë imazhin e departamentit si një qendër akademike e turizmit.

✎ Marketingu dhe komunikimi ndërkombëtar janë instrumente kyçe për ndërkombëtarizimin e Departamentit të Turizmit. Përmes masave të parashikuara, departamenti do të rrisë vizibilitetin e tij global, do të tërheqë studentë dhe partnerë ndërkombëtarë, dhe do të krijojë një imazh të fortë institucional që reflekton cilësinë dhe profesionalizmin e tij. Kjo qasje e bën departamentin një aktor të besueshëm dhe të njohur në arenën ndërkombëtare të arsimit dhe turizmit.

❖ *Mbështetje për studentë të huaj / vizitorë.*

✎ Mbështetja për studentët e huaj dhe vizitorë është një fushë ndërhyrjeje strategjike për Departamentin e Turizmit, sepse ndikon drejtpërdrejt në përvojën e tyre akademike dhe sociale. Një sistem i mirëorganizuar mbështetjeje jo vetëm që lehtëson integrimin e studentëve ndërkombëtarë, por edhe e bën departamentin më tërheqës dhe konkurrues në arenën globale të arsimit.

✎ Departamenti i Turizmit për të forcuar mbështetjen ndaj studentëve ndërkombëtarë do të ndër marrë masa të qarta:

- Krijimi i shërbimeve të dedikuara për studentët e huaj përmes ngritjes së një grupi lektorësh për orientimin dhe asistencën e studentëve ndërkombëtarë, që të ofrojnë informacion mbi procedurat akademike dhe administrative.
- Programet e orientimit dhe integritimit kulturor kanë si synim organizimi i aktiviteteve të mirëseardhjes, prezantimeve mbi kulturën lokale dhe mentorimit nga studentët vendas.
- Mbështetje gjuhësore dhe akademike, në rastet kur studentët e huaj do të kenë nevojë për kurse gjuhësore, asistencë për shkrimin akademik dhe ndihmë në përshtatjen me metodologjitë e mësimdhënies.
- Shërbime sociale dhe praktike synohet të realizohet duke i ndihmuar ata për akomodimin, sigurimet shëndetësore, transportin dhe aksesin në shërbime të komunitetit lokal.
- Platforma digjitale për komunikim dhe informacion, më konkretisht krijimi i një portali online ku studentët e huaj mund të gjejnë udhëzime, dokumente dhe mbështetje në kohë reale.
- Aktivitete ndërkulturore me synim organizimin e eventeve që nxisin ndërveprimin mes studentëve vendas dhe të huaj, duke krijuar një mjedis multikulturor dhe të hapur.



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

- Feedback i vazhdueshëm, që kanë si qëllim krijimin e mekanizmave për mbledhjen e mendimeve dhe sugjerimeve nga studentët e huaj, për të përmirësuar shërbimet dhe përvojën e tyre.

➤ Mbështetja për studentët e huaj dhe vizitorë është një element kyç për ndërkombëtarizimin e Departamentit të Turizmit. Përmes masave të parashikuara, departamenti do të sigurojë një përvojë të plotë akademike dhe sociale për studentët ndërkombëtarë, duke e bërë institucionin më tërheqës, më mikpritës dhe më të integruar në rrjetet globale të arsimit.

4.2 Plani i veprimit (Action Plan)

Plotësoni tabelën më poshtë me aktivitetet e planifikuara.

Nr	Aktiviteti/Masa	Afati	Përgjegj ësi	Partnerë	Burime	Output/Rezultat
1	Program studimi me diplomë të dyfishtë në Master i Shkencave në "Ekonomia Mjedisore, Kulture dhe Turistike"	2025-2029	Doc.Dr. Gentian Ruspi	Universiteti Sapienza i Romës, Departamenti i Metodave dhe Modeleve për Ekonominë, Territorin dhe Financën, Romë, Itali dhe Departamenti i Turizmit, Fakulteti i Biznesit, UAMD	Mbështetjet dhe financohet në kuadër të projekteve të ndërkombëtarizimit me Universitetin e Sapienzës në Itali dhe nga UAMD.	• Rritje e mobilitetit akademik, • Zhvillim i aftësive ndërdisiplinore, • Rritje e kapaciteteve kërkimore. • Ndërveprim ndërkulturor. • Tërheqje e studentëve të huaj. • Forcim i partneriteteve institucionale. • Kontribut në zhvillimin e qëndrueshëm.
2	Programi studimi me diplomë të dyfishtë Bachelor në "Turizëm të	2026-2030	Departamenti i Turizmit	Departamenti i Shkencave Politike, Universiteti i Teramos,	Mbështetjet dhe financohet në kuadër të projekteve	• Diplomë e dyfishtë e njohur ndërkombëtarisht. • Rritje e atraktivitetit për studentët vendas dhe të huaj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

	qëndrueshëm"			Itali dhe Departament i i Turizmit, Fakulteti i Biznesit, UAMD	të ndërkombë tarizimit me Universitet in e Sapienzës në Itali dhe nga UAMD.	• Mobilitet akademik dhe kulturor. • Formim profesional i integruar. • Harmonizim i kurrikulave. • Rritje e kapaciteteve kërkimore dhe praktike. • Ndërveprim ndërkulturor dhe gjuhësor. • Forcim i partneriteteve institucionale. • Kontribut në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm.
3	Nënshkrimi i marrëveshjeve të reja ndërkombëtare për mobilitet studentor dhe stafor	2026-2030	Departamenti i Turizmit	Universitete partnere, Erasmus+	Burime e njerëzore dhe financiare të UAMD dhe financime nga BE (Erasmus +)	Rritja e numrit të marrëveshjeve dhe mundësive të mobilitetit
4	Organizimi i workshop-eve dhe pjesëmarrje e Departamentit të turizmit në javët ndërkombëtare në universitet	Çdo vit akademik	Departamenti i Turizmit, Koordinatorët e projekteve	Profesorë vizitorë, studentë ndërkombëtarë	Infrastrukturë dhe fonde nga UAMD, por edhe nga burime të tjera si Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe	Rritja e ndërveprimit ndërkulturor dhe vizibilitetit ndërkombëtar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

					Inovacionit , Be, BB etj.	
5	Aplikimi në projekte Horizon Europe dhe Interreg	2027-2 030	Persone li pjesë e Drejtori së së Projekte ve dhe Marrëdhënieve me Jashtë në UAMD, persone li akadem ik i Departa mentit të turizmit	Institute kërkimore, partnerë rajonale	Ekspertizë akademike nga burime të vet departamen tit dhe financime nga UAMD dhe programet Horizon Europe dhe Interreg	Fitimi i projekteve kërkimore dhe rritja e kapaciteteve shkencore
6	Mbështetje për studentët e huaj dhe vizitorë (orientim, mentorim, shërbime)	Çdo semest ër	Persone li që mbulon mobilitet pjesë e Drejtori së së Projekte ve dhe Marrëdhënieve me Jashtë në	Studentë mentorë, shërbime komunitare	Burime logjistike të UAMD dhe financiare në kuadër të Erasmus +.	Integrim më i lehtë i studentëve ndërkombëtarë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

			UAMD, persone li akadem ik i Departa mentit të turizmit			
7	Promovimi i Departamentit të Turizmit përmes marketingut ndërkombëtar	2025-2 026	Departa menti i Turizmi t,	Media ndërkombëta re, rrjete sociale	Burime digjitalë, fonde promocion ale të UAMD apo burimeve të tjera që mbështesin institucione t e arsimit të lartë.	Rritja e vizibilitetit dhe tërheqja e studentëve të huaj

5. Objektivat vjetore (2025–2030)

- Viti 2026: Konsolidimi i Partneriteteve dhe Rrjetëzimi Strategjik Fokusimi në rritjen e mobilitetit përmes marrëveshjeve me Universitë degli Studi di Teramo, Sapienza Università di Roma, Università degli Studi di Bari Aldo Moro dhe Klaipeda University (Lituani). Ky vit shënon nisjen e procesit për bashkëpunim zyrtar me UN Tourism (WTO) dhe aplikimet e para në Erasmus+ (KA171) dhe IPA III. Do të nisë puna përgatitore për edicionin e parë të Konferencës së Përvitshme Ndërkombëtare të Turizmit të Departamentit.
- Trajnimet Profesionale (Short Courses) dhe Konferenca Inauguruese Finalizimi i moduleve "Short Courses" (Hospitalitet, Menaxhim Destinacioni, Guida, Horeca, Marketing Digjital). Realizimi i Konferencës së Parë Ndërkombëtare të Turizmit, si platformë për rritjen e network-it me UNESCO dhe GSTC. Aplikime proaktive në Interreg dhe përfshirja e parë në COST Actions.
- Viti 2027: Inovacioni Digjital dhe Zgjerimi në Ballkan Krijimi i Labororit të Turizmit dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

Marketingut Digjital në bashkëpunim me Univerza v Mariboru dhe rrjetin WorldChefs. Organizimi i edicionit të dytë të Konferencës Ndërkombëtare me fokus te projektet Horizon Europe dhe anëtarësimi në ECTN (European Cultural Tourism Network)

- Viti 2028: Ndërkombëtarizimi i Kurrikulës dhe Diplomave të Dyfishta Arritja e objektivit për $\geq 30\%$ të moduleve në gjuhën angleze. Zhvillimi i programeve "Double Degree" me universitete si Cornell University, Universidade do Porto dhe Instituto Politécnico de Bragança (IPB). Konferenca e përvitshme do të shërbejë si forum për projektet Erasmus+ KA2 (CBHE). Perafrimi i kurrikules dhe me universitetin e Primorskem, Slloveni
- Viti 2029: Integrimi Strategjik dhe Qëndrueshmëria Konsolidimi i prezencës në COST Actions dhe rritja e impaktit të Konferencës Ndërkombëtare si pikë takimi mes akademisë dhe industrisë. Zhvillimi i projekteve me ndikim territorial përmes fondeve IPA dhe Interreg, duke pozicionuar departamentin si lider në rajon.
- Viti 2030: Liderhipi Shkencor dhe Ekselencia Ndërkombëtare Transformimi i laboratorit në qendër kërkimore të referencës. Arritja e targetit për publikime në revista të indeksuara (Scopus/Web of Science) në bashkautorësi me partnerët nga Sapienza, Teramo dhe Maribor, duke e mbyllur ciklin me një Konferencë Jubilare që certifikon suksesin e strategjisë.

6. Burimet financiare, prioritetet dhe plani financiar 2025–2030

6.1 Korniza e Përgjithshme Financiare

Financimi i veprimtarisë së Departamentit të Turizmit për periudhën 2025–2030 do të mbështetet në:

- Buxhetin vjetor institucional (Fakultet/Universitet);
- Fondet e programit Erasmus+ (KA131 / KA171);
- Projekte kombëtare dhe ndërkombëtare (KA2, CBHE, Horizon Europe, Interreg, etj.);
- Bashkëpunime me partnerë të industrisë dhe sponsorizime;
- Burime të tjera konkurruese dhe donacione.

Planifikimi financiar do të orientohet drejt realizimit të objektivave strategjike në fushën akademike, kërkimore, ndërkombëtare dhe të infrastrukturës.

6.2 Prioritizimi i Investimeve (2025–2030)

A. Prioritete Afatshkurtra (2026–2027)

Qëllimi: Konsolidimi i bazës akademike dhe rritja e kapaciteteve aplikative.

6. Përmirësimi i infrastrukturës teknologjike në auditorë
7. Mbështetje për mobilitet Erasmus+
8. Trajnime për shkrimin dhe menaxhimin e projekteve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

9. Organizimi i konferencave dhe aktiviteteve shkencore
10. Rritja e databazave dhe burimeve kërkimore

B. Prioritete Afatmesme (2027–2028)

Qëllimi: Rritja e konkurrueshmërisë akademike dhe ndërkombëtarizimit.

6. Krijimi dhe pajisja e Laboratorit të Turizmit dhe Marketingut Digjital
7. Zgjerimi i partneriteteve ndërkombëtare
8. Rritja e pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare
9. Certifikime profesionale për stafin
10. Digjitalizimi i moduleve dhe zhvillimi i moduleve në gjuhën angleze

C. Prioritete Afatgjata (2029–2030)

Qëllimi: Qëndrueshmëri financiare dhe profil i fortë kërkimor

5. Konsolidimi i laboratorit si qendër kërkimore dhe shërbimi për industrinë
6. Integrimi në konsorciume të qëndrueshme ndërkombëtare
7. Zhvillimi i projekteve me ndikim territorial
8. Rritja e të ardhurave nga projekte dhe bashkëpunime me industrinë

6.3 Plani Financiar Indikativ 2025–2030

(Vlerësim orientues – në varësi të alokimeve buxhetore dhe projekteve të fituara)

Infrastrukturë dhe Pajisje

Kategoria	2026-2027	2027-2028	2029-2030	Burimi i
	7	8		Financimit
Pajisje teknologjike për auditorë	Mesatar	—	—	Buxhet
Laboratori i Turizmit & Marketingut Digjital	—	I lartë	Mirëmbajtje	institucional
Softuerë profesionalë & databaza	Mesatar	Mesatar	Mesatar	Buxhet + Projekte

Kërkimi Shkencor dhe Projekte

Kategoria	2026-2027	2027-2028	2029-2030	Burimi
	7	8	0	
Mbështetje publike	për Mesatar	Mesatar	Mesatar	Buxhet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

Aplikime për projekte	Mesatar	I lartë	I lartë	Projekte	
Organizim konferencash	Mesatar	Mesatar	Mesatar	Buxhet	+
				Sponsorizime	

Ndërkombëtarizimi dhe Mobiliteti

Kategoria	2026-2027	2027-2028	2029-2030	Burimi	
	7	8	0		
Mobilitet studentor	I lartë	I lartë	I lartë	Erasmus+	
Mobilitet stafit	Mesatar	I lartë	I lartë	Erasmus+	
Guest lectures	Mesatar	Mesatar	Mesatar	Buxhet	+
ndërkombëtare				Projekte	

Zhvillimi i Kapaciteteve

Kategoria	2026-2027	2027-2028	2029-2030	Burimi	
	7	8	0		
Trajnime për projekte	Mesatar	Mesatar	Mesatar	Buxhet	+
				Projekte	
Pjesëmarrje në konferenca	Mesatar	I lartë	I lartë	Projekte	
Certifikime profesionale	—	Mesatar	Mesatar	Buxhet	

6.4 Mekanizmi i Monitorimit Financiar

- Planifikim vjetor në përputhje me buxhetin institucional;
- Raportim financiar vjetor në nivel Departamenti dhe Fakulteti;
- Monitorim i realizimit të investimeve sipas prioriteteve;
- Analizë periodike e raportit midis investimit dhe performancës (KPI).
-

6.5 BUXHETI INDIKATIV 2025-2030

Buxheti indikativ paraqet shpërndarjen përqindore të fondeve të disponueshme nga burime të kombinuara (buxhet institucional, projekte, Erasmus+, sponsorizime), në funksion të realizimit të objektivave strategjike të Departamentit të Turizmit.

Shpërndarja e Buxhetit sipas Fushave Prioritare

Fusha Strategjike	%	e	Buxhetit	Total
-------------------	---	---	----------	-------



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

	(orientuese)
Infrastrukturë dhe Pajisje (Laborator, teknologji, softuerë)	30%
Kërkimi Shkencor dhe Projekte	20%
Ndërkombëtarizimi dhe Mobiliteti	20%
Zhvillimi i Kapaciteteve (trajnim, konferenca, certifikime)	15%
Aktivitetet Akademike & Evente Shkencore	10%
Rezervë Strategjike / Iniciativa të reja	5%
Totali	100%

2. Shpërndarja sipas Periudhave Kohore

2026–2027 (Faza e Konsolidimit) do të ketë në fokus forcimin e bazës teknologjike dhe rritja e kapaciteteve aplikative.

- Infrastrukturë bazë dhe pajisje teknologjike: 35%
- Ndërkombëtarizimi: 20%
- Kërkimi: 15%
- Trajnime & kapacitete: 15%
- Evente dhe aktivitete: 10%
- Rezervë: 5%

2027–2028 (Faza e Zhvillimit) do të ketë në fokus Investimin e lartë në laborator dhe zgjerim ndërkombëtar.

- Laboratori i Turizmit & Marketingut Digjital: 40%
- Projekte dhe kërkim: 20%
- Ndërkombëtarizimi: 20%
- Zhvillimi i kapaciteteve: 10%
- Evente: 5%
- Rezervë: 5%

2029–2030 (Faza e Konsolidimit Strategjik) do të ketë në fokus Qëndrueshmëri financiare dhe profil i fortë kërkimor.

- Mirëmbajtje infrastrukture & zhvillim laborator: 25%
- Projekte dhe kërkim i avancuar: 25%
- Ndërkombëtarizimi: 20%
- Zhvillim kapacitetesh: 15%
- Evente dhe aktivitete: 10%
- Rezervë strategjike: 5%

6.6 Parime të Menaxhimit Financiar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

1. Transparencë dhe raportim periodik në nivel Departamenti dhe Fakulteti;
2. Harmonizim i investimeve me KPI-të strategjikë;
3. Prioritizim i fondeve drejt aktiviteteve me ndikim të matshëm akademik dhe kërkimor;
4. Diversifikim i burimeve të financimit për të reduktuar varësinë nga buxheti institucional;
5. Rishikim vjetor i strukturës së alokimit financiar në bazë të performancës dhe nevojave.

7. KPI dhe monitorimi

7.1 Ndërkombëtarizimi dhe Mobiliteti

Objektivi Strategjik	Treguesi (KPI)	Baseline (2024)	Target	Afati	Njësia Përgjegjëse	Instrumenti i Verifikimit
Rritja e ndërkombëtarizimit	Nr. studentëve në mobilitet dalës	2 studentë	≥ 6 studentë/vit	2026-2028	Koordinatori i Ndërkombëtarizimit	Raport Erasmus+, evidenca zyrtare
	Nr. studentëve në mobilitet hyrës	0-1	≥ 10 studentë/vit	2026-2028	Koordinatori i Ndërkombëtarizimit	Marrëveshje & regjistrime
	Nr. mobiliteteve të stafit	6 mobilitete	≥ 8 /vit	2026-2028	Përgjegjësi i Departamentit	Raport vjetor
	Nr. marrëveshjeve aktive ndërkombëtare	3	≥ 5	2026-2027	Departamenti	Arkiva e marrëveshjeve

7.2 Projekte dhe Partneritet

Objektivi Strategjik	Treguesi (KPI)	Baseline	Target	Afati	Njësia Përgjegjëse	Instrumenti i Verifikimit
Rritja e kapacitetit aplikues	Nr. aplikimeve për projekte	3/vit	≥ 5 /vit	2026-2028	Koordinatori i Projekteve	Dosje aplikimesh
	Nr. projekteve të fituara	3	≥ 4 aktive/vit	2026-2028	Departamenti	Kontrata projektesh



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

Nr. marrëveshjeve me industrinë	6	≥ 10	2026–2029	Përgjegjësi i Departamentit	Memorandume bashkëpunimi
Nr. aktiviteteve me aktorë të industrisë	3/vit	$\geq 6/vit$	2026–2028	Departamenti	Raporte aktiviteteve

7.3 Zhvillimi akademik dhe Kurrikular

Objektivi Strategjik	Treguesi (KPI)	Baselin e	Target	Afati	Njësia Përgjegjëse	Instrumenti i Verifikimit
Modernizimi i ofertës akademike	% moduleve në anglisht	<10%	$\geq 30\%$	2026–2028	Koordinatori i Cilësisë	Plani mësimor
	Nr. programeve me komponent ndërkombëtar	1	≥ 2	2026–2028	Departamenti	Vendime Senati
	Niveli i kalueshmërisë	80%	$\geq 85\%$	Vjetor	Sekretaria Mësimore	Statistika akademike
	Nr. guest lectures	2/vit	$\geq 4/vit$	2026–2028	Departamenti	Procesverbale aktiviteteve
	% studentëve në praktikë	75%	100% (prof.) $\geq 80\%$ (BA)	2026–2028	Koordinatori i Praktikave	Kontrata praktike

7.4 Kërkimi Shkencor

Objektivi Strategjik	Treguesi (KPI)	Baseline	Target	Afati	Njësia Përgjegjëse	Instrumenti i Verifikimit
Forcimi i profilit kërkimor	Nr. publikimeve shkencore	15 (3 vite)	≥ 20 (3 vite)	2026-2029	Stafi Akademik	Lista e publikimeve
	Publikime në revista të indeksuara	3/vit	$\geq 5/vit$	Vjetor	Departamenti	Database shkencore
	Bashkautorësi ndërkombëtare	1–2	$\geq 3/vit$	2026–2028	Stafi Akademik	Publikime



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

Nr. konferencave të organizuara	1/vit	≥ 2 /vit	2026–2028	Departamenti	Raporte aktivitetesh
Studentë në kërkim	5	≥ 15 /vit	2026–2028	Koordinatori i Kërkimit	Evidencë projektsh

7.5 Mekanizmi i Monitorimit

Elementi	Përshkrimi
Frekuenca e monitorimit	Semestrale për treguesit akademikë; Vjetore për mobilitet, projekte dhe kërkim
Forma e raportimit	Raport Vjetor i Departamentit; Analizë KPI; Prezantim në Këshillin e Fakultetit
Instrumente	Matrica KPI; analiza statistikore; anketime studentore; feedback nga partnerët
Organ përgjegjës për vlerësim	Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me Koordinatorin e Cilësisë

8. Struktura e zbatimit dhe përgjegjësitë

Për të garantuar një zbatim kapilar, strategjia mbështetet në një model gjithëpërfshirës (Top-Down & Bottom-Up):

- Drejtuesi i Departamentit: Mbikëqyr strategjinë, udhëheq marrëveshjet me BB, Universitet Partnere dhe projektet madhore (Horizon/IPA/ Erasmus).
- Koordinatorët e Programeve: Monitorojnë ndërkombëtarizimin brenda programeve (mobiliteti, ECTS, modulet në anglisht).
- Stafi Akademik (Gjithëpërfshirja): Çdo anëtar i stafit angazhohet në të paktën një projekt ndërkombëtar ose COST Action, udhëheq modulet e "Short Courses" dhe kontribuon në konferencën e përvitshme. Stafi shërben si mentor për kërkuesit e rinj.
- Studentët Ekselentë dhe "Observatori i Turizmit":
 - o Promovimi: Studentët me rezultate të larta do të angazhohen si "Ambasadorë të Ndërkombëtarizimit", duke asistuar në pritjen e studentëve të huaj dhe promovimin e mobilitetit.
 - o Përgatitja si Kërkues: Studentët ekselentë do të integrohen në punën e Observatorit të Turizmit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të terrenit.
 - o Junior Researchers: Përmes laboratorit, studentët do të trajnohen për shkencën e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

artikujve shkencorë dhe pjesëmarrjen në konferenca, duke krijuar një "pishinë" talenti për kërkimin shkencor të ardhshëm.

- Bordi i Konferencës dhe Projekteve: Koordinon organizimin e aktivitetit vjetor dhe aplikimet në Erasmus+ dhe Interreg.

9. Menaxhimi i riskut

Më poshtë paraqitet matrica e vlerësimit të rreziqeve potenciale, e cila detajon masat parandaluese dhe planet alternative për të garantuar zbatimin me sukses të objektivave strategjike të departamentit deri në vitin 2030

N r	Rreziku	Probabiliteti	Ndikimi	Masa parandaluese	Plan B
1	Shkalla e ulët e suksesit në aplikime (Horizon, IPA, Interreg)	Mesatar	I lartë	Trajnime për stafin në shkrimin e projekteve dhe krijimi i konsorciumeve me partnerë si Sapienza Università di Roma .	Rishikim i aplikimit për thirrjet e radhës dhe kërkim i fondeve alternative përmes donatorëve ose partneriteteve private.
2	Vonesa në përgatitjen dhe lançimin e "Short Courses" (2026)	Mesatar	Mesatar	Caktimi i grupeve të punës për çdo fushë (Horeca, Marketing, Guida) që në vitin 2026 dhe monitorimi i rreptë i afateve.	Ofrimi i moduleve si seminare trajnimi pilot në bashkëpunim me specialistë të industrisë vendase.
3	Angazhim i pamjaftueshëm i studentëve ekselentë në kërkim	Mesatar	Mesatar	Krijimi i skemave incentivuese, certifikimi i punës kërkimore dhe promovimi i Observatorit të Turizmit si mundësi karriere.	Integrimi i praktikës kërkimore në Observator si pjesë e kurrikulës mësimore (puna e diplomës).
4	Mungesa e qëndrueshmërisë së Konferencës së përvitshme	Ulët	Mesatar	Krijimi i një Bordi Shkencor Ndërkombëtar me profesorë nga	Bashkë-organizimi i konferencës me një universitet partner jashtë vendit për të ndarë kostot dhe buroret.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

				Universitete partnere	
5	Barriera gjuhësore për stafin dhe modulet në anglisht	Mesatar	I lartë	Ofrimi i kurseve intensive të gjuhës angleze për stafin akademik dhe mbështetje për certifikime profesionale.	Angazhimi i profesorëve vizitorë nga universitetet partnere për bashkë-mësimdhënie (Co-teaching).
6	Mungesa e monitorimit efektiv nga koordinatorët e programeve	Ulët	I lartë	Përfshirja e detyrave të monitorimit të ndërkombëtarizimit në ngarkesën vjetore dhe raportimi periodik në mbledhjet e departamentit.	Audit i brendshëm semestral nga Përgjegjësi i Departamentit për të verifikuar treguesit KPI të çdo programi.

Departamenti i Financë Kontabilitet

1. Baza ligjore dhe dokumentet referuese

Departamenti i Financë-Kontabilitetit, si një nga njësitë bazë të Fakultetit të Biznesit në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, operon në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar dhe dokumentet strategjike institucionale. Strategjia e ndërkombëtarizimit të departamentit për periudhën 2025–2030 mbështetet në vizionin e universitetit për profilizim ndërkombëtar dhe në dokumentet e miratuara nga Senati Akademik, duke e lidhur zhvillimin e tij me standardet evropiane të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Kuadri ligjor kombëtar

Ligji Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".

Ligji Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike".

Udhëzimi Nr. 20, datë 09.05.2008 "Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë".

Dokumente institucionale të UAMD



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

Vendimi i Senatit Akademik Nr. 138, datë 21.11.2025 dhe Vendimi Nr. 176, datë 17.12.2025 mbi miratimin e Projekt-Strategjisë së Profilizimit të UAMD përmes ndërkombëtarizimit 2025–2030. Strategji e Ndërkombëtarizimit të UAMD 2025–2030, objektivat e përgjithshme të universitetit: transformimi digjital, ndërkombëtarizimi i arsimit dhe kërkimit shkencor, si dhe roli i UAMD si motor zhvillimi rajonal.

Plani Strategjik i Departamentit Financë-Kontabilitet 2021-2025, bazë për vijimësinë e strategjisë së re, duke theksuar edukimin cilësor, kërkimin shkencor dhe rrjetëzimin ndërkombëtar.

Kuadrot strategjike ndërkombëtare

European Higher Education Area (EHEA) – Procesi i Bolonjës, harmonizimi i kurrikulave, kreditimi ECTS dhe sigurimi i cilësisë akademike.

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë – Kuadri i sigurimit të cilësisë/akreditimit dhe referencat ligjore.

Ligji nr. 10 247, datë 04.03.2010 'Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve', i ndryshuar me ligjin nr. 23/2018, datë 10.05.2018.

Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 – mbi orientimin për kërkim/inovacion dhe integrim ndërkombëtar.

Erasmus+ (KA131/KA171, KA2, CBHE), mobiliteti i studentëve dhe stafit, projektet e bashkëpunimit akademik.

Horizon Europe 2021–2027, programi i kërkimit shkencor dhe inovacionit të BE.

Agenda 2030 e OKB (SDGs): veçanërisht SDG 4 (arsimi cilësor), SDG 8 (punë dinjitoze dhe rritje ekonomike), SDG 9 (infrastrukturë dhe inovacion), SDG 17 (partneritete ndërkombëtare).

Strategjia Evropiane për Rininë 2019–2027 dhe Strategjia Globale e OKB për Rininë "Youth 2030", përfshirja e studentëve në mobilitet, sipërmarrje dhe inovacion social.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 dhe Strategjia e BE për Barazinë Gjinore 2020–2025, gjithëpërfshirja dhe barazia në arsimin e lartë.

2. Qëllimi i Strategjisë së Departamentit

Departamenti i Financë-Kontabilitetit synon të konsolidojë rolin e tij si një qendër akademike dhe kërkimore me profil ndërkombëtar, duke kontribuar në vizionin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" për t'u profilizuar përmes ndërkombëtarizimit. Strategjia e periudhës 2025–2030 ka për qëllim të rrisë cilësinë akademike dhe relevancën e programeve, të zgjerojë bashkëpunimet dhe projektet ndërkombëtare, si dhe të ndërkombëtarizojë programet e studimit përmes harmonizimit të kurrikulave, rezultateve të të nxënies dhe metodologjive të mësimdhënies me kuadrot evropiane dhe globale të arsimit të lartë. Në këtë kuadër, departamenti do të synojë zhvillimin e moduleve me komponent ndërkombëtar, rritjen e mobilitetit të studentëve dhe stafit, bashkë-mësimdhënien me partnerë të huaj dhe krijimin e mundësive për programe të përbashkëta ose mikrokredenciale, duke garantuar standarde të matshme cilësie dhe transparence.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

Qëllime specifike në kuadër të ndërkombëtarizimit

Në kuadër të strategjisë së ndërkombëtarizimit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" për profilizim ndërkombëtar dhe në përputhje me dokumentet e miratuara nga Senati Akademik, qëllimet specifike të ndërkombëtarizimit për periudhën 2025–2030 janë konceptuar si një mekanizëm i qartë për të rritur cilësinë akademike, për të zgjeruar rrjetet e bashkëpunimit dhe për të forcuar integrimin e programeve të studimit në standardet evropiane dhe globale.

Këto qëllime nuk janë thjesht orientime të brendshme, por pjesë e një strategjie gjithëpërfshirëse që lidhet drejtpërdrejt me marrëveshjet ndërkombëtare si Procesi i Bolonjës (EHEA), Erasmus+, Horizon Europe, si dhe me objektivat e Agjendës 2030 të OKB-së për zhvillim të qëndrueshëm. Përmes tyre synohet:

- *Harmonizimi me strategjitë institucionale të UAMD*

Përputhja e programeve të departamentit me objektivat e profilizimit të universitetit, duke synuar që të paktën dy programe të ofrohen në gjuhë të huaj deri në vitin 2027.

Integrimi i moduleve ndërkulturore dhe teknologjike, në përputhje me orientimet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) dhe Procesit të Bolonjës.

- *Edukimi dhe mësimdhënia ndërkombëtare*

Zhvillimi i programeve të përbashkëta dhe diplomave të dyfishta, në linjë me objektivat e UAMD për të arritur $\geq 20\%$ të mësimin në anglisht deri në vitin 2030.

Ofrimi i leksioneve të hapura dhe shkëmbimeve akademike me profesorë nga universitete partnere.

- *Kërkimi shkencor dhe inovacioni*

Rritja e pjesëmarrjes së stafit në projekte Horizon Europe dhe Erasmus+, duke ndërtuar rrjete kërkimore ndërkombëtare.

Nxjitja e prodhimit shkencor të stafit të departamentit me fokus të publikimet në revista të indeksuara në Scopus dhe Web of Science dhe rritja e impaktit bibliometrik, në mënyrë që stafi të pozicionohet më mirë në renditje/klasifikime kombëtare dhe të rrisë vizibilitetin e tij në hapësirën akademike evropiane.

- *Mobiliteti akademik*

Zgjerimi i mobilitetit të studentëve dhe stafit përmes Erasmus+ (KA131/KA171) dhe projekteve rajonale (Interreg, RYCO).

Pritja e studentëve të huaj dhe ofrimi i mbështetjes për integrimin e tyre akademik e social.

- *Rrjetet e bashkëpunimit dhe impakti rajonal*

Bashkëpunim me universitete evropiane dhe institucione financiare ndërkombëtare për praktika profesionale dhe punësim të studentëve.

Kontribut aktiv në zhvillimin socio-ekonomik të qytetit të Durrësit, në përputhje me vizionin e UAMD si motor i zhvillimit rajonal.

- *Barazia dhe gjithëpërfshirja*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

Promovimi i barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale në të gjitha programet dhe aktivitetet, në përputhje me prioritetet strategjike të UAMD dhe BE-së.

3. Ndërkombëtarizimi, gjendja aktuale

Departamenti ka ndërtuar një profil të qartë ndërkombëtar përmes bashkëpunimeve të vazhdueshme akademike dhe profesionale. Marrëveshjet e bashkëpunimit me universitete europiane kanë mundësuar mobilitete të studentëve dhe stafit, si dhe pjesëmarrjen në projekte Erasmus+ që kanë sjellë risi në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Krahas kësaj, janë krijuar lidhje të forta me institucione financiare, kompani sigurimesh dhe organizata profesionale, të cilat ofrojnë mundësi praktike dhe punësimi për studentët, duke i përgatitur ata për tregun e punës kombëtar dhe ndërkombëtar. Departamenti është gjithashtu pjesë e rrjeteve akademike të UAMD (tabela 1), ku përfshihen programe të përbashkëta dhe diploma të dyfishta, duke e vendosur atë në një pozicion të qartë për integrim në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

Partneritete aktive/ekzistuese

Partneritetet aktive dhe ekzistuese të departamentit përfaqësojnë një bazë të fortë për ndërkombëtarizimin e tij. Marrëveshjet e bashkëpunimit me universitete europiane kanë mundësuar mobilitete të studentëve dhe stafit, si dhe pjesëmarrjen në projekte Erasmus+ që kanë sjellë përfitime të dukshme në cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Krahas këtyre, janë krijuar lidhje të qëndrueshme me institucione financiare, kompani sigurimesh dhe organizata profesionale, të cilat ofrojnë mundësi praktike dhe punësimi për studentët, duke i përgatitur ata për sfidat e tregut të punës ndërkombëtar. Departamenti është gjithashtu pjesë e rrjeteve akademike të UAMD, ku përfshihen programe të përbashkëta dhe diploma të dyfishta në nivel fakulteti dhe universiteti, duke e vendosur atë në një pozicion të qartë për integrim në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

Mobilitetet e realizuara

Gjatë tre viteve të fundit, mobilitetet kanë qenë një element kyç në ndërkombëtarizimin e departamentit. Stafi akademik ka marrë pjesë në mobilitete mësimdhënie dhe trajnimi në kuadër të programit Erasmus+, duke sjellë përvoja të reja pedagogjike dhe metodologjike në auditorët e UAMD. Studentët kanë përfituar nga mundësitë e mobilitetit për studime dhe praktika profesionale në universitete dhe institucione financiare, duke u ekspozuar ndaj standardeve ndërkombëtare të arsimit dhe tregut të punës. Këto mobilitete kanë kontribuar në forcimin e lidhjeve ndërkombëtare të departamentit dhe kanë sjellë risi në mësimdhënie e kërkim shkencor.

Projekte (Erasmus+/të tjera) ku departamenti ka qenë i përfshirë

Departamenti ka qenë i angazhuar në projekte të shumta Erasmus+, duke përfshirë projektet KA1 për mobilitet të studentëve dhe stafit, si dhe projektet KA2 për zhvillimin e kurrikulave dhe inovacionin në mësimdhënie. Paralelisht, departamenti ka marrë pjesë edhe në iniciativa dhe projekte kombëtare (p.sh. në projekte kombëtare si AKSHI/UAMD/READ), me fokus në përmirësimin e infrastrukturës,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

ritje kapacitetesh dhe përmirësim të proceseve akademike. Përveç Erasmus+, departamenti ka marrë pjesë në konferenca dhe projekte kërkimore ndërkombëtare, duke kontribuar me publikime të përbashkëta në revista shkencore të indeksuara. Gjithashtu, është angazhuar në nisma rajonale dhe evropiane që lidhen me menaxhimin e riskut dhe zhvillimin e industrisë së sigurimeve, duke forcuar profilin e tij akademik dhe profesional.

Kapacitete dhe burime (staf, infrastrukturë, laboratorë, programe)

Departamenti disponon një staf akademik të përkushtuar, me eksperiencë të fituara brenda dhe jashtë vendit, i cili është i angazhuar në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Ai ofron programe studimi të akredituara në Bachelor (Financë-Kontabilitet, Bankë-Financë), Master Shkencor dhe Master Profesional, si dhe Doktoratë në Shkenca Ekonomike. Departamenti ka investuar në ndërtimin dhe përmirësimin e një infrastrukture moderne mësimore dhe kërkimore, duke përfshirë laboratorë për studentët e ciklit Bachelor, Master dhe Doktoraturë, auditorë bashkëkohorë, si dhe akses të zgjeruar në literaturë dhe burime të përditësuara akademike. Departamenti merr pjesë rregullisht në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, duke kontribuar me publikime në revista të indeksuara. Gjithashtu, mbështetet nga UAMD në procesin e digjitalizimit të shërbimeve dhe integrimin e teknologjive të reja në mësimdhënie, duke e bërë atë më konkurrues në nivel ndërkombëtar.

4. Objektivat strategjike 2025–2030

OS1: Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe përafrimi me standardet evropiane

Departamenti i Financë-Kontabilitetit në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës synon rritjen e qëndrueshme të cilësisë së mësimdhënies përmes përditësimit dhe modernizimit të programeve të studimit, në përputhje me zhvillimet bashkëkohore në financë dhe kontabilitet. Gjatë periudhës 2025–2030, prioritet do të ketë rishikimi periodik i kurrikulave, forcimi i rezultateve të nxënies të orientuara drejt kompetencave, si dhe harmonizimi i tyre me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (EQF) dhe standardet e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë.

Në këtë kuadër, Departamenti do të zgjerojë përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies, duke përfshirë mësimin e bazuar në problem (PBL), studimet e rasteve reale, simulimet financiare dhe integrimin sistematik të platformave digjitale. Departamenti do të zgjerojë përdorimin e metodave praktike dhe inovative në mësimdhënie, duke integruar më shumë qasje të bazuara në problem, studime rasti, ushtrime aplikative, simulime dhe përdorim sistematik të platformave digjitale. Një prioritet do të jetë forcimi i komponentit laboratorik, me synim rritjen e aftësive praktike të studentëve dhe lidhjen më të ngushtë të njohurive të kontabilitetit me financën, analizën dhe tregjet.

Në këtë kuadër, laboratorët dhe mjetet mbështetëse (p.sh. FinBook Lab) do të shërbejnë për zhvillimin e moduleve praktike të integruara (p.sh. Financa 5 dhe lëndë të ngjashme), ku studentët punojnë me të dhëna reale, analiza të pasqyrave, raportim dhe vendimarrje financiare. Gjithashtu, do të integrohet përdorimi i platformave profesionale si Capital IQ për analizë kompanish, krahasim sektorial,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

vlerësim (valuation), risk/return dhe hartim raportesh analitike, si dhe mjeteve praktike të kontabilitetit si QuickBooks për të forcuar kompetencat teknike dhe aftësitë e kërkuara nga tregu i punës.

Këto ndërhyrje do të shoqërohen me standardizim të materialeve laboratorike (manuale, ushtrime, rubrika vlerësimi), si dhe me mekanizma të matshëm për vlerësimin e efektit në kompetencat e studentëve dhe punësueshmërinë e tyre.

Paralelisht, Departamenti do të forcojë sistemin e sigurimit të cilësisë përmes mekanizmave të brendshëm të monitorimit, analizës së performancës akademike dhe përdorimit të rregullt të feedback-ut të studentëve, duke i kthyer gjetjet në masa konkrete për përmirësim të vazhdueshëm.

Si drejtime strategjike të zhvillimit akademik dhe ndërkombëtarizimit për periudhën 2025–2030, Departamenti parashikon:

- Integrimi i kornizës ACCA në programin *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet* do të realizohet përmes rishikimit të plan-mësimit dhe përafrimit të përmbajtjeve me standardet profesionale ndërkombëtare, me synim rritjen e relevancës profesionale dhe konkurrueshmërisë së të diplomuarve.
- Zhvillimi i diplomave duale dhe zgjerimi/promovimi i programeve në gjuhën angleze për programet bachelor por jo vetëm, të cilat do të shërbejnë si instrumente për rritjen e llojshmërisë së ofertës akademike, tërheqjen e studentëve ndërkombëtarë dhe forcimin e profilit ndërkombëtar të Departamentit.
- Në funksion të rritjes së cilësisë dhe zbatimit të rekomandimeve të ASCAL, Departamenti do të ndërmarrë riorganizime të planifikuara në nivel kurrikule dhe organizimi mësimor—të harmonizuara me proceset e ndërkombëtarizimit dhe zhvillimin e diplomave duale—si dhe do të forcojë sigurimin e brendshëm të cilësisë, me synim standardizimin e proceseve dhe rritjen e provueshmërisë së rezultateve.

OS2: Zhvillimi i kërkimit shkencor dhe rritja e publikimeve akademike

Një nga prioritetet kryesore strategjike të departamentit është forcimi i kërkimit shkencor dhe rritja e ndikimit akademik në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Për periudhën 2025–2030, departamenti do të mbështesë zhvillimin e kërkimit të aplikuar dhe teorik në fushat e financës, kontabilitetit, auditimit, menaxhimit financiar dhe politikave fiskale. Do të nxitet publikimi i punimeve shkencore në revista ndërkombëtare të indeksuara (Scopus, Web of Science), si dhe pjesëmarrja aktive në konferenca shkencore ndërkombëtare. Departamenti synon të krijojë një kulturë të fortë kërkimore përmes mentorimit të stafit të ri akademik, krijimit të grupeve kërkimore tematike dhe lidhjes së temave të diplomave dhe doktoraturave me prioritetet kërkimore të departamentit dhe nevojat e ekonomisë kombëtare. Një rol të rëndësishëm do të ketë edhe përfshirja në projekte kërkimore të financuara nga programe kombëtare dhe ndërkombëtare, duke rritur kapacitetet kërkimore dhe burimet financiare të departamentit, si dhe duke forcuar reputacionin akademik të Fakultetit të Biznesit.

OS3: Forcimi i lidhjes me tregun e punës dhe aktorët institucionalë

Departamenti i Financë-Kontabilitetit synon të ndërtojë dhe konsolidojë ura të qëndrueshme bashkëpunimi me tregun e punës dhe institucionet publike dhe private. Gjatë periudhës 2025–2030, do



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

të intensifikohet bashkëpunimi me banka, institucione financiare, administratën tatimore, institucionet e auditimit, shoqatat profesionale të kontabilistëve dhe bizneset lokale e rajonale. Ky bashkëpunim do të reflektohet në ofrimin e praktikave profesionale për studentët, përfshirjen e ekspertëve të jashtëm si lektorë të ftuar, organizimin e trajnimeve profesionale dhe aktiviteteve të përbashkëta shkencore dhe profesionale. Departamenti do të angazhojë palët e interesit në procesin e rishikimit të programeve studimore, duke siguruar që kompetencat e fituara nga studentët të jenë të përshtatura me nevojat reale të tregut të punës. Në këtë kuadër, do të promovohet edhe sipërmarrja, edukimi financiar dhe përgatitja e studentëve për certifikime profesionale në fushën e financës dhe kontabilitetit, duke rritur punësueshmërinë dhe konkurrueshmërinë e të diplomuarve.

OS4: Ndërkombëtarizimi dhe zhvillimi i kapaciteteve akademike

Ndërkombëtarizimi përbën një shtyllë thelbësore të zhvillimit strategjik të departamentit. Për periudhën 2025–2030, synohet rritja e mobilitetit akademik të stafit dhe studentëve përmes pjesëmarrjes aktive në programe si Erasmus+, COST Actions, Horizon Europe, Jean Monnet dhe iniciativa të tjera ndërkombëtare. Departamenti do të inkurajojë zhvillimin e marrëveshjeve dypalëshe me universitete dhe institucione kërkimore europiane, si dhe bashkëautorësinë e publikimeve shkencore me partnerë ndërkombëtarë. Një fokus i veçantë do t'i kushtohet rritjes së kapaciteteve profesionale të stafit akademik përmes trajnimeve, shkëmbimeve akademike dhe pjesëmarrjes në rrjete ndërkombëtare kërkimore. Në të njëjtën kohë, do të promovohet përdorimi i gjuhëve të huaja në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, si dhe ofrimi i moduleve ose programeve të përbashkëta studimore, duke rritur dukshmërinë dhe konkurrueshmërinë ndërkombëtare të Departamentit të Financë-Kontabilitetit dhe të Fakultetit të Biznesit në tërësi.

4.1 Fushat e ndërhyrjes dhe masat kryesore

Mobiliteti i studentëve

Mobiliteti i studentëve përbën një element kyç në procesin e ndërkombëtarizimit dhe zhvillimit akademik të Fakultetit të Biznesit. Gjatë periudhës strategjike, synohet rritja graduale e pjesëmarrjes së studentëve në programe mobiliteti ndërkombëtar, veçanërisht përmes Erasmus+ (KA131/KA171) dhe marrëveshjeve dypalëshe me universitete partnere. Masat kryesore do të fokusohen në informimin dhe orientimin e studentëve mbi mundësitë e mobilitetit, thjeshtimin e procedurave administrative, garantimin e njohjes akademike të krediteve dhe integrimin e përvojës së mobilitetit në trajektoren akademike të studentit. Mobiliteti synon jo vetëm përfitimin akademik, por edhe zhvillimin e kompetencave ndërkulturore, gjuhësore dhe profesionale.

Mobiliteti i stafit (teaching/training)

Mobiliteti i stafit akademik dhe administrativ për mësimdhënie dhe trajnim përbën një instrument të rëndësishëm për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe menaxhimit institucional. Fakulteti do të inkurajojë pjesëmarrjen e stafit në mobilitete teaching dhe training, duke promovuar shkëmbimin e praktikave më të mira, transferimin e njohurive dhe përditësimin profesional. Përmes mobilitetit, stafi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

akademik do të kontribuojë në mësimdhënie në universitete partnere, ndërsa do të përfitojë nga përvoja ndërkombëtare në metodat pedagogjike, kërkimin shkencor dhe përdorimin e teknologjive inovative në arsim.

Projekte dhe fonde (KA2/KA171/Horizon/Interreg, etj.)

Angazhimi aktiv në projekte dhe programe të financuara nga Bashkimi Evropian dhe donatorë ndërkombëtarë përbën një prioritet strategjik. Fakulteti i Biznesit synon të rrisë kapacitetet për aplikim dhe menaxhim projektesh në kuadër të Erasmus+ KA2, KA171, Horizon Europe, Interreg dhe programe të tjera rajonale. Masat përfshijnë krijimin e ekipeve të specializuara, trajnimin e stafit për shkrimin e projekteve dhe ndërtimin e partneriteteve strategjike ndërkombëtare. Projektet do të shërbejnë si instrument për modernizimin e kurrikulave, zhvillimin e kërkimit shkencor, rritjen e mobilitetit dhe forcimin e lidhjes me sektorin publik dhe privat.

Programe të përbashkëta / diploma të dyfishta

Zhvillimi i programeve të përbashkëta dhe diplomave të dyfishta përfaqëson një nivel të avancuar të ndërkombëtarizimit. Fakulteti synon të eksplorojë dhe të zhvillojë programe të përbashkëta studimi me universitete partnere europiane dhe rajonale, veçanërisht në fushat e financës, kontabilitetit dhe menaxhimit. Këto programe do të kontribuojnë në rritjen e cilësisë akademike, përmirësimin e reputacionit ndërkombëtar dhe rritjen e atraktivitetit për studentët vendas dhe të huaj. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet harmonizimit të kurrikulave, sigurimit të cilësisë dhe njohjes reciproke të diplomave.

Ndërkombëtarizimi në kurrikulë

Ndërkombëtarizimi në kurrikulë përbën një komponent thelbësor për studentët që nuk kanë mundësi të përfitojnë nga mobiliteti fizik. Fakulteti do të integrojë dimensionin ndërkombëtar në programet e studimit përmes përdorimit të literaturës ndërkombëtare, studimeve të rasteve globale, mësimdhënies në gjuhë të huaj, si dhe përfshirjes së pedagogëve të huaj si lektorë të ftuar. Kjo qasje synon të zhvillojë te studentët perspektiva ndërkombëtare, kompetenca ndërkulturore dhe aftësi për të operuar në një mjedis profesional global.

Kërkimi shkencor dhe publikimet me bashkëautorë

Ndërkombëtarizimi i kërkimit shkencor është një prioritet strategjik i Fakultetit të Biznesit. Gjatë periudhës në fjalë, do të nxitet bashkëpunimi kërkimor me universitete dhe institute ndërkombëtare, duke promovuar publikime të përbashkëta në revista shkencore të indeksuara dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare. Masat kryesore përfshijnë krijimin e rrjeteve kërkimore, përfshirjen e stafit të ri akademik në projekte kërkimore dhe lidhjen e temave të doktoraturës me prioritetet kërkimore ndërkombëtare.

Evente ndërkombëtare (workshop-e, javë ndërkombëtare, konferenca)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

Organizimi i eventeve ndërkombëtare përbën një mjet të rëndësishëm për rritjen e dukshmërisë akademike dhe forcimin e rrjeteve bashkëpunuese. Fakulteti synon të organizojë workshop-e tematike, javë ndërkombëtare dhe konferenca shkencore me pjesëmarrje të gjerë ndërkombëtare. Këto aktivitete do të kontribuojnë në shkëmbimin e ideve, prezantimin e rezultateve kërkimore dhe krijimin e mundësive të reja për bashkëpunim akademik dhe profesional.

Marketingu dhe komunikimi ndërkombëtar

Përmirësimi i marketingut dhe komunikimit ndërkombëtar është thelbësor për rritjen e vizibilitetit dhe atraktivitetit të Fakultetit të Biznesit. Masat kryesore përfshijnë përditësimin e materialeve promovuese në gjuhë të huaja, forcimin e pranisë digjitale, promovimin e historive të suksesit të studentëve dhe stafit, si dhe komunikimin aktiv me partnerë ndërkombëtarë. Një komunikim i strukturuar dhe strategjik do të mbështesë rekrutimin e studentëve të huaj dhe zgjerimin e partneriteteve.

Mbështetje për studentë të huaj / vizitorë

Krijimi i një mjedisi mikpritës dhe mbështetës për studentët e huaj dhe vizitorët akademikë është një komponent kyç i strategjisë së ndërkombëtarizimit. Fakulteti do të ofrojë mbështetje administrative, akademike dhe sociale për studentët e huaj, duke përfshirë orientimin fillestar, mentorimin akademik dhe integrimin kulturor. Këto masa synojnë të përmirësojnë përvojën e studentëve ndërkombëtarë dhe të rrisin reputacionin institucional të Fakultetit të Biznesit dhe UAMD në arenën ndërkombëtare.

4.2 Plani i veprimit (Action Plan)

Nr	Aktiviteti / Masa	Afati	Përgjegjësi	Partnerë	Burime	Output / Rezultat
1	Rishikimi dhe përditësimi i programeve të studimit sipas standardeve EQF/ESG	2025	Departamenti, Dekanati	ASCAL, ekspertë akademikë	Buxhet fakulteti	Kurrikula të përditësuara dhe të miratuara
2	Promovimi dhe rritja e mobilitetit studentor Erasmus+	2025–2030	Koordinatori Erasmus+, Departamenti	Universitete partnere	Erasmus+ KA131/KA171	Rritje e numrit të studentëve outgoing/incoming
3	Mobilitet teaching/training për stafin akademik	2025–2030	Departamenti, Zyra e Projekteve	Universitete partnere	Erasmus+	Përmirësim i cilësisë së mësimdhënies
4	Krijimi i grupeve të punës për aplikime në projekte ndërkombëtare	2025–2026	Përgjegjës kërkimi, Departamenti	Universitete, institute kërkimore	Buxhet fakulteti	Aplikime të strukturuar për projekte
5	Aplikim dhe zbatim projektesh KA2/CBHE/Horizon/Inte	2026–2030	Ekipet e projektit	Partnerë ndërkombëtarë	Fonde BE	Projekte të fituara dhe të zbatuara



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

Nr	Aktiviteti / Masa	Afati	Përgjegjësi	Partnerë	Burime	Output / Rezultat
	rreg					
6	Organizimi i workshop-eve dhe konferencave ndërkombëtare	2026–2030	Departamenti	Universitete, rrjete akademike	Buxhet + sponsorizime	Evente ndërkombëtare të realizuara
7	Zhvillimi i programeve të përbashkëta / diplomave të dyfishta	2027–2029	Fakulteti, Departamenti	Universitete partnere	Projekte buxhet	/Marrëveshje dhe programe të reja
8	Nxjtja e kërkimit shkencor dhe publikimeve bashkautorë ndërkombëtarë	2025–2030	Stafi akademik	Universitete, revista shkencore	Buxhet projekte	/Publikime Scopus/WoS
9	Marketing dhe komunikim ndërkombëtar (web, materiale promo)	2025–2030	Fakulteti, Zyra Komunikimit	Partnerë ndërkombëtarë	Buxhet fakulteti	Rritje dukshmërisë ndërkombëtare
10	Mbështetje akademike dhe administrative për studentë të huaj / vizitorë	2025–2030	Departamenti, Zyra Erasmus	Universitete partnere	Buxhet Erasmus+	Përmirësim i përvojës së studentëve ndërkombëtarë

5. Objektivat vjetore (2025–2030)

- Viti 2025 – Konsolidimi i bazës strategjike dhe organizative

Gjatë vitit 2025, Departamenti i Financë-Kontabilitetit do të fokusohet në ndërtimin dhe konsolidimin e bazës strategjike për zhvillimin afatmesëm dhe afatgjatë. Prioritet do të jetë rishikimi i programeve ekzistuese të studimit, me synim përafrimin e tyre me standardet europiane të arsimit të lartë, veçanërisht në lidhje me rezultatet e të nxënësve, ngarkesën akademike dhe kompetencat profesionale. Në këtë fazë, departamenti do të hartojë dokumentet themelore strategjike që lidhen me ndërkombëtarizimin, kërkimin shkencor dhe sigurimin e cilësisë, duke vendosur objektiva të qarta dhe mekanizma monitorimi. Një rëndësi e veçantë do t'i kushtohet ndërgjegjësimit të studentëve dhe stafit akademik për mundësitë e mobilitetit dhe projekteve ndërkombëtare, si dhe krijimit të strukturave të brendshme për mbështetjen e këtyre proceseve. Viti 2025 do të shërbejë si vit orientues dhe përgatitor për zbatimin e plotë të strategjisë.

- Viti 2026 – Zbatimi praktik dhe zgjerimi i aktiviteteve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

Në vitin 2026, fokusi do të zhvendoset nga planifikimi drejt zbatimit konkret të masave të përcaktuara. Programet e studimit të përditësuara do të fillojnë të zbatohen në praktikë, duke integruar metoda inovative të mësimdhënies, përdorimin e teknologjive digjitale dhe raste studimore nga praktika ndërkombëtare. Departamenti do të synojë rritjen e numrit të mobiliteteve studentore dhe të stafit, duke e bërë mobilitetin një pjesë të natyrshme të përvojës akademike.

Paralelisht, do të intensifikohen përpjekjet për aplikime në projekte ndërkombëtare, duke synuar sigurimin e fondeve për zhvillimin institucional dhe kërkimin shkencor. Organizimi i eventeve të para ndërkombëtare dhe rritja e publikimeve shkencore do të jenë tregues konkretë të aktivizimit të strategjisë.

• Viti 2027 – Thellimi i ndërkombëtarizimit dhe bashkëpunimit akademik

Viti 2027 do të karakterizohet nga thellimi i bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe konsolidimi i marrëdhënieve me partnerë akademikë dhe kërkimorë. Departamenti do të punojë drejt zhvillimit të moduleve dhe programeve të përbashkëta studimore, si dhe drejt rritjes së publikimeve shkencore me bashkautorë ndërkombëtarë. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përfshirjes së studentëve në aktivitetet kërkimore dhe projekte, duke forcuar lidhjen midis mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Gjithashtu, do të përmirësohet ndjeshëm komunikimi dhe marketingu ndërkombëtar, duke rritur dukshmërinë e departamentit dhe atraktivitetin e tij për studentë dhe partnerë të huaj.

Viti 2028 – Konsolidimi i rezultateve dhe rritja e ndikimit

Në vitin 2028, fokusi strategjik do të jetë konsolidimi i rezultateve të arritura deri në atë moment. Programet e përbashkëta ose diplomat e dyfishta do të hyjnë në fazën e funksionalizimit, ndërsa projektet e fituara ndërkombëtare do të japin ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Organizimi i konferencave dhe eventeve shkencore ndërkombëtare do të rrisë profilin akademik të departamentit. Një element i rëndësishëm do të jetë edhe rritja e numrit të studentëve të huaj dhe përmirësimi i shërbimeve mbështetëse për ta, duke e bërë departamentin më të hapur dhe konkurrues në nivel ndërkombëtar. Në këtë fazë do të realizohet edhe një vlerësim i ndërmjetëm i strategjisë, me qëllim përshtatjen dhe përmirësimin e mëtejshëm të masave.

• Viti 2029 – Qëndrueshmëria dhe cilësia afatgjatë

Viti 2029 do të fokusohet në sigurimin e qëndrueshmërisë së arritjeve dhe rritjen e cilësisë së përgjithshme akademike dhe kërkimore. Departamenti do të punojë për institucionalizimin e praktikave të suksesshme në mobilitet, projekte dhe kërkim shkencor, duke siguruar vazhdimësinë e tyre përtej ciklit strategjik. Ndërkombëtarizimi në kurrikulë do të thellohet më tej, duke garantuar që të gjithë studentët, pavarësisht pjesëmarrjes në mobilitet fizik, të përfitojnë nga dimensionin ndërkombëtar i arsimit. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përmirësimit të punësueshmërisë së të diplomuarve dhe forcimit të lidhjes me tregun e punës dhe institucionet financiare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

- Viti 2030 – Vlerësimi përfundimtar dhe orientimi drejt së ardhmes

Viti 2030 do të shërbejë si një fazë reflektimi dhe vlerësimi përfundimtar i realizimit të objektivave të periudhës 2025–2030. Departamenti do të analizojë rezultatet e arritura, do të dokumentojë praktikën më të mirë dhe do të vlerësojë ndikimin e strategjisë në cilësinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimit. Në bazë të këtij vlerësimi, do të hartohet strategjia e re e zhvillimit për periudhën pasuese, duke synuar një pozicionim edhe më të fortë akademik dhe institucional të Departamentit të Financë-Kontabilitetit brenda Fakultetit të Biznesit dhe UAMD.

6. Burimet financiare

Zbatimi me sukses i objektivave strategjike dhe vjetorë të Departamentit të Financë-Kontabilitetit për periudhën 2025–2030 kërkon sigurimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve financiare, të cilat përbëjnë një element thelbësor për zhvillimin e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimit. Strategjia financiare e departamentit bazohet në diversifikimin e burimeve të financimit, rritjen e eficiencës në përdorimin e fondeve dhe forcimin e kapaciteteve për përthithjen e fondeve konkurruese kombëtare dhe ndërkombëtare.

Buxheti i departamentit / fakultetit

Buxheti i akorduar nga Universiteti dhe Fakulteti mbetet baza kryesore financiare për funksionimin e përditshëm të Departamentit. Këto fonde do të përdoren për mbulimin e shpenzimeve operative, mbështetjen e procesit mësimor dhe veprimtarive akademike, organizimin e eventeve shkencore dhe profesionale, si dhe për përmirësimin gradual të infrastrukturës didaktike dhe teknologjike (laboratorë, pajisje, platforma dhe licenca).

Departamenti do ta planifikojë dhe menaxhojë buxhetin në mënyrë strategjike dhe transparente, duke aplikuar një qasje të orientuar sipas projekteve dhe aktiviteteve (project-based budgeting), ku alokimi i fondeve lidhet drejtpërdrejt me prioritetet strategjike dhe objektivat e matshme të performancës. Paralelisht, planifikimi buxhetor do të reflektojë edhe dinamikën e rritjes së numrit të studentëve, duke siguruar burime proporcionale për cilësinë e mësimdhënies, kapacitetet laboratorike dhe shërbimet akademike mbështetëse.

Erasmus+ (KA131 / KA171)

Programi Erasmus+ përbën një burim të rëndësishëm financiar për mbështetjen e mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik dhe administrativ. Për periudhën 2025–2030, departamenti synon të rrisë shfrytëzimin e fondeve Erasmus+ për mobilitet teaching, training dhe studentor, si dhe për aktivitete akademike ndërkombëtare. Këto fonde do të kontribuojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies, zhvillimin profesional të stafit dhe forcimin e dimensionit ndërkombëtar të programeve të studimit, duke reduktuar barrën financiare për institucionin dhe pjesëmarrësit.

Projekte dhe fonde ndërkombëtare (KA2 / CBHE / Horizon / Interreg, etj.)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

Projektet e financuara nga programe konkurruese ndërkombëtare përfaqësojnë një burim strategjik për zhvillimin afatgjatë të departamentit. Përmes pjesëmarrjes në projekte Erasmus+ KA2/CBHE, Horizon Europe, Interreg dhe iniciativa të tjera, departamenti synon të sigurojë fonde për modernizimin e kurrikulave, forcimin e kapaciteteve kërkimore, zhvillimin e infrastrukturës akademike dhe përfshirjen në rrjete ndërkombëtare. Një fokus i veçantë do t'i kushtohet rritjes së aftësive për shkrimin, menaxhimin dhe raportimin e projekteve, duke siguruar përdorim efikas dhe të qëndrueshëm të fondeve.

Burime të tjera (partnerë, sponsorizime)

Përveç fondeve publike dhe programeve ndërkombëtare, departamenti do të eksplorojë burime alternative financimi përmes bashkëpunimit me sektorin privat, institucionet financiare, shoqatat profesionale dhe partnerë të tjerë strategjikë. Sponsorizimet, marrëveshjet e bashkëpunimit dhe kontributet në natyrë (in-kind) do të mbështesin organizimin e eventeve akademike, praktikat profesionale, trajnime të specializuara dhe aktivitete që rrisin punësueshmërinë e studentëve. Këto burime do të kontribuojnë në forcimin e lidhjes me tregun e punës dhe në diversifikimin e financimit.

Nevoja për investime dhe trajnime

Arritja e objektivave strategjikë kërkon investime të vazhdueshme në infrastrukturën akademike, teknologjitë digjitale, softwerë financiarë dhe kontabël, si dhe në zhvillimin profesional të stafit akademik dhe administrativ. Departamenti identifikon si prioritet investimet në trajnime për mësimdhënie inovative, kërkim shkencor, shkrim projektsh dhe menaxhim financiar. Këto investime do të rrisin kapacitetet institucionale, cilësinë akademike dhe aftësinë konkurruese të departamentit në përthithjen e fondeve dhe realizimin e misionit të tij akademik.

7. KPI dhe monitorimi

Plani i ndërkombëtarizimit dhe sigurimit të cilësisë në Departamentin e Financë-Kontabilitet është ndërtuar mbi bazën e dokumenteve institucionale të UAMD, evidencave të mobilitetit dhe partneriteteve, si dhe strategjive të miratuara nga Senati Akademik për profilizimin e universitetit përmes ndërkombëtarizimit 2025–2030. Qëllimi i përgjithshëm është forcimi i profilit ndërkombëtar të departamentit përmes mobilitetit të studentëve dhe stafit, konsolidimit të bashkëpunimeve akademike e profesionale, integritetit të dimensionit ndërkombëtar në kurrikula dhe kërkim shkencor, si dhe sigurimit të cilësisë sipas standardeve ndërkombëtare.

Ky vizion lidhet drejtpërdrejt me punën e bërë më lart:

- Partneritetet aktive janë të harmonizuara me objektivat e UAMD për diploma të dyfishta dhe programe të përbashkëta.
- Mobilitetet e realizuara përputhen me KPI-të e planit (≥ 5 studentë/vit dhe ≥ 2 pedagogë/vit në mobilitet).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

- Projektet Erasmus+ dhe CBHE janë pjesë e angazhimit të departamentit për të zhvilluar kurrikula inovative dhe për të rritur publikimet ndërkombëtare.
- Kapacitetet dhe burimet (staf i kualifikuar, programe të akredituara, laboratorë modernë) janë baza për të përmbushur objektivat e ndërkombëtarizimit dhe për të siguruar cilësinë e mësimdhënies.

Treguesit e ndërkombëtarizimit (KPI) – Departamenti Financë-Kontabilitet

Fusha	Indikator	Përshkrimi	Target vjetor	Përgjegjës
Mobilitet	Studentë në mobilitet	Studentë të departamentit në Erasmus+/shkëmbime	≥10/vit	Departamenti / Zyra Ndërkombëtare
Mobilitet	Staf akademik në mobilitet	Pedagogë në trajnime/mësimdhënie jashtë vendit	≥5/vit	Departamenti
Mobilitet	Marrëveshje Erasmus+	Marrëveshje aktive institucionale	+2/vit	Departamenti/ Rektorati
Partneritetet	Marrëveshje me biznesin	Bashkëpunime profesionale dhe praktika	≥4/vit	Fakulteti / Departamenti
Projekte	Projekte/aplikime ndërkombëtare	READ, Erasmus+, thirrje të tjera	≥2/vit	Departamenti
Akademikë	Module me dimension ndërkombëtar	Module me literaturë/guest lecturers	≥2/vit	Departamenti
Akademikë	Guest lectures	Leksione nga partnerë ndërkombëtarë	≥2/vit	Departamenti
Kërkimorë	Aktivitete kërkimore	Seminare, konferenca, bashkautorësi	≥3/vit	Dep. / Qendra Kërkimit
Cilësia	Raport ndërkombëtarizimi	Raport vjetor analitik	1/vit	NJSBC



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

8. Struktura e zbatimit dhe përgjegjësitë

Zbatimi i strategjisë së ndërkombëtarizimit në nivel departamenti është menduar si një proces i organizuar dhe i koordinuar, i cili mbështetet në dokumentet institucionale dhe praktikën e sigurimit të cilësisë të përcaktuara nga ASCAL dhe më gjërë. Për të garantuar që objektivat e ndërkombëtarizimit të përkthehen në veprime konkrete dhe të matshme, është ndërtuar një strukturë e qartë përgjegjësisë dhe mekanizmash monitorimi.

Ky organizim përfshin rolin udhëheqës të drejtuesit të departamentit, i cili përcakton prioritetet vjetore dhe ndjek realizimin e treguesve të performancës; grupin e punës për ndërkombëtarizim, që zbaton aktivitetet dhe mbledh evidenca; si dhe koordinimin institucional me Dekanatin dhe Zyrën e Ndërkombëtarizimit, të cilat sigurojnë harmonizimin e veprimeve dhe mbështetjen teknike e administrative. Mekanizmi i monitorimit dhe raportimit është i strukturuar në mënyrë që të garantojë transparencë dhe matshmëri, duke u realizuar në baza semestrale dhe vjetore përmes raporteve KPI, vetëvlerësimeve dhe arkivimit digjital.

Ky sistem i integruar i përgjegjësisë dhe monitorimit siguron që ndërkombëtarizimi të mos mbetet një synim abstrakt, por të shndërrohet në një proces të qëndrueshëm, të matshëm dhe të harmonizuar me strategjinë e përgjithshme të UAMD për periudhën 2025–2030. Për ta bërë këtë të mundur, është përcaktuar një strukturë e qartë zbatimi dhe ndarje rolesh, ku secili aktor ka funksione të veçanta dhe të ndërthurura në realizimin e planit.

- *Drejtuesi i Departamentit*

- Mbikëqyr zbatimin e planit në nivel departamenti.
- Përcakton prioritetet vjetore dhe ndjek realizimin e KPI-ve.
- Koordinon veprimet me Dekanatin dhe Zyrën e Ndërkombëtarizimit.
- Raporton periodikisht mbi progresin dhe problematikat.

- *Grupi i Punës për Ndërkombëtarizim*

- Përbëhet nga staf akademik, koordinatorë dhe përfaqësues të NJSBC.
- Zbaton veprimet konkrete të planit dhe mbledh evidenca.
- Përgatit raporte vjetore për Drejtuesin e Departamentit dhe Fakultetin.

- *Koordinimi institucional*

- Dekanati siguron harmonizimin me strategjinë e Fakultetit të Biznesit.
- Zyra e Ndërkombëtarizimit ofron mbështetje administrative dhe teknike për mobilitetet, marrëveshjet dhe projektet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

- *Mekanizmi i monitorimit dhe raportimit*

- Përgjegjësit institucionalë: Departamenti, Dekanati, Zyra e Ndërkombëtarizimit, NJSBC.
- Afatet e monitorimit: Monitorim semestral dhe raportim vjetor.
- Mjetet e raportimit: Raporte KPI, sistemi PITAGORA, raporte vetëvlerësimi dhe arkivim digjital.

9. Menaxhimi i riskut

Menaxhimi i rrezikut në kuadër të strategjisë së ndërkombëtarizimit të Departamentit Financë-Kontabilitet është konceptuar si një mekanizëm mbështetës për të siguruar që objektivat e përcaktuara në dokumentet institucionale dhe strategjike të UAMD, të realizohen në mënyrë të qëndrueshme dhe të matshme. Ky proces nuk shihet thjesht si një listë masash parandaluese, por si një qasje e integruar që lidh mobilitetin, partneritetet, projektet kërkimore dhe sigurimin e cilësisë me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Në këtë kuadër, menaxhimi i rrezikut synon:

Identifikimin e sfidave kryesore që lidhen me pjesëmarrjen e studentëve dhe stafit në mobilitet, angazhimin akademik, vonesat administrative, mungesën e fondeve apo dokumentimin e pamjaftueshëm.

Parandalimin e pasojave përmes masave të qarta si informimi i vazhdueshëm, trajnimi i stafit, standardizimi i procedurave, aplikimet e rregullta për fonde dhe arkivimi digjital sistematik.

Sigurimin e alternativave për çdo rrezik të mundshëm, duke përfshirë mobilitetet virtuale, leksionet online, projektet rajonale, aktivitetet me kosto të ulët dhe auditimet e brendshme korrektuese.

Kjo qasje është në përputhje me filozofinë e UAMD për ndërkombëtarizim të qëndrueshëm dhe të matshëm, duke e vendosur departamentin në një pozicion të fortë për të përmbushur standardet e ASCAL dhe për të kontribuar në vizionin e universitetit si motor zhvillimi rajonal. Në këtë mënyrë, menaxhimi i rrezikut shërben si garanci që strategjia e ndërkombëtarizimit të mos mbetet një synim teorik, por të përkthehet në rezultate konkrete dhe të qëndrueshme.

Nr	Rreziku	Probabiliteti	Ndikimi	Masa parandaluese	Plani alternativ
1	Pjesëmarrje e ulët në mobilitet	Mesatar	I lartë	Informim dhe këshillim i vazhdueshëm	Mobilitete virtuale / guest lectures online
2	Angazhim i kufizuar i stafit	I ulët	Mesatar	Trajnime dhe incentivim institucional	Projekte kombëtare/rajonale



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

Nr	Rreziku	Probabiliteti	Ndikimi	Masa parandaluese	Plani alternativ
3	Vonesa administrative	I ulët	Mesatar	Procedura të standardizuara	Mbështetje nga Dekanati/Zyra Ndërkombëtare
4	Mungesë fondesh	Mesatar	I lartë	Aplikime të rregullta për fonde	Aktivitetet me kosto të ulët
5	Dokumentim i pamjaftueshëm	I ulët	I lartë	Arkivim digjital sistematik	Audit i brendshëm korrektues

Rezultatet e pritshme

Ndërkombëtarizim i qëndrueshëm dhe i matshëm në nivel departamenti

Ky rezultat nënkupton krijimin e një sistemi të konsoliduar partneritetesh dhe mobilitetesh, të cilat nuk varen nga nisma sporadike, por janë pjesë e një procesi të vazhdueshëm. Matshmëria sigurohet përmes treguesve të performancës (KPI), duke monitoruar çdo vit numrin e studentëve dhe stafit në mobilitet, marrëveshjet e reja të bashkëpunimit dhe projektet ndërkombëtare ku departamenti është i përfshirë.

Rritje e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor

Ndërkombëtarizimi sjell përmirësim të metodave të mësimdhënies përmes integritit të moduleve ndërkombëtare, leksioneve të hapura nga profesorë vizitorë dhe përdorimit të literaturës bashkëkohore. Në fushën e kërkimit, pjesëmarrja në projekte Horizon Europe dhe Erasmus+ nxit prodhimin e studimeve të përbashkëta dhe publikimeve në revista të indeksuara, duke rritur standardin akademik të departamentit.

Forcim i lidhjeve akademike dhe profesionale ndërkombëtare

Departamenti synon të zgjerojë rrjetin e bashkëpunimeve me universitete europiane, institucione financiare dhe organizata profesionale. Këto lidhje krijojnë mundësi për diploma të dyfishta, praktika profesionale dhe projekte të përbashkëta, duke e vendosur departamentin në një pozicion të dukshëm në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

Përmbytje e standardeve të ASCAL dhe objektivave institucionale të UAMD

Rezultatet e pritshme lidhen drejtpërdrejt me kërkesat e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), përmes raportimit të rregullt dhe vetëvlerësimit të aktiviteteve ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, ato përputhen me objektivat e Projekt Strategjisë së Profilizimit të UAMD 2025–2030, duke e bërë departamentin një aktor aktiv në realizimin e vizionit të universitetit për ndërkombëtarizim dhe zhvillim rajonal.



Departamenti i Menaxhimit

1. Baza ligjore dhe dokumentet referuese

Kjo strategji bazohet në:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr. 80, datë 22.07.2015, *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;
- Statutin (miratuar me Urdhërin nr. 385, datë 09.07.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë) dhe Rregulloren (miratuar me Vendimin nr. 154, datë 26.11.2018 të Senatit Akademik) të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD);
- Rregulloren e Brendshme të Drejtorisë së Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë (miratuar me Vendimin nr. 5, datë 17.01.2020 të Senatit Akademik), si dhe Strategjinë e Ndërkombëtarizimit 2019-2021, Strategjinë e Ndërkombëtarizimit 2022-2024 dhe Strategjinë e Ndërkombëtarizimit 2025-2027 të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës;
- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*;
- Rregulloren financiare të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, neni 43, të cilat përbëjnë bazën ligjore dhe operative të kësaj strategjie.

2. Qëllimi i Strategjisë së Departamentit

Qëllimi i përgjithshëm i Strategjisë së Ndërkombëtarizimit të Departamentit të Menaxhimit është forcimi i profilit ndërkombëtar të departamentit përmes integritit të qëndrueshëm dhe sistematik të dimensionit ndërkombëtar në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe shërbim ndaj komunitetit. Kjo strategji synon të rrisë cilësinë akademike, konkurrueshmërinë dhe atraktivitetin e programeve të studimit, duke përgatitur studentë dhe staf akademik me kompetenca ndërkulturore, profesionale dhe kërkimore, në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe me vizionin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.

Në këtë kuadër, strategjia mbështet zhvillimin dhe konsolidimin e programeve të përbashkëta dhe diplomave të dyfishta, rritjen e mobilitetit akademik dhe forcimin e bashkëpunimit me institucione partnere ndërkombëtare, duke e pozicionuar Departamentin e Menaxhimit si një aktor aktiv dhe të besueshëm në hapësirën evropiane të arsimit të lartë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

Qëllime specifike:

- Të rrisë dhe diversifikojë mobilitetin ndërkombëtar të studentëve dhe stafit akademik përmes programeve Erasmus+ dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare;
- Të zhvillojë dhe konsolidojë programe të përbashkëta studimi dhe diploma të dyfishta, duke zgjeruar ofertën akademike ndërkombëtare të departamentit;
- Të ndërkombëtarizojë kurrikulën përmes ofrimit të moduleve në gjuhë të huaj, përfshirjes së pedagogëve të ftuar dhe aplikimit të praktikave të "internationalisation at home";
- Të forcojë kërkimin shkencor dhe inovacionin përmes projekteve ndërkombëtare, publikimeve me bashkautorë dhe pjesëmarrjes në rrjete kërkimore evropiane;
- Të rrisë dukshmërinë dhe reputacionin ndërkombëtar të Departamentit të Menaxhimit përmes marketingut akademik, eventeve ndërkombëtare dhe bashkëpunimit me partnerë strategjikë;
- Të përmirësojë mbështetjen akademike dhe administrative për studentët dhe stafin ndërkombëtar, duke krijuar një mjedis gjithëpërfshirës dhe ndërkulturor.

3. Ndërkombëtarizimi, gjendja aktuale

Profili i departamentit

Departamenti i Menaxhimit është një prej njësive bazë kryesore të Fakultetit të Biznesit në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës dhe përfaqëson një strukturë akademike me rol kyç në formimin e profesionistëve dhe studiuesve në fushën e menaxhimit, administrimit të biznesit dhe disiplinave të ndërlidhura. Departamenti ka një profil të konsoliduar akademik dhe didaktik, i ndërtuar mbi përvojë shumëvjeçare në ofrimin e programeve të studimit në të tre ciklet: Bachelor, Master dhe Doktoratë.

Stafi akademik i Departamentit të Menaxhimit përbëhet nga 16 anëtarë me tituj dhe grada shkencore (Profesorë, Profesorë të Asociuar, Doktorë Shkencash dhe kandidatë për Doktorë Shkencash), me formim universitar brenda dhe jashtë vendit, si dhe me përvojë të drejtpërdrejtë në mësimdhënie, kërkim shkencor, projekte akademike dhe bashkëpunime ndërkombëtare. Ky staf garanton cilësi të lartë të procesit mësimor, përditësim të vazhdueshëm të syllabuseve dhe integrim të praktikave bashkëkohore të menaxhimit në procesin e formimit të studentëve.

Departamenti ofron programe studimi të orientuara drejt tregut të punës dhe zhvillimeve bashkëkohore në ekonominë globale, duke përfshirë programe në gjuhë angleze, çka e bën atë tërheqës për studentë ndërkombëtarë dhe pjesëmarrës në programe mobiliteti. Përmes kombinimit të mësimdhënies teorike me raste studimore, projekte praktike dhe leksione të hapura me profesionistë dhe akademikë vendas e të huaj, departamenti synon zhvillimin e kompetencave profesionale, analitike dhe ndërkulturore të studentëve.

Departamenti i Menaxhimit ofron një ofertë të konsoliduar akademike në të tre ciklet e studimit, në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane të arsimit të lartë. Në nivelin Bachelor, departamenti ofron programin "Administrim Biznes" shqip dhe anglisht, dhe programin e përbashkët ndërkombëtar "International Business Management" në bashkëpunim me Institutin Politeknik të Bragancës. Në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

nivelin Master, departamenti ofron programin Master i Shkencave në "Menaxhim Biznes", si dhe programe të Masterit Profesional në "Menaxhim Biznes" dhe "Drejtim i SME-ve", të orientuara drejt zhvillimeve bashkëkohore të tregut të punës dhe nevojave të ekonomisë. Kjo gamë programesh përbën bazën strukturore mbi të cilën ndërtohet procesi i ndërkombëtarizimit, duke mundësuar integrimin e dimensionit ndërkombëtar në kurrikulë, zhvillimin e programeve të përbashkëta dhe diplomave të dyfishta, si dhe zgjerimin e bashkëpunimit akademik me partnerë evropianë.

Në fillim të vitit akademik 2025-2026, Departamenti i Menaxhimit ka propozuar hapjen e dy programeve të reja studimi për vitin akademik 2026-2027: Master Profesional në "Sipërmarrje dhe Transformim Digjital" dhe Master i Shkencave në "Logjistikë dhe Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit". Këto programe përfaqësojnë një zgjerim strategjik të ofertës akademike në fusha me potencial të lartë ndërkombëtarizimi, inovacioni dhe bashkëpunimi me partnerë evropianë.

Në fushën e kërkimit shkencor, Departamenti i Menaxhimit angazhohet aktivisht në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, botime shkencore dhe projekte kërkimore, duke kontribuar në avancimin e dijes dhe në rritjen e dukshmërisë akademike të Fakultetit të Biznesit dhe UAMD. Ky angazhim mbështet drejtpërdrejt procesin e ndërkombëtarizimit, duke krijuar baza të qëndrueshme për bashkëpunime akademike dhe kërkimore me institucione partnere evropiane dhe më gjerë.

Profili i departamentit forcohet më tej nga përfshirja aktive në programe ndërkombëtare si Erasmus+, zhvillimi i programeve të përbashkëta dhe diplomave të dyfishta, si dhe nga orientimi strategjik drejt ndërkombëtarizimit të kurrikulës dhe ofertës akademike. Këto elemente e pozicionojnë Departamentin e Menaxhimit si një strukturë dinamike, konkurruese dhe të hapur ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar në hapësirën evropiane të arsimit të lartë.

Partneritete aktive/ekzistuese

Pjesëmarrja e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës në Aleancën Evropiane STARS EU përbën një dimension strategjik të rëndësishëm për procesin e ndërkombëtarizimit të Departamentit të Menaxhimit. STARS EU krijon një platformë të strukturuar bashkëpunimi ndërmjet universiteteve evropiane, duke mundësuar zhvillimin e programeve të përbashkëta, mobiliteteve të integruara, projekteve kërkimore ndërinstitucionale dhe inovacionit akademik.

Për Departamentin e Menaxhimit, përfshirja në këtë aleancë rrit potencialin për zgjerimin e rrjetit të partneriteteve, ndërkombëtarizimin e kurrikulës, zhvillimin e moduleve të përbashkëta dhe përfshirjen në projekte evropiane me ndikim më të gjerë. Gjithashtu, STARS EU krijon mundësi për rritjen e dukshmërisë ndërkombëtare të programeve të studimit, forcimin e bashkëpunimit në fushën e kërkimit shkencor dhe integrimin e praktikave më të mira evropiane në procesin mësimor.

Në këtë kontekst, aleanca STARS EU përfaqëson një katalizator të rëndësishëm për fazën e dytë të ndërkombëtarizimit të Departamentit të Menaxhimit (2027-2030), duke mbështetur zhvillimin e programeve të reja Master, diplomave të dyfishta dhe projekteve strategjike ndërkombëtare.

Departamenti i Menaxhimit ka ndërtuar dhe zhvillon partneritete aktive ndërkombëtare në përputhje me prioritetet strategjike të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës dhe Fakultetit të Biznesit, me fokus në mësimdhënie, mobilitet akademik, programe të përbashkëta studimi dhe kërkim shkencor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

Partneriteti më i konsoliduar dhe strategjik i departamentit është ai me Institutin Politeknik të Bragançës (IPB), Portugali, i cili shtrihet përtej mobiliteteve klasike Erasmus+ dhe materializohet në:

- zhvillimin e programit të përbashkët Bachelor në "International Business Management" (joint degree) për vitin akademik 2025-2026 në bashkëpunim me Institutin Politeknik të Bragançës, Portugali;
- zbatimin e programit Bachelor me diplomë të dyfishtë në "Administrim Biznes" (Anglisht) për vitin akademik 2025-2026 në bashkëpunim me Institutin Politeknik të Bragançës, Portugali;
- mobilitet të rregullt të studentëve dhe stafit akademik;
- harmonizim kurrikular dhe bashkëpunim akademik të qëndrueshëm.

Përveç IPB, Departamenti i Menaxhimit përfiton nga rrjeti më i gjerë i marrëveshjeve ndërkombëtare të Fakultetit të Biznesit dhe UAMD, kryesisht në kuadër të programit Erasmus+, duke mundësuar mobilitete për mësimdhënie (teaching mobility) dhe trajnim (training mobility) të stafit akademik, si dhe shkëmbime studentore me universitete partnere evropiane.

Partneritetet ekzistuese shërbejnë si bazë për zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në fusha si:

- zhvillimi i programeve të reja të përbashkëta dhe diplomave të dyfishta në nivel Master;
- aplikime të përbashkëta në projekte ndërkombëtare;
- organizimi i aktiviteteve akademike dhe kërkimore ndërkombëtare.

Mobilitetet e realizuara (3 vitet e fundit)

Gjatë 3 (tri) viteve të fundit akademike, Departamenti i Menaxhimit ka shënuar një angazhim të vazhdueshëm dhe progresiv në fushën e mobilitetit ndërkombëtar të studentëve dhe stafit akademik, kryesisht në kuadër të programit Erasmus+. Këto mobilitete kanë kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së mësimdhënies, zhvillimin profesional të stafit dhe forcimin e kompetencave akademike e ndërkulturore të studentëve.

Mobilitetet e studentëve janë realizuar si në formën e shkëmbimeve semestrale, ashtu edhe në kuadër të programeve me diplomë të dyfishtë, duke u fokusuar veçanërisht në programe studimi në gjuhë angleze.

Paralelisht, stafi akademik i Departamentit të Menaxhimit ka marrë pjesë rregullisht në mobilitete për mësimdhënie (teaching mobility) dhe trajnim (training mobility), duke kontribuar në shkëmbimin e praktikave të mira akademike, përditësimin e metodologjive të mësimdhënies dhe ndërtimin e rrjeteve profesionale ndërkombëtare. Këto mobilitete kanë shërbyer gjithashtu si bazë për thellimin e bashkëpunimit institucional dhe zhvillimin e programeve të përbashkëta.

Në tërësi, mobilitetet e realizuara gjatë tre viteve të fundit përfaqësojnë një element kyç të strategjisë së ndërkombëtarizimit të Departamentit të Menaxhimit dhe krijojnë premisa të forta për rritje të mëtejshme të shkëmbimeve akademike dhe programeve të strukturuar të mobilitetit në periudhën 2025-2030.

Projekte (Erasmus+/të tjera) ku departamenti ka qenë i përfshirë

Departamenti i Menaxhimit ka qenë i përfshirë në mënyrë aktive në projekte ndërkombëtare, kryesisht



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

në kuadër të programit Erasmus+, duke kontribuar në zbatimin e prioriteteve institucionale të ndërkombëtarizimit, ndërtimit të kapaciteteve dhe rritjes së cilësisë akademike.

Në veçanti, departamenti ka marrë pjesë në projekte dhe veprimtari të lidhura me:

mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik (KA131/KA171), duke siguruar mbështetje akademike dhe administrative për zbatimin e mobiliteteve;

zhvillimin dhe konsolidimin e programeve të përbashkëta dhe diplomave të dyfishta, në bashkëpunim me institucione partnere evropiane;

shkëmbimin e praktikave të mira në mësimdhënie, metodologji bashkëkohore dhe menaxhim akademik.

Stafi akademik i Departamentit të Menaxhimit ka qenë gjithashtu i angazhuar individualisht dhe institucionalisht në aktivitete kërkimore dhe projekte të financuara në nivel universiteti dhe fakulteti, të cilat kanë krijuar bazën për aplikime të përbashkëta në projekte ndërkombëtare më komplekse, si Erasmus+ KA2/CBHE, Horizon Europe apo programe të tjera rajonale dhe evropiane.

Përfshirja në projekte ndërkombëtare ka kontribuar në forcimin e kapaciteteve akademike dhe administrative të departamentit, në rritjen e përvojës së stafit në menaxhimin e projekteve dhe në zgjerimin e rrjetit të bashkëpunimit ndërkombëtar. Këto eksperiencë përbëjnë një aset të rëndësishëm për periudhën 2025-2030, ku departamenti synon të rrisë pjesëmarrjen si partner dhe koordinator në projekte ndërkombëtare mësimore dhe kërkimore.

Projekte (Erasmus+/të tjera) ku departamenti ka qenë i përfshirë

Departamenti i Menaxhimit disponon kapacitete të qëndrueshme akademike, infrastrukturore dhe organizative, të cilat mbështesin drejtpërdrejt zbatimin e strategjisë së ndërkombëtarizimit dhe zhvillimin e programeve të përbashkëta ndërkombëtare.

Stafi akademik përbëhet nga 16 anëtarë me kohë të plotë, me tituj dhe grada shkencore (Profesorë, Profesorë të Asociuar, Doktorë Shkencash dhe kandidatë për doktoraturë), të cilët mbulojnë fusha kyçe të menaxhimit, administrimit të biznesit, burimeve njerëzore, financës, marketingut dhe sipërmarrjes. Një pjesë e konsiderueshme e stafit ka formim akademik dhe/ose përvojë profesionale jashtë vendit, si dhe eksperiencë në mësimdhënie në gjuhë angleze, pjesëmarrje në mobilitete Erasmus+ dhe bashkëpunime ndërkombëtare.

Infrastruktura mësimore e Departamentit të Menaxhimit përfshin ambiente bashkëkohore për zhvillimin e procesit mësimor, salla leksionesh dhe seminari të pajisura me mjete didaktike moderne, akses në teknologji informative dhe platforma digjitale për mësimdhënie dhe komunikim akademik. Kjo infrastrukturë mundëson zhvillimin e mësimin në format tradicional, blended dhe online, në përputhje me praktikën evropiane.

Laboratorët dhe burimet mbështetëse të Fakultetit të Biznesit dhe UAMD janë në dispozicion të Departamentit të Menaxhimit për zhvillimin e aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe projekteve studentore. Këto përfshijnë laboratorë kompjuterikë, biblioteka fizike dhe elektronike, si dhe akses në burime shkencore dhe databaza akademike, të cilat mbështesin kërkimin shkencor dhe përgatitjen akademike të studentëve dhe stafit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

Programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Menaxhimit përfshijnë programe në të tre ciklet e studimit (Bachelor, Master dhe Doktoratë), përfshirë programe në gjuhë angleze, si dhe programe të përbashkëta dhe me diplomë të dyfishtë. Kjo gamë programesh përbën një bazë solide për ndërkombëtarizimin e kurrikulës, tërheqjen e studentëve ndërkombëtarë dhe zgjerimin e bashkëpunimit akademik me institucione partnere.

Në tërësi, kapacitetet dhe burimet ekzistuese të Departamentit të Menaxhimit krijojnë kushte të favorshme për konsolidimin dhe zgjerimin e ndërkombëtarizimit në periudhën 2025-2030, duke mbështetur objektivat strategjike të departamentit dhe të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.

4. Objektivat strategjike 2025-2030

OS1: Forcimi i mobilitetit ndërkombëtar të studentëve dhe stafit akademik

Të rritet në mënyrë të qëndrueshme dhe cilësore pjesëmarrja e studentëve dhe stafit akademik të Departamentit të Menaxhimit në mobilitete ndërkombëtare, duke kaluar nga mobilitete individuale drejt mobiliteteve të strukturuar dhe të integruara në programe studimi. Ky objektiv synon zhvillimin e kompetencave akademike, profesionale dhe ndërkulturore, si dhe rritjen e përvojës ndërkombëtare të komunitetit akademik të departamentit.

OS2: Zhvillimi dhe konsolidimi i programeve të përbashkëta dhe diplomave të dyfishta

Të konsolidohen programet ekzistuese të përbashkëta dhe me diplomë të dyfishtë në nivel Bachelor, në veçanti bashkëpunimi me Institutin Politeknik të Bragançës, dhe të zgjerohet ky model bashkëpunimi në nivel Master gjatë periudhës 2025-2030. Ky objektiv synon rritjen e ndërkombëtarizimit të ofertës akademike dhe pozicionimin e Departamentit të Menaxhimit si një strukturë konkurruese në hapësirën evropiane të arsimit të lartë.

OS3: Ndërkombëtarizimi i kurrikulës dhe forcimi i cilësisë akademike

Të integrohet dimensionin ndërkombëtar në kurrikulë përmes ofrimit të moduleve në gjuhë të huaj, përfshirjes së pedagogëve të huaj dhe përdorimit të metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies. Ky objektiv synon përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe përgatitjen e studentëve për tregun ndërkombëtar të punës dhe studimeve të avancuara.

OS4: Forcimi i kërkimit shkencor, projekteve ndërkombëtare dhe dukshmërisë akademike

Të rritet përfshirja e stafit akademik të Departamentit të Menaxhimit në projekte ndërkombëtare mësimore dhe kërkimore, si dhe në publikime shkencore me bashkautorë ndërkombëtarë. Ky objektiv synon zgjerimin e rrjetit të bashkëpunimit akademik, rritjen e reputacionit ndërkombëtar të departamentit dhe krijimin e një baze të qëndrueshme për financim dhe inovacion akademik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

4.1 Fushat e ndërhyrjes dhe masat kryesore

Mobiliteti i studentëve:

Departamenti i Menaxhimit synon rritjen sasore dhe cilësore të mobilitetit ndërkombëtar të studentëve përmes programeve Erasmus+ dhe marrëveshjeve bilaterale me institucione partnere. Masat kryesore përfshijnë promovimin aktiv të mundësive të mobilitetit, integrimin e mobilitetit në strukturën e programeve të studimit (sidomos në programet joint dhe double diploma), si dhe sigurimin e njohjes së plotë akademike të krediteve të përfituara jashtë vendit. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet mobilitetit afatgjatë dhe atij të integruar në ciklin e studimit.

Mobiliteti i stafit (teaching/training):

Departamenti do të inkurajojë pjesëmarrjen e stafit akademik në mobilitete për mësimdhënie dhe trajnim, me qëllim përmirësimin e metodologjive të mësimdhënies, shkëmbimin e praktikave të mira dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional. Këto mobilitete do të shërbejnë gjithashtu si instrument për ndërtimin e rrjeteve akademike dhe përgatitjen e projekteve të përbashkëta ndërkombëtare.

Projekte dhe fonde (KA2/KA171/Horizon/Interreg, etj.):

Një fokus i veçantë do t'i kushtohet rritjes së përfshirjes së departamentit në projekte ndërkombëtare mësimore dhe kërkimore. Masat përfshijnë ngritjen e kapaciteteve për shkrimin dhe menaxhimin e projekteve, pjesëmarrjen në aplikime të përbashkëta Erasmus+ (KA2/CBHE), Horizon Europe dhe programe të tjera rajonale dhe evropiane, si dhe bashkëpunimin e ngushtë me Zyrën e Ndërkombëtarizimit të UAMD.

Programe të përbashkëta / diploma të dyfishta:

Departamenti do të konsolidojë programet ekzistuese të përbashkëta dhe me diplomë të dyfishtë në nivel Bachelor dhe do të punojë për zgjerimin e këtij modeli në nivel Master. Masat kryesore përfshijnë harmonizimin e vazhdueshëm të kurrikulave me institucionet partnere, koordinimin akademik dhe administrativ të programeve, si dhe promovimin e tyre në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Ndërkombëtarizimi në kurrikulë (internationalisation at home):

Departamenti synon integrimin e dimensionit ndërkombëtar në kurrikulë përmes ofrimit të moduleve në gjuhë angleze, përfshirjes së pedagogëve të huaj (guest lecturers), përdorimit të materialeve didaktike ndërkombëtare dhe aplikimit të metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies. Kjo qasje synon që edhe studentët që nuk marrin pjesë fizikisht në mobilitete të përfitojnë nga një përvojë akademike ndërkombëtare.

Kërkimi shkencor dhe publikimet me bashkautorë:

Departamenti do të inkurajojë bashkëpunimin kërkimor ndërkombëtar përmes publikimeve të përbashkëta, pjesëmarrjes në konferenca shkencore dhe krijimit të grupeve kërkimore me partnerë të huaj. Masat synojnë rritjen e cilësisë dhe dukshmërisë së kërkimit shkencor, si dhe forcimin e lidhjes midis mësimdhënies dhe kërkimit.

Evente ndërkombëtare (workshop-e, javë ndërkombëtare, konferenca):



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

Organizimi i eventeve akademike ndërkombëtare do të jetë një element i rëndësishëm i strategjisë, duke përfshirë javë ndërkombëtare, workshop-e tematike dhe konferenca shkencore. Këto aktivitete do të shërbejnë si platformë për shkëmbim akademik, promovim të departamentit dhe forcim të rrjetit të partneriteteve ndërkombëtare.

Marketing/komunikim ndërkombëtar:

Departamenti do të forcojë komunikimin dhe promovimin ndërkombëtar të programeve dhe aktiviteteve të tij përmes kanaleve zyrtare të UAMD, materialeve promocionale në gjuhë të huaj dhe pjesëmarrjes në aktivitete informuese ndërkombëtare. Qëllimi është rritja e dukshmërisë dhe atraktivitetit të ofertës akademike për studentë dhe partnerë ndërkombëtarë.

Mbështetje për studentë të huaj / vizitorë:

Do të sigurohet mbështetje akademike dhe administrative për studentët dhe stafin ndërkombëtar përmes orientimit akademik, mentorimit, koordinimit me strukturat përkatëse të universitetit dhe krijimit të një mjedisi gjithëpërfshirës dhe mikpritës. Këto masa synojnë përmirësimin e përvojës së studentëve dhe stafit ndërkombëtar dhe rritjen e kënaqësisë së tyre akademike dhe sociale.

4.2 Plani i veprimit (Action Plan)

Nr.	Aktiviteti / Masa	Afati	Përgjegjësi	Partnerë	Burime	Output / Rezultat
1	Konsolidimi i programit të përbashkët Bachelor në "International Business Management" (joint degree)	2025-2026	Koordinatori i Programit (Dr. Denada Liça)	IPB Bragança	Erasmus+, buxhet FB	Zbatim i qëndrueshëm i programit, raport vjetor cilësie
2	Menaxhimi dhe monitorimi i programit Bachelor me diplomë të dyfishtë në "Administrim Biznes" (Anglisht)	2025-2026	Koordinatori i Programit (Dr. Denada Liça)	IPB Bragança	Erasmus+, staf akademik	Njohje kreditesh, përfundim i suksesshëm i mobilitetit
3	Harmonizimi periodik i kurrikulave dhe syllabuseve me	2025-2030	Departamenti i Menaxhimit	IPB Bragança	Burime njerëzore	Përditësim kurrikular dhe rritje e cilësisë akademike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

	institucionet partnere					
4	Përgatitja dhe aplikimi për program Master me diplomë të dyfishtë në "Menaxhim Biznes"	2026-2027	Departamenti / Dekanati FB	IPB Bragança	Erasmus+, buxhet UAMD	Dosje aplikimi dhe miratim institucional
5	Rritja e mobilitetit studentor Erasmus+ (outgoing/incoming)	Çdo vit	Departamenti / Zyra e Ndërkombëtarizimit	Universitete partnere	Erasmus+	Rritje progresive e numrit të mobiliteteve
6	Rritja e mobilitetit të stafit akademik (teaching/training)	Çdo vit	Departamenti i Menaxhimit	Universitete partnere	Erasmus+	Minimumi 2 mobilitete stafi në vit
7	Organizimi i javëve ndërkombëtare, workshop-eve dhe leksioneve të përbashkëta	Çdo vit	Departamenti i Menaxhimit	IPB & partnerë të tjerë	Erasmus+, buxhet FB	Minimumi 1 event ndërkombëtar në vit
8	Përgatitja dhe dorëzimi i aplikimeve në projekte Erasmus+ KA2/CBHE, Horizon Europe	2025-2030	Staf akademik	Partnerë ndërkombëtarë	Programe BE	Aplikime projektsh të dorëzuara
9	Zhvillimi i moduleve në gjuhë angleze dhe përfshirja e pedagogëve të huaj (guest lectures)	2025-2030	Departamenti i Menaxhimit	Pedagogë të huaj	Burime institucionale	Internationalisation at home
10	Promovimi dhe komunikimi ndërkombëtar i programeve të përbashkëta dhe	Çdo vit	Departamenti / Fakulteti i Biznesit	IPB & partnerë	Marketing institucional	Rritje e aplikimeve ndërkombëtare



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

	diplomave të dyfishta					
--	--------------------------	--	--	--	--	--

5. Objektivat vjetore (2025-2030)

Viti akademik 2025-2026

- Konsolidimi i programit të përbashkët Bachelor në "International Business Management" me Institutin Politeknik të Bragançës;
- Monitorimi i programit Bachelor me diplomë të dyfishtë në "Administrim Biznes" (Anglisht) me Institutin Politeknik të Bragançës;
- Rritja e mobilitetit studentor dhe të stafit akademik përmes Erasmus+;
- Organizimi i të paktën një aktiviteti akademik ndërkombëtar (workshop/javë ndërkombëtare/guest lecture);
- Përditësimi i kurrikulës dhe syllabuseve në përputhje me partnerët ndërkombëtarë.

Viti akademik 2026-2027

- Vazhdimi dhe forcimi i programeve të përbashkëta dhe me diplomë të dyfishtë në nivel Bachelor;
- Përgatitja dhe dorëzimi i dokumentacionit për hapjen e programit Master me diplomë të dyfishtë në "Menaxhim Biznes" në bashkëpunim me IPB;
- Rritja e numrit të mobiliteteve Erasmus+ për studentë dhe staf akademik;
- Përgatitja dhe dorëzimi i të paktën një aplikimi për projekt ndërkombëtar (Erasmus+ KA2/CBHE ose programe të tjera);
- Zgjerimi i ofertës së moduleve në gjuhë angleze.

Viti akademik 2027-2028

- Miratimi dhe nisja e zbatimit të programit Master me diplomë të dyfishtë (nëse aprovohet);
- Konsolidimi i bashkëpunimit akademik dhe kërkimor me IPB dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë;
- Rritja e pjesëmarrjes së stafit akademik në projekte kërkimore dhe publikime me bashkautorë ndërkombëtarë;
- Organizimi i një eventi ndërkombëtar me pjesëmarrje të gjerë akademike;
- Forcimi i mekanizmave të mbështetjes për studentët ndërkombëtarë dhe vizitorë.

Viti akademik 2028-2029

- Zgjerimi i rrjetit të partnerëve ndërkombëtarë përtej bashkëpunimit ekzistues;
- Rritja e numrit të studentëve incoming dhe outgoing në programe mobiliteti;
- Thëllimi i ndërkombëtarizimit të kurrikulës përmes qasjes "internationalisation at home";
- Rritja e numrit të aplikimeve dhe pjesëmarrjeve në projekte ndërkombëtare;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

- Përmirësimi i dukshmërisë ndërkombëtare të departamentit përmes marketingut akademik.

Viti akademik 2029-2030

- Konsolidimi i plotë i programeve të përbashkëta dhe diplomave të dyfishta në nivel Bachelor dhe Master;
- Vlerësimi i përgjithshëm i rezultateve të strategjisë së ndërkombëtarizimit 2025-2030;
- Hartimi i rekomandimeve për strategjinë pasuese të ndërkombëtarizimit;
- Forcimi i pozicionimit të Departamentit të Menaxhimit si një strukturë referuese për ndërkombëtarizimin në kuadër të UAMD.

6. Burimet financiare

Zbatimi i Strategjisë së Ndërkombëtarizimit të Departamentit të Menaxhimit për periudhën 2025-2030 mbështetet në një kombinim burimesh financiare institucionale, fonde ndërkombëtare dhe burime alternative, të cilat do të menaxhohen në mënyrë të koordinuar dhe efikase.

Buxhet departamenti/fakulteti:

Buxheti i Departamentit të Menaxhimit dhe Fakultetit të Biznesit përbën bazën financiare për mbështetjen e aktiviteteve të ndërkombëtarizimit, duke përfshirë organizimin e eventeve akademike, pritjen e pedagogëve dhe studentëve të huaj, zhvillimin e moduleve në gjuhë angleze dhe mbështetjen administrative të programeve të përbashkëta dhe diplomave të dyfishta. Ky buxhet do të përdoret gjithashtu për bashkëfinancimin e projekteve ndërkombëtare dhe aktiviteteve të mobilitetit.

Erasmus+ (KA131/KA171):

Programi Erasmus+ përbën burimin kryesor financiar për mobilitetin ndërkombëtar të studentëve dhe stafit akademik. Përmes veprimeve KA131 dhe KA171, Departamenti i Menaxhimit do të vazhdojë të përfitojë fonde për mobilitete studimi, mësimdhënie dhe trajnim, si dhe për mbështetjen e programeve me diplomë të dyfishtë dhe aktiviteteve të përbashkëta akademike me institucionet partnere.

Projekte (KA2/CBHE/Horizon/Interreg, etj.):

Një burim i rëndësishëm financiar do të jetë përfshirja e departamentit në projekte ndërkombëtare të financuara nga Bashkimi Evropian dhe programe të tjera rajonale. Departamenti synon të marrë pjesë në projekte Erasmus+ KA2/CBHE, Horizon Europe, Interreg dhe programe të ngjashme, si partner ose koordinator, duke siguruar fonde për zhvillimin e kurrikulës, kërkimin shkencor, ndërtimin e kapaciteteve dhe inovacionin akademik.

Burime të tjera (partnerë, sponsorizime):

Departamenti do të eksplorojë dhe zhvillojë burime alternative financimi përmes bashkëpunimit me



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

partnerë akademikë, institucione publike dhe private, si dhe përmes sponsorizimeve dhe mbështetjes nga bizneset dhe organizatat e interesuara për zhvillimin e kapitalit njerëzor. Këto burime do të përdoren kryesisht për mbështetjen e eventeve ndërkombëtare, aktiviteteve praktike dhe projekteve studentore.

Nevoja për investime dhe trajnime:

Zbatimi efektiv i strategjisë kërkon investime të vazhdueshme në zhvillimin profesional të stafit akademik dhe administrativ, veçanërisht në fusha si menaxhimi i projekteve ndërkombëtare, mësimdhënia në gjuhë të huaj, përdorimi i teknologjive digjitale dhe ndërkombëtarizimi i kurrikulës. Gjithashtu, do të nevojiten investime të targetuara në infrastrukturë, burime didaktike dhe teknologjike për të mbështetur programe të përbashkëta, mobilitete dhe aktivitete ndërkombëtare.

7. KPI dhe monitorimi

Për të siguruar zbatimin efektiv dhe të matshëm të Strategjisë së Ndërkombëtarizimit të Departamentit të Menaxhimit 2025-2030, do të përdoret një sistem treguesish kyç performance (KPI), i cili mundëson monitorimin periodik të progresit, vlerësimin e rezultateve dhe përmirësimin e vazhdueshëm të aktiviteteve ndërkombëtare.

Tregues të mobilitetit

- Numri i studentëve outgoing dhe incoming në mobilitete ndërkombëtare (Erasmus+ dhe marrëveshje bilaterale);
- Numri i studentëve të përfshirë në programe me diplomë të dyfishtë dhe programe të përbashkëta;
- Numri i mobiliteteve të stafit akademik për mësimdhënie (teaching mobility) dhe trajnim (training mobility);
- Kohëzgjatja mesatare e mobiliteteve dhe shkalla e përfundimit me sukses të tyre.

Tregues të projekteve dhe partneriteteve

- Numri i marrëveshjeve aktive ndërkombëtare dhe partneriteteve strategjike;
- Numri i aplikimeve për projekte ndërkombëtare (Erasmus+ KA2/CBHE, Horizon Europe, Interreg, etj.);
- Numri i projekteve të fituara dhe/ose në zbatim ku departamenti është partner ose koordinator;
- Numri i aktiviteteve të përbashkëta akademike dhe kërkimore të realizuara me partnerët ndërkombëtarë.

Tregues akademikë dhe kurrikularë

- Numri i moduleve dhe programeve të studimit të ofruara në gjuhë angleze;
- Numri i pedagogëve të huaj të ftuar (guest lecturers) dhe leksioneve të përbashkëta;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

- Numri i programeve të përbashkëta dhe diplomave të dyfishta në nivel Bachelor dhe Master;
- Shkalla e integritit të elementeve të "internationalisation at home" në kurrikulë.

Tregues kërkimorë

- Numri i publikimeve shkencore me bashkautorë ndërkombëtarë;
- Numri i pjesëmarrjeve në konferenca dhe evente shkencore ndërkombëtare;
- Numri i eventeve akademike dhe kërkimore ndërkombëtare të organizuara nga departamenti;
- Përfshirja e stafit akademik në rrjete dhe grupe kërkimore ndërkombëtare.

Mekanizmi i raportimit dhe monitorimit

Monitorimi i KPI-ve do të realizohet në mënyrë të rregullt dhe të strukturuar, sipas këtij mekanizmi:

- Drejtuesi i Departamentit të Menaxhimit, në bashkëpunim me Koordinatorin e Programeve të Përbashkëta dhe Zyrën e Ndërkombëtarizimit të UAMD;
- Raportim vjetor, në fund të çdo viti akademik;
- Raporte të shkruara vjetore, të integruara në analizën vjetore të departamentit dhe të paraqitura në strukturat përkatëse të Fakultetit të Biznesit dhe UAMD;
- Të dhënat e monitorimit do të shërbejnë për vlerësimin e progresit, identifikimin e problematikave, përmirësimin e planit të veprimit dhe hartimin e strategjive pasuese të ndërkombëtarizimit.

8. Struktura e zbatimit dhe përgjegjësitë

Zbatimi i Strategjisë së Ndërkombëtarizimit të Departamentit të Menaxhimit 2025-2030 mbështetet në një strukturë të qartë organizative dhe ndarje të mirëpërcaktuar të përgjegjësisë, duke siguruar koordinim efikas ndërmjet departamentit, Fakultetit të Biznesit dhe strukturave qendrore të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.

Drejtuesi i Departamentit:

- Drejtuesi i Departamentit të Menaxhimit ka përgjegjësinë kryesore për zbatimin, monitorimin dhe përditësimin e strategjisë së ndërkombëtarizimit në nivel departamenti. Në këtë rol përfshihet:
- drejtimi strategjik i proceseve të ndërkombëtarizimit;
- mbikëqyrja e realizimit të objektivave strategjike dhe planeve vjetore të veprimit;
- koordinimi i aktiviteteve të lidhura me mobilitetet, programet e përbashkëta dhe projektet ndërkombëtare;
- raportimi periodik mbi progresin dhe rezultatet e strategjisë në strukturat përkatëse të Fakultetit të Biznesit dhe UAMD.

Grupi i punës / Komisioni për ndërkombëtarizimin:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT

- Për zbatimin efektiv të strategjisë, në nivel departamenti do të funksionojë një grup pune ose komision për ndërkombëtarizimin, i përbërë nga anëtarë të stafit akademik me eksperiencë në mobilitete, programe të përbashkëta dhe projekte ndërkombëtare. Ky grup ka për detyrë:
- mbështetjen e drejtuesit të departamentit në planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve ndërkombëtare;
- ndjekjen e programeve të përbashkëta dhe diplomave të dyfishta, përfshirë koordinimin akademik;
- identifikimin e mundësive të reja për partneritete dhe projekte ndërkombëtare;
- kontributin në raportimet vjetore dhe analizën e KPI-ve të ndërkombëtarizimit.

Koordinimi me Dekanatin dhe Zyrën e Ndërkombëtarizimit:

- Zbatimi i strategjisë realizohet në koordinim të ngushtë me Dekanatin e Fakultetit të Biznesit dhe Zyrën e Ndërkombëtarizimit të UAMD. Ky koordinim siguron:
- përputhjen e strategjisë së departamentit me strategjinë institucionale të UAMD;
- mbështetje administrative dhe ligjore për mobilitetet, marrëveshjet ndërkombëtare dhe projektet;
- harmonizimin e procedurave akademike dhe administrative për programet e përbashkëta dhe diplomave të dyfishta;
- shkëmbimin e informacionit dhe praktikave të mira në nivel universiteti.

Nëpërmjet kësaj strukture bashkëpunuese dhe ndarjeje të qartë përgjegjësisë, Departamenti i Menaxhimit synon të sigurojë një zbatim të qëndrueshëm, efikas dhe transparent të Strategjisë së Ndërkombëtarizimit 2025-2030.

9. Menaxhimi i riskut

Zbatimi i Strategjisë së Ndërkombëtarizimit 2025-2030 mund të shoqërohet me rreziqe të natyrës akademike, financiare, organizative dhe institucionale. Identifikimi në kohë i këtyre rreziqeve dhe parashikimi i masave parandaluese dhe planeve alternative (Plan B) është thelbësor për garantimin e zbatimit të qëndrueshëm të strategjisë.

Nr	Rreziku	Probabiliteti	Ndikimi	Masa parandaluese	Plan B
1	Pjesëmarrje e ulët e studentëve në mobilitete dhe programe të përbashkëta	Mesatar	I lartë	Informim i vazhdueshëm, orientim akademik, integrim i	Riorientim drejt mobiliteteve afatshkurtra dhe "internationalisation at home"



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

				mobilitetit në kurrikulë	
2	Mungesë ose reduktim fondesh Erasmus+ / projekte	Mesatar	I lartë	Diversifikim burimesh financiare, aplikime të rregullta në projekte	Rritje e mbështetjes nga buxheti i fakultetit/departamentit
3	Vonesë në miratimin institucional të programeve të reja (p.sh. Master double diploma)	Mesatar	Mesatar	Planifikim i hershëm, koordinim me Dekanatin dhe strukturat qendrore	Shtyrje e nisjes së programit dhe forcim i bashkëpunimit ekzistues
4	Mbipërfshirje ose mbingarkesë e stafit akademik	Mesatar	Mesatar	Ndarje e qartë përgjegjësisë, planifikim realist i aktiviteteve	Rishpërndarje e ngarkesës dhe përfshirje e stafit mbështetës
5	Vështirësi në harmonizimin kurrikular me partnerët ndërkombëtarë	I ulët	Mesatar	Takime periodike koordinuese, komisione të përbashkëta akademike	Përshtatje graduale e kurrikulës dhe përdorim i moduleve të përbashkëta
6	Ndryshime në politikat kombëtare ose institucionale të arsimit të lartë	I ulët	Mesatar	Monitorim i vazhdueshëm i kuadrit ligjor dhe institucional	Rishikim i strategjisë dhe përshtatje e objektivave



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I BIZNESIT

MBYLLJE

Strategjia e Ndërkombëtarizimit të Fakultetit të Biznesit 2025–2030 shpreh angazhimin institucional për integrimin e dimensionit ndërkombëtar në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe bashkëpunim me partnerë evropianë. Zbatimi i saj do të realizohet përmes koordinimit ndërmjet departamenteve, rritjes së mobilitetit, projekteve ndërkombëtare dhe forcimit të programeve në gjuhë të huaj. Monitorimi vjetor dhe rishikimi i ndërmjetëm do të sigurojnë efektivitetin dhe përshtatjen e vazhdueshme të strategjisë.

Dekan i Fakultetit të Biznesit

Prof. As. Dr. Llambi PRENDI

Durrës, 2026